

Samuel Beckett

*Duke pritur  
Godonë*

*Oh ato ditë të  
bukura*

BEC  
83-111(417)-2-10



CABEJ

**Konstelacione 8**

Teatër

Samuel Beckett

*Duke pritur Godonë*

\*\*\*

*Oh ato ditë të bukura*

Përkthyen nga origjinali frëngjisht

Mirela Kumbaro

Anton Papeka



ÇABEJ

821.133.1-2

V

Titujt në original:  
*En attendant Godot*  
*Oh les beaux jours*


Për botimin e këtij libri ndihmoi Ambasada Franceze Tiranë

Redaktore:  
Saverina Pasho

Përpunimi grafik:  
Nino Perrone



Copyright © Les Editions de Minuit  
Copyright © për botimin shqip Çabej MÇM  
Botime Çabej MÇM  
Rruga Qemal Stafa 395/12, Tiranë  
tel. ++355/42/64340



*Duke pritur Godonë*

*Përktheu  
Mirela Kumbaro*

## AKTI I PARË

*Rrugë fshati, një pemë.*

*Mbrëmje.*

*Estragoni, i ulur mbi një gur, përpiqet të heqë këpucën. Jep e merr me të dy duart duke shfryrë. Heq dorë i rraskapitur, merr frymë, fillon nga e para.*

*Hyn Vladimiri.*

ESTRAGONI: *(i mposhtur)* S'kam ç'bëj.

VLADIMIRI: *(duke u afruar me hapa të vegjël, të ngrirë, me këmbët e hapura)* Tani po e besoj edhe vetë. *(Ndalet)* I bëra ballë për shumë kohë këtij mendimi, i thosha vetes: Vladimir, thirri mendjes, ende nuk ke provuar gjithçka. Dhe e nisja luftën nga e para *(Përqendrohet, duke u menduar për luftën. I drejtohet Estragonit)* Prapë këtu ti?

ESTRAGONI: A thua?

VLADIMIRI: Gëzohem që po të shoh sërish. Kujtoja se kishe ikur përgjithnjë.

ESTRAGONI: Edhe unë.

VLADIMIRI: Si ta festojmë takimin tonë? *(Mendohet.)* Çohu që të të përqafoj. *(I shtrin dorën Estragonit.)*

ESTRAGONI: *(i acaruar)* Pastaj, pastaj.

*Heshtje.*

VLADIMIRI: *(i fyer, ftohtë)* A mund ta dimë se ku e ka kaluar natën zotëria juaj?

ESTRAGONI: Në një kanal.

VLADIMIRI: *(i habitur)* Kanal! Ku kështu?

ESTRAGONI: *(pa bërë asnjë shenjë)* Atje.



VLADIMIRI: Dhe nuk të rrahën?  
 ESTRAGONI: Po... Por jo shumë.  
 VLADIMIRI: Po ata?  
 ESTRAGONI: Ata? Nuk e di.

VLADIMIRI: Kur e çoj nëpër mend... Ka kaluar kaq kohë...  
 pyes veten... Ç'do të ishe bërë ti... pa mua... (*i vendosur*)  
 Do të ishe katandisur veç një dorë eshtrash. Me siguri.

ESTRAGONI: (*i ngacmuar aty ku i djeg*) E çë pastaj?

VLADIMIRI: (*i lodhur*) Një dorë eshtra është goxha për një njeri  
 të vetëm (*Pauzë. Me gjallëri.*) Përveç kësaj, përse u dashka që  
 të humbasësh kurajon tani, them unë. Për këtë duhej vrarë  
 mendja shumë kohë më parë, aty nga viti 1900.

ESTRAGONI: Mjaft. Më ndihmo ta heq këtë ndyrësirën.

VLADIMIRI: Do të kishim qenë ndër të parët që, të kapur dorë  
 për dore, do ishim hedhur nga Kulla Eifel. Lëre se ç'do kish  
 vajtur atëherë. Tani është tepër vonë. Nuk do të na linin as  
 të ngjiteshim. (*Estragoni bën çmos të heqë këpucën.*) Ç'bën  
 ashtu?

ESTRAGONI: Po heq këpucët. S'të ka qëlluar ndonjëherë ty?

VLADIMIRI: Sa herë të kam thënë që duhen hequr çdo ditë! Bën  
 mirë të ma dëgjosh fjalën.

ESTRAGONI: (*me mundim*) Më ndihmo!

VLADIMIRI: Të vrasin?

ESTRAGONI: Vrasin the? Edhe më pyet!

VLADIMIRI: (*i inatosur*) Vetëm ti vuan gjithmonë! Për mua as që  
 pyet fare. Do të doja ta provoje një herë në kurrizin tënd.  
 Pastaj të flisnim bashkë.

ESTRAGONI: Ke pasur dhimbje?

VLADIMIRI: Dhimbje the? Edhe më pyet!

ESTRAGONI: (*duke treguar me gisht*) Kjo s'është arsye për të  
 mos u kopsitur.

VLADIMIRI: (*duke u përkulur*) Ke të drejtë. (*Kopsitet.*) Gjërat e  
 vogla nuk duhen nënvlerësuar.

ESTRAGONI: Ç'të të them unë ty, ti pret gjithnjë çastin e fundit.

VLADIMIRI: (*i humbur në mendime*) Çasti i fundit... (*Duke u  
 menduar.*) Vonon, por ia vlen. Kush thoshte kështu?

ESTRAGONI: Do të më ndihmosh apo jo?

VLADIMIRI: Nganjëherë më duket se sidoqoftë ky çast vjen. Atëhere çuditem me veten time. (*Heq kapelen, e këqyr nga brenda, rrëmon në të, e shkund, e vë përsëri në kokë*) Si të të them? I çliruar, por edhe... (*kërkon fjalën*)... i llahtarisur. (*me deklamim*) I llahtarisur. (*Përsëri heq kapelen dhe shikon brenda saj.*) Epo kjo! (*I bie kapeles nga sipër sikur të ketë gjë, sheh përsëri nga brenda, e vë në kokë.*) Më në fund... (*Me përpjekje të mëdha Estragoni arrin ta heqë këpucën. E këqyr brenda, rrëmon me dorë, e kthen përmbys, e shkund, sheh se mos ka rënë ndonjë gjë përtokë, asgjë, fut përsëri dorën në të, me shikim të përhumbur.*) Hë pra?

ESTRAGONI: Asgjë.

VLADIMIRI: Prit ta shoh?

ESTRAGONI: S'ke ç'të shohësh.

VLADIMIRI: Pa provo ta mbathësh prapë.

ESTRAGONI: (*pasi ka parë këmbën*) Po e lë të marrë pak ajër.

VLADIMIRI: Ja, kështu e ka njeriu. Merret me këpucën, kurse fajin ia ka këmba. (*Për herë të tretë heq kapelen, e këqyr nga brenda, rrëmon me dorë, e qëllon përsipër, i fryn brenda dhe e vendos në kokë*) Kjo po më shqetëson. (*Pauzë. Estragoni lëviz këmbën dhe gishtat që të marrin ajër.*) Njëri prej kusarëve shpëtoi. (*Pauzë*) Është përqindje e kënaqshme. (*Pauzë*) Gogo...

ESTRAGONI: Çfarë?

VLADIMIRI: Po sikur të pendoheshim?

ESTRAGONI: Për çfarë?

VLADIMIRI: Po... (*kërkon*) Nuk është nevoja të hyjmë në hollë-sira.

ESTRAGONI: Që kemi lindur?

*Vladimiri ia plas gazit, po shpejt e mbyl atë duke çuar dorën drejt fundit të barkut dhe duke shtrembëruar fytyrën.*

VLADIMIRI: Nuk guxojmë më as të qeshim.

ESTRAGONI: Sakrificë e madhe.

VLADIMIRI: Vetëm buzëqeshja lejohet. (*I çahet fytyra nga një buzëqeshje e tepruar, e ngrirë, që zgjat disa çaste pastaj i shubet përnjëherë.*) S'është e njëjta gjë. Sidoqoftë... (*Pauzë*) Gogo...

ESTRAGONI: (*i bezdisur*) Hë, çfarë ke?



VLADIMIRI: A e ke lexuar Biblën?

ESTRAGONI: Biblën... (*Mendohet*) Më duket se i kam hedhur një sy.

VLADIMIRI: (*i habitur*) Në shkollën pa Zot?

ESTRAGONI: Ku e di unë me Zot a pa Zot.

VLADIMIRI: Po e ngatërron me shkollën e riedukimit.

ESTRAGONI: Mbase. Më kujtohen hartat e Tokës së Shenjtë. Ishin me ngjyra. Shumë të bukura. Deti i Vdekur ishte bojë-qielli. Kisha etje sa herë e shihja. Atje dua ta kaloj muajin e mjaltit, thosha me vete. Do të notojmë. Do të jemi të lumtur.

VLADIMIRI: Ti duhet të ishe bërë poet.

ESTRAGONI: Kam qenë. (*tregon rrekat e veta*) Pse, nuk duket? *Heshtje.*

VLADIMIRI: Çfarë po thosha... Si e ke këmbën?

ESTRAGONI: Po ënjtet.

VLADIMIRI: Ah, po, u kujtova, ajo historia e hajdutëve. E mban mend?

ESTRAGONI: Jo.

VLADIMIRI: A do të ta tregoj?

ESTRAGONI: Jo.

VLADIMIRI: Sa për të shtyrë kohën. (*Pauzë*) Na ishin dy hajdutë që i kryqëzuan në të njëjtën kohë me Shpëtimtarin. Thuhet se...

ESTRAGONI: Cilin?

VLADIMIRI: Shpëtimtarin. Dy hajdutë. Thuhet se njëri shpëtoi, ndërsa tjetri... (*kërkon të kundërtën e fjalës «shpëtoi»*)... u dënuar.

ESTRAGONI: Nga se shpëtoi?

VLADIMIRI: Nga ferri.

ESTRAGONI: Unë po shkoj (*nuk lëviz vendit*).

VLADIMIRI: Megjithatë... (*Pauzë*) Si është e mundur që... Nuk të mërzis, ë?

ESTRAGONI: Nuk po të dëgjoj.

VLADIMIRI: Si është e mundur që vetëm njëri nga të katër apostujt e tregon ngjarjen në këtë mënyrë? E pra, që të katërt ishin atje – ose, të paktën, diku pranë. Por vetëm njëri prej tyre thotë se njëri nga hajdutët shpëtoi. (*Pauzë*) Shiko, Gogo, duhet të më përgjigjesh herë pas here.

ESTRAGONI: Po të dëgjoj.

VLADIMIRI: Vetëm njëri prej të katërve. Sa për tre të tjerët, dy nuk e zënë ngoje fare, ndërsa i treti thotë se e kanë bërë leckë që të dy.

ESTRAGONI: Kush?

VLADIMIRI: Si?

ESTRAGONI: Nuk po kuptoj asgjë... (Pauzë) Kë kanë bërë leckë?

VLADIMIRI: Shpëtimtarin!

ESTRAGONI: Pse?

VLADIMIRI: Sepse nuk deshi t'i shpëtonte.

ESTRAGONI: Nga ferri?

VLADIMIRI: Po jo, more, jo! Nga vdekja.

ESTRAGONI: Po pastaj?

VLADIMIRI: Pastaj u dënuan që të dy.

ESTRAGONI: E pastaj?

VLADIMIRI: Mirëpo tjetri thotë se njëri shpëtoi.

ESTRAGONI: E çë? Do të thotë se nuk janë në një mendje dhe pikë.

VLADIMIRI: Ata ishin atje që të katër. Dhe vetëm njëri flet për hajdutin e shpëtuar. Përse u dashka besuar ai dhe jo të tjerët?

ESTRAGONI: E kush e beson?

VLADIMIRI: Të gjithë e besojnë. Njerëzit njohin vetëm këtë version.

ESTRAGONI: Janë të gjithë hajvanë.

*Ngrihet me mundim dhe duke çaluar drejtohet për nga quinta e majtë, ndalet, hedh vështrimin larg duke mbrojtur sytë me dorë, kthehet, drejtohet për nga quinta e djathtë, vështron larg. Vladimiri e ndjek me sy, pastaj shkon të marrë këpucën, vështron përbrenda saj, e lëshon përdhe menjëherë.*

VLADIMIRI: Puh! (pështyn përtokë)

ESTRAGONI: (Kthehet në qendër të skenës dhe vështron nga fundi) Vend magjepsës. (Kthehet, bën përpara deri në paraskenë, vështron nga publiku) Pamje të qeshura. (Kthehet nga Vladimiri) Eja të shkojmë.

VLADIMIRI: Nuk mundemi.

ESTRAGONI: Pse?

VLADIMIRI: Po presim Godonë.

ESTRAGONI: Po, ke të drejtë. (*Pauzë*) A je i sigurt se është ky?

VLADIMIRI: Çfarë?

ESTRAGONI: Vendi ku duhet ta presim.

VLADIMIRI: Ai tha përpara pemës. (*Vështrojnë pemën*) A të zë syri të tjera veç kësaj këtu?

ESTRAGONI: Ç'pemë është?

VLADIMIRI: Mua më duket shëlg.

ESTRAGONI: Po gjetet ku janë?

VLADIMIRI: Duhet të jetë i tharë.

ESTRAGONI: I ka reshtur lotët.

VLADIMIRI: Veç në mos qoftë stina.

ESTRAGONI: Mos është ndonjë shkurre?

VLADIMIRI: Një shkurrëz.

ESTRAGONI: Një shkurre.

VLADIMIRI: Një... (*Ndërpret fjalën*) Ç'do të thuash? Që kemi ngatërruar vendin?

ESTRAGONI: Duhej të kishte ardhur.

VLADIMIRI: Nuk tha se do të vinte patjetër.

ESTRAGONI: Po sikur të mos vijë?

VLADIMIRI: Do të vijmë nesër përsëri.

ESTRAGONI: Ndoshta edhe pasnesër.

VLADIMIRI: Ndoshta.

ESTRAGONI: E kështu me radhë.

VLADIMIRI: Domethënë...

ESTRAGONI: Deri sa të vijë.

VLADIMIRI: Je i pamëshirshëm.

ESTRAGONI: Erdhëm edhe dje.

VLADIMIRI: Ah, jo kështu! Po ia fut kot tani.

ESTRAGONI: Çfarë bëmë dje?

VLADIMIRI: Çfarë bëmë dje?

ESTRAGONI: Po.

VLADIMIRI: Për besë... (*Duke u nxehur*) S'e ke shokun për të mbjellë dyshime.

ESTRAGONI: Unë them se ishim këtu.

VLADIMIRI: (*hedh një shikim rreth e përqark*) Mos të duket i njohur ky vend?

ESTRAGONI: S'të thashë gjë.

- VLADIMIRI: Atëherë?
- ESTRAGONI: S'do të thotë gjë.
- VLADIMIRI: Megjithatë... kjo pema... *(duke u kthyer nga publiku)*... ky llum.
- ESTRAGONI: A je i sigurt se ishte për sonte?
- VLADIMIRI: Çfarë?
- ESTRAGONI: Që duhej ta prisnim.
- VLADIMIRI: Ai tha të shtunën *(Pauzë)* Kështu më duket.
- ESTRAGONI: Pas pune.
- VLADIMIRI: Duhet ta kem shënuar gjëkundí. *(Kërkon nëpër xhepat e mbushur me gjithfarë mbeturinash)*
- ESTRAGONI: Cilën të shtunë se? Po sot, e shtunë është? Mos është e diel? Apo e hënë? Apo e premte?
- VLADIMIRI: *(duke vështruar përreth shumë i shqetësuar, sikur data të ishte e shkruar në peizazhin që ka përpara)* Nuk është e mundur.
- ESTRAGONI: Apo e enjte.
- VLADIMIRI: Si t'ia bëjmë?
- ESTRAGONI: Po pati ardhur mbrëmë e s'na ka gjetur, të jesh i sigurt që sonte s'ka për të ardhur më.
- VLADIMIRI: Po ti thua se ne erdhëm këtu edhe mbrëmë.
- ESTRAGONI: Mbase e kam gabim. *(Pauzë)* Rimë pak pa folur, po deshe.
- VLADIMIRI: *(pa fuqi)* Mirë. *(Estragoni ulet përsëri përtokë. Vladimiri i shqetësuar vete e vjen nëpër skenë, hera-herës ndalet për të vështruar në horizont. Estragonin e zë gjumi. Vladimiri ndalet përpara Estragonit)* Gogo... *(Heshtje)* Gogo... *(Heshtje)* Gogo!
- ESTRAGONI: *(zgjohet i trembur, duke e shprehur qartë se është i llahtarisur)* Po flija. *(Qortues)* Si nuk më le një herë të fle!
- VLADIMIRI: Mbeta vetëm.
- ESTRAGONI: Pashë një ëndërr.
- VLADIMIRI: Mos ma trego!
- ESTRAGONI: Në ëndërr po shihja sikur...
- VLADIMIRI: MOS MA TREGO!
- ESTRAGONI: *(tregon gjithë universin)* A të mjafton ky këtu? *(Pauzë)* Sa i keq që bëhesh, Didi! Kujt, veç teje, mund t'ia tregoj makthet e mia?

VLADIMIRI: Mbaji për vete. Ti e di që nuk i duroj dot.

ESTRAGONI: (*ftohtë*) Nganjëherë them me vete se mbase është më mirë të ndahemi.

VLADIMIRI: S'kishe për të shkuar larg.

ESTRAGONI: Ashtu është, nuk do të kisha pikë leverdie. (*Pauzë*) Apo jo Didi, nuk do të kisha asnjë leverdi. (*Pauzë*) Po të kesh parasysh bukurinë e rrugës. (*Pauzë*) Dhe mirësinë e udhëtarëve (*Pauzë. Miklues*) Apo jo, Didi?

VLADIMIRI: Qetësohu.

ESTRAGONI: (*me pasion*) Qetë... qetë (*i përhumbur*) Anglezët thonë kâââm. Janë tipa kâââm. (*pauzë*) A e di atë historinë e anglezit në bordell.

VLADIMIRI: Po, po.

ESTRAGONI: Pa ma trego njëherë.

VLADIMIRI: Mjaft!

ESTRAGONI: Pasi është bërë tapë, një anglez shkon në bordell. Kujdestarja e vajzave e pyet nëse dëshiron një bionde, një brune apo një kuqe. Vazhdoje ti.

VLADIMIRI: MJAFT!

*Vladimiri del. Estragoni ngrihet dhe i shkon pas deri në skaj të skenës. Mimika e Estragonit i ngjan asaj të spektatorëve që ndjekin një ndeshje boksi. Vladimiri kthehet, kalon përpara Estragonit, përshkon tërë skenën me sytë poshtë. Estragoni bën disa hapa drejt tij dhe ndalet.*

ESTRAGONI: (*me të butë*) Deshe të më thoje ndonjë gjë? (*Vladimiri nuk përgjigjet; Estragoni bën një hap para.*) Kishe ndonjë gjë për të më thënë? (*Heshtje. Hap tjetër para.*) Më thuaj, Didi...

VLADIMIRI: (*pa u kthyer*) Nuk kam asgjë për të të thënë.

ESTRAGONI: (*bën një hap para*) U zemërove? (*Pauzë. Hap para*) Më fal! (*Heshtje. Hap para. I prek supin.*) Hë pra, dorën. (*Vladimiri kthehet*) Përqafo më! (*Vladimiri ngrin*) Lërmë të të përqafoj! (*Vladimiri dorëzohet. Përqafohen. Estragoni prapset*) Qelbesh erë hudhër.

VLADIMIRI: Bën mirë për veshkat. (*Heshtje. Estragoni vështron pemën me vëmendje.*) Po tani ç'të bëjmë?

ESTRAGONI: Të presim.

VLADIMIRI: Mirë, po ndërkohë që presim?

ESTRAGONI: Po sikur të varnim veten?

VLADIMIRI: Do të ishte një mënyrë për të na u ngrehur.

ESTRAGONI: (*i ngacmuar*) Ngrehet?

VLADIMIRI: Ngrehet dhe ca më tepër. Aty ku derdhet, mbijnë madërgonat. Ja përse këto ulërijnë kur i shkulin. Nuk e dije?

ESTRAGONI: Ç'presim? Hajde varemi!

VLADIMIRI: Po ku? Në një degë? (*I afrohen pemës dhe e vësh-trojnë*) Unë s'do t'i zija besë.

ESTRAGONI: Ç'të keqe ka po ta provojmë?

VLADIMIRI: Provoje!

ESTRAGONI: Ti i pari.

VLADIMIRI: Jo, jo. Në fillim ti.

ESTRAGONI: Pse?

VLADIMIRI: Sepse ti peshon më pak se unë.

ESTRAGONI: Pikërisht.

VLADIMIRI: Nuk të kuptoj.

ESTRAGONI: Pa mendohu pak...

*Vladimiri mendohet.*

VLADIMIRI: (*Më në fund.*) Nuk kuptoj.

ESTRAGONI: Ta shpjegoj unë. (*Përqendrohet*) Dega... dega... (*I inatosur*) Dreqi e mori. Përpiqu ta kuptosh!

VLADIMIRI: Unë vetëm te ty kam besim.

ESTRAGONI: (*duke u përpjekur*)... Gogo i lehtë... dega nuk thyhet... Gogo i vdekur. Didi i rëndë... dega thyhet... Didi vetëm. (*Pauzë*) Ndërsa... (*Kërkon shprehjen e saktë*)

VLADIMIRI: Kjo s'më kish vajtur në mend.

ESTRAGONI: (*tashmë e ka gjetur*) Kush mban shumë, mban edhe pak.

VLADIMIRI: Pse, vërtet unë peshoj më shumë se ti?

ESTRAGONI: Ti po thua. Unë s'di gjë. Por ka të ngjarë.

VLADIMIRI: Atëherë, ç'të bëjmë?

ESTRAGONI: Nuk bëjmë asgjë. Është më mirë kështu.

VLADIMIRI: Të dëgjojmë njëherë ç'do të na thotë ai.

ESTRAGONI: Kush?

VLADIMIRI: Godoja.

ESTRAGONI: Hë, po.

VLADIMIRI: Të presim që të marrim vesh si është puna.

ESTRAGONI: Nga ana tjetër, mbase është më mirë ta rrahësh hekurin sa është i nxehtë.

VLADIMIRI: Jam kureshtar të di ç' do të na thotë. Sido që të jetë, kjo nuk na i lidh duart.

ESTRAGONI: Po çfarë i kemi kërkuar ne atij?

VLADIMIRI: Pse, nuk ishe ti?

ESTRAGONI: Nuk e kisha mendjen.

VLADIMIRI: Po, ja... Asgjë të saktë.

ESTRAGONI: Një lloj lutjeje.

VLADIMIRI: Tamam.

ESTRAGONI: Një lutje të paqartë.

VLADIMIRI: Pak a shumë.

ESTRAGONI: Po ai si u përgjigj?

VLADIMIRI: Tha se do ta shihte.

ESTRAGONI: Se nuk mund të premtonte asgjë.

VLADIMIRI: Se duhet të mendohej.

ESTRAGONI: Me qetësi?

VLADIMIRI: Të këshillohej me familjen.

ESTRAGONI: Me miqtë?

VLADIMIRI: Me agjentët e tij.

ESTRAGONI: Me korrespondentët.

VLADIMIRI: Të shihte regjistrat.

ESTRAGONI: Llogarinë e tij në bankë.

VLADIMIRI: Para se të shprehej.

ESTRAGONI: Është normale.

VLADIMIRI: Vërtet?

ESTRAGONI: Kështu më duket!

VLADIMIRI: Edhe mua.

*Heshtje e gjatë.*

ESTRAGONI: *(i shqetësuar)* Po ne?

VLADIMIRI: Urdhëro?

ESTRAGONI: Thashë: Po ne?

VLADIMIRI: Nuk kuptoj.

ESTRAGONI: Ç' rol kemi ne në këtë mes?

VLADIMIRI: Roli ynë?

ESTRAGONI: Merre shtruar.

VLADIMIRI: Roli ynë? Është roli i lutësit.

ESTRAGONI: Kështu qenkemi katandisur.

VLADIMIRI: Mos keni gjë kërkesa për të parashtruar, zotëria juaj?

ESTRAGONI: Pse, nuk kemi më të drejta?

*E qeshura e Vladimirit ndërpritet befás, si më parë. E njëjta mikë, përveç buzëqeshjes.*

VLADIMIRI: Sikur të më lejohej, do më bëje për të qeshur.

ESTRAGONI: I kemi humbur?

VLADIMIRI: (*prerazi*) I kemi shitur për hiçgjë.

*Pauzë. Rrinë pa lëvizur, me krahët lëshuar, kokën varur mbi gjoks, gjunjët e përthyer.*

ESTRAGONI: (*me zë të mekur*) Nuk jemi të lidhur? (*Pauzë*) Hë?

VLADIMIRI: (*duke ngritur dorën*) Dëgjo!

*Mbajnë vesh, të ngrirë, me pamje groteske.*

ESTRAGONI: Nuk dëgjoj asgjë.

VLADIMIRI: Shshshsh! (*Mbajnë vesh. Estragoni humbet drejtpe-shimin dhe për pak sa nuk bie. Kapet pas krahut të Vladimirit, që i merren këmbët. Mbajnë vesh, të ngjeshur pas njëri-tjetrit, tek shihen sy më sy*) As unë.

*Marrin frymë të lehtësuar. Çtendosje. Largohen nga njëri-tjetri.*

ESTRAGONI: Më trembe.

VLADIMIRI: Kujtova se ishte ai.

ESTRAGONI: Kush?

VLADIMIRI: Godoja.

ESTRAGONI: Posi! Lëviz kallamishtja nga era.

VLADIMIRI: M'u dukën krejt si britma.

ESTRAGONI: E përse do të briste?

VLADIMIRI: Për t'i thirrur kalit.

*Heshtje.*

ESTRAGONI: Eja të ikim.

VLADIMIRI: Ku? (*Pauzë*) Ndoshta sonte do të flemë në shtëpinë e tij, në të ngrohtë, pa u lagur, përmbi kashtë, me barkun plot. Ia vlen të presim, apo jo?

ESTRAGONI: Veç jo gjithë natën.

VLADIMIRI: Është ditë akoma.

*Heshtje.*

ESTRAGONI: Kam uri.

VLADIMIRI: Do një karrotë?

ESTRAGONI: Nuk ka gjë tjetër?

VLADIMIRI: Duhet të kem ca rrepa.



ESTRAGONI: Më jep një karrotë. (*Vladimiri rrëmon xhepat, nxjerr një rrepë dhe ia zgjat Estragonit*) Falemnderit. (*E kafshon, duke u qarë.*) Po kjo qenka rrepë!

VLADIMIRI: Oh, më fal. I sigurt se ishte karrotë. (*Kërkon përsëri nëpër xhepa, por gjen vetëm rrepa.*) Vetëm rrepa paskam. (*Kërkon prapë*) Të fundit duhet ta kesh ngrënë ti. (*Duke kërkuar.*) Prit. E gjeta. (*Nxjerr më në fund një karrotë dhe ia zgjat Estragonit.*) Urdhëro, i dashur. (*Estragoni e fshin pas mëngës dhe fillon ta hajë.*) Ma kthe rrepën. (*Estragoni i kthen rrepën*) Hajë ngadalë, se nuk ka më.

ESTRAGONI: (*duke u përtypur*) Të bëra një pyetje.

VLADIMIRI: Aha!

ESTRAGONI: M'u përgjigje apo jo?

VLADIMIRI: Hë pra, si të duket karrota?

ESTRAGONI: Është e ëmbël.

VLADIMIRI: Aq më mirë, aq më mirë. (*Pauzë*) Çfarë doje të dije?

ESTRAGONI: Nuk e mbaj mend më. (*Vazhdon të përtypet.*) Më vjen të plas. (*Vështron karrotën sikur do ta hajë me sy, e vërtit në majë të gishtave*) E mrekullueshme kjo karrota! (*thith karrotën duke u menduar*) Prit! Po, m'u kujtua. (*Kafshon karrotën.*)

VLADIMIRI: Pra?

ESTRAGONI: (*me gojën plot, pa e patur mendjen*) Nuk jemi të lidhur?

VLADIMIRI: S'po të marr vesh.

ESTRAGONI: (*përtypet, pastaj gëlltit*) Të pyeta nëse jemi të lidhur.

VLADIMIRI: Të lidhur?

ESTRAGONI: Të li-dhur.

VLADIMIRI: Si të lidhur?

ESTRAGONI: Këmbë e duar.

VLADIMIRI: Pas kujt? Prej kujt?

ESTRAGONI: Pas bablokut tënd.


VLADIMIRI: Pas Godosë? Të lidhur pas Godosë? Hajde mendje, hajde! Kurrën e kurrës! (*Pauzë*) Ende jo.

ESTRAGONI: Godo quhet?

Vladimir: Ashtu më duket.

ESTRAGONI: Bukur! (*E ngre karrotën nga ana e fryrë dhe e vërtit*)

- përpara syve.) Çudi, sa më shumë ha, aq më pak të shijon.*
- VLADIMIRI: Për mua është e kundërta.
- ESTRAGONI: Domethënë?
- VLADIMIRI: Sa më shumë ha, aq më shumë më shijon.
- ESTRAGONI: (*pasi është menduar gjatë*) Po pse, e kundërta është kjo?
- VLADIMIRI: Çështje temperamenti.
- ESTRAGONI: Karakteri.
- VLADIMIRI: S'e ç'i bën.
- ESTRAGONI: Lodhu sa të duash.
- VLADIMIRI: Këta që këta jemi.
- ESTRAGONI: Boll jemi rropatur.
- VLADIMIRI: Thelbi nuk ndryshon.
- ESTRAGONI: Nuk kemi ç'bëjmë. (*i zgjat karrotën e mbetur Vladimirit*) Do ta hash këtë që ka mbetur?
- Fare afër dëgjohet një britmë e tmerrshme. Estragonit i bie karrota nga dora. Shtangen të dy për një çast, pastaj lëshohen drejt kuintave. Estragoni ndalet në mes të rrugës, kthehet nga ka ardhur, merr karrotën, e fut në xhëp, lëshohet për nga Vladimiri që e pret, ndalet sërish. Kthehet mbrapsht, merr këpucën, pastaj vrapon për te Vladimiri. Të përqaftuar fort me njëri-tjetrin, duke iu shmangur rrezikut, presin pa lëvizur.*
- Hynë Poco dhe Luki. I pari e tërheq të dytin me një litar shkuar në qafë, në mënyrë të tillë që në fillim shfaqet vetëm Luki i ndjekur nga litari i gjatë deri në mes të skenës, pastaj, nga kuintat del Poco. Luki mban një valixhe të rëndë, një stol që paloset, një shportë ushqimesh dhe një pallto (në dorë) Poco ka në dorë një kamzhik.*
- POCO: (*që prapa kuintave*) Më shpejt! (Goditje kamzhiku. Hyn Poco. Përshkojnë të gjithë skenën. Luki kalon përpara Vladimirit dhe Estragonit dhe del. Poco, kur sheh Vladimirin dhe Estragonin, mban këmbët. Litari tendoset. Poco e tërheq litarin me forcë.) Mbrapa! (Jashtë skenës dëgjohet një rropamë. Luki është rrëzuar me gjithë ngarkesën. Vladimiri dhe Estragoni e vështrojnë mëdysbas, midis dëshirës për të vrapuar në ndihmë të tij dhe frikës se mos përzhihen në punë që nuk u takojnë. Vladimiri hedh një hap drejt Lukit. Estragoni e mban për mënge.)



VLADIMIRI: Lëshomë!

ESTRAGONI: Mos luaj!

POCO: Kujdes. Është i lig. (*Estragoni dhe Vladimiri e vësh. trojnë.*) Me të panjohurit.

ESTRAGONI: (*me zë të ulët*) Ai është?

VLADIMIRI: Kush?

ESTRAGONI: Ai pra...

VLADIMIRI: Godoja?

ESTRAGONI: E pra.

POCO: Të njihemi: quhem POCO.

VLADIMIRI: Jo, jo.

ESTRAGONI: Tha se quhet Godo.

VLADIMIRI: Jo mor, jo.

ESTRAGONI: (*i drejtohet Pocos*) Nuk jeni zoti Godo, ju?

POCO: (*me një zë të tmerrshëm*) Unë jam POCO! (*Pauzë*) Nuk ju thotë asgjë ky emër? (*Pauzë*) Ju pyeta nëse ky emër ju thotë gjë.

*Vladimiri dhe Estragoni shihen në sy.*

ESTRAGONI: (*bën sikur përpiqet të kujtojë*) BOCO... BOCO.

VLADIMIRI: (*po ashtu*) POCO...

POCO: Pppoco!

ESTRAGONI: Ah! POCO... pa shih... POCO...

VLADIMIRI: POCO apo BOCO?

ESTRAGONI: POCO... jo, nuk e kuptoj.

VLADIMIRI: (*duke dashur të merret vesh*) Kam njohur një familje GOCO. Nëna qëndiste me gjergjef.

*POCO afrohet kërcënues.*

ESTRAGONI: (*shpejt e shpejt*) Nuk jemi nga këto anë, zotëri.

POCO: (*duke ndalur hapin*) Por jeni qenie njerëzore ama. (*Vë syzet*) Me ç'më shohin sytë. (*Heq syzet*) Jemi e njëjta specie. (*qesh me të madhe*) E njëjta specie me POCO. Me origjinë hyjnore!

VLADIMIRI: Domethënë...

POCO: (*prerazi*) Kush është Godoja?

ESTRAGONI: Godoja?

POCO: Më morët për Godonë.

VLADIMIRI: Oh, jo zotëri. Aspak zotëri.

POCO: Kush është ky?

VLADIMIRI: Po ja, është... është një i njohur.

ESTRAGONI: Jo, jo, shiko, ne e njohim shumë pak.

VLADIMIRI: Vërtet... nuk e njohim mirë... por megjithatë.

ESTRAGONI: Unë, madje, po ta shoh nuk e njoh.

POCO: Ju më morët për të.

ESTRAGONI: Po ja... errësira... lodhja... dobësia... pritja... e pranoj... për një moment... ju mora...

VLADIMIRI: Mos ia vini veshin, zotëri, mos ia vini veshin.

POCO: Pritja? Pra ju po e prisnit?

VLADIMIRI: Jo, po...

POCO: Këtu? Në tokat e mia?

VLADIMIRI: Nuk kishim ndërmend asgjë të keqe.

ESTRAGONI: Kishim mendje të mirë.

POCO: Rruga është e të gjithëve.

VLADIMIRI: Atë po thoshim dhe ne.

POCO: Turp është, po ja që është kështu.

ESTRAGONI: S'ke ç'i bën.

POCO: *(me një gjest bujar)* Ta lëmë këtë muhabet. *(Tërheq litarin)* Çohu! *(Një çast)* Sa herë rrëzohet, ia merr me gjumë *(Tërheq litarin)* Çohu qelbësirë! *(Luki bën zhurmë duke u ngritur dhe duke mbledhur plaçkat e tij. Poco tërheq litarin)* Prapsohu. *(Luki hyn duke ecur prapas)* Ndal! *(Luki ndalon)* Kthehu! *(Luki kthehet. Poco tregohet i dashur me Vladimirin dhe Estragonin)* Miqtë e mi, jam i lumtur që munda t'ju takoj. *(Duke parë se Vladimiri dhe Estragoni duken të çuditur)* Po, po, jam i lumtur, sinqerisht. *(Tërheq litarin)* Afrohu *(Luki bën përpara)* Ndal! *(Luki ndalet. I drejtohet Vladimirit dhe Estragonit)* E dini, rruga s'ka të sosur kur e bën vetëm *(shëb orën)*... kur ecën *(bën llogarinë)* gjashtë orë, po, tamam, gjashtë orë rresht, pa takuar njeri të gjallë *(Lukit)* Pallton! *(Luki lë valixhen, bën përpara, i jep pallton, zbrapset, rimerr valixhen)* Merre këtë! *(Poco i zgjat kamzhikun, Luki bën përpara dhe, meqë i ka duart e zëna, përkulet dhe e merr kamzhikun me dhëmbë, pastaj zbrapset. Poco nis të veshë pallton, ndalet)* Pallton! *(Luki lë gjithçka përdhe, bën përpara, ndihmon Pocon të veshë pallton, zbrapset dhe merr ato që ka lënë përdhe)* Ajri është i freskët. *(Mbaron së kopsituri pallton, përkulet, shihet me vëmendje, ngrihet)* Kamzhikun! *(Luki afrohet, përkulet. Poco ia tërheq me forcë kamzhikun nga*

goja. *Luki zbrapset*) Sepse unë, miqtë e mi, nuk rri dot pa njerëz për një kohë të gjatë (*sheh dy njerëzit që ndodhen para tij*) edhe kur ata që më rrethojnë nuk janë krejt si unë. (*Lukit*) Karrigen! (*Luki lë përdhe valixhen dhe shportën, bën përpara, hap karrigen, e vendos në tokë, zbrapset, merr përsëri valixhen dhe shportën. Po sheh karrigen*) Më afër! (*Luki lë valixhen dhe shportën, bën përpara e zhvendos karrigen, zbrapset, rimerr valixhen dhe shportën. Po ulet, mbështet majën e kamzbikut tek kraharori i Lukit dhe shtyn*) Zbrapsu! (*Luki zbrapset*) Akoma. (*Luki zbrapset edhe më*) Ndal! (*Luki ndalet; Vladimirit dhe Estragonit*) Prandaj, nëse më lejoni, po qëndroj pak me ju, para se të nisem prapë për udhë. (*Lukit*) Shportën! (*Luki bën përpara, i jep shportën, zbrapset*) Ajri i freskët të hap oreksin. (*Hap shportën, nxjerr një copë pulë, një copë bukë dhe një shishe verë. Lukit*) Shportën! (*Luki bën përpara, merr shportën, zbrapset dhe qëndron si i ngrirë*) Tutje! (*Luki zbrapset*) Atje! (*Luki ndalon*) Qelbet erë. (*Pi drejt e nga shishja*) Për shëndetin tonë! (*Lë shishen dhe fillon të hajë*)

*Qetësi. Estragoni dhe Vladimiri marrin zemër pak nga pak, vijnë rrotull Lukit, e shohin me vërejtje. Po ha si i limaksur copën e pulës, hedh kockat pasi i ka lëpirë mirë. Luki përkulet ngadalë derisa valixhja prek tokën, drejtohet përnjëherësh, përkulet sërisht. Si një njeri që fle në këmbë.*

ESTRAGONI: Çfarë ka ky?

VLADIMIRI: Duket i lodhur.

ESTRAGONI: Përse nuk i lë përtokë bagazhet?

VLADIMIRI: E ku ta di unë? (*I afrohen akoma*) Kujdes!

ESTRAGONI: Sikur t'i flisnim?

VLADIMIRI: Pa shiko?

ESTRAGONI: Çfarë?

VLADIMIRI: (*duke bërë me shenjë*) Qafën!

ESTRAGONI: (*duke parë qafën*) Nuk shoh gjë.

VLADIMIRI: Eja këtu.

*Estragoni vjen në vendin e Vladimirit.*

ESTRAGONI: Vërtet.

VLADIMIRI: Duket mish i gjallë.

ESTRAGONI: Është vendi i litarit.

*Duke pritur Godonë*

VLADIMIRI: Duke u fërkuar pas qafës.

ESTRAGONI: S'ke ç'i bën.

VLADIMIRI: Është vendi ku lidhet nyja.

ESTRAGONI: Është e pashmangshme.

*Ata fillojnë ta vështrojnë me vëmendje dhe përqedrohen te fytyra.*

VLADIMIRI: Nuk është i shëmtuar.

ESTRAGONI: *(duke ngritur supet dhe duke shtrembëruar buzët)* A thua?

VLADIMIRI: Është si femër.

ESTRAGONI: I varen jargët.

VLADIMIRI: Domosdo.

ESTRAGONI: Po shkumëzon.

VLADIMIRI: Mbase është idiot.

ESTRAGONI: Ndonjë budalla.

VLADIMIRI: *(duke zgjatur kokën)* Do të jetë i sëmure nga struma.

ESTRAGONI: *(duke vepruar si Vladimiri)* Nuk i dihet.

VLADIMIRI: I merret fryma.

ESTRAGONI: Është normale.

VLADIMIRI: Shiko sytë.

ESTRAGONI: Ç'i kanë sytë.

VLADIMIRI: I kanë dalë vendit.

ESTRAGONI: Për mua, ai po ngordh.

VLADIMIRI: S'i dihet *(kalon një çast)* Pa bëji një pyetje.

ESTRAGONI: Me tërë mend e ke?

VLADIMIRI: E ç'humbasim?

ESTRAGONI: *(me ndrojtje)* Zotëri...

VLADIMIRI: Ngrije zërin.

ESTRAGONI: *(më fort)* Zotëri...

POCO: Lëreni rehat! *(Ata kthehen nga Poco, që ka mbaruar së ngrëni dhe fshin buzët me kurrizin e dorës.)* Nuk e shihni se do të çlodhet? *(Nxjerr llullën dhe fillon ta mbushë. Estragoni shikon me zili kockat e pulës përdhe. Poco ndez një shkrepëse dhe më pas llullën)* Shportën! *(Luki nuk lëviz. Poco hedh fijen e shkrepes dhe me inat tërheq litarin)* Shportën! *(Luki gati sa s'bie, vjen në vete, bën përpara, fut shishen në shportë, kthehet në vendin e tij dhe merr qëndrimin e mëparshëm.)*

*Estragoni nuk ia ndan sytë kockave, Poco ndez prapë një fije shkrepëseje dhe ndez llullën*) Ç't'i bësh, kjo nuk është punë e tij. *(Thith llullën me afsh, zgjat këmbët)* Oh, tani jam më mirë.

ESTRAGONI: *(me ndrojtje)* Zotëri...

POCO: Ç'është, more trim?

ESTRAGONI: Ëë... nuk do t'i hani... ëë... nuk ju duhen... kockat... zotëri?

VLADIMIRI: *(i fyer)* Nuk prisje dot ti?

POCO: S'ka gjë, s'ka gjë, është e natyrshme. A më duhen kockat? *(I lëviz me majën e kamzhikut)* Jo, mua vetë nuk më duhen më. *(Estragoni bën një hap drejt kockave)* Por... *(Estragoni ndalon)* në parim kockat i takojnë atij që i mban. Duhet të pyesni atë! *(Estragoni kthehet nga Luki, ngurron)* Pyeteni, pyeteni, mos u druani, ai do t'ju përgjigjet!

*Estragoni shkon drejt Lukit, ndalet para tij.*

ESTRAGONI: Zotëri, më falni, zotëri...

*Luki nuk reagon. Poco përplas kamzhikun. Luki ngre kokën.*

POCO: Po të flasin, derr. Përgjigju. *(Estragonit)* Jepi, pyete.

ESTRAGONI: Më falni, zotëri, kockat, i doni kockat?

*Luki nuk ia ndan sytë Estragonit.*

POCO: *(i zbavitur sa s'bëhet)* Zotëri! *(Luki ul kryet)* Përgjigju. I do apo s'i do? *(Luki hesht. Estragonit)* Mund t'i merrni. *(Estragoni hidhet mbi kockat, i mbledh dhe fillon t'i brejë)* E çuditshme. Është hera e parë që s'i pranon kockat. *(Sheh i shqetësuar Lukin)* Se mos më bëjë ndonjë proçkë e të sëmurët. *(Thith llullën)*

VLADIMIRI: *(shpërthen)* Është turp!

*Qetësi. Estragoni, i shastisur, lë kockat dhe sheh sa Vladimirin sa Pocon. Poco shumë i qetë, Vladimiri gjithnjë e më shumë i zënë ngushtë.*

POCO: *(Vladimirit)* E keni fjalën për ndonjë gjë konkrete?

VLADIMIRI: *(i vendosur dhe duke iu marrë goja)* Ta trajtosh njeriun *(një gjest drejt Lukit)* në këtë mënyrë... kjo më duket... një qenie njerëzore... jo, ky është turp...

ESTRAGONI: *(duke mos dashur të mbetet pas)* Skandal! *(fillon të brejë kockat përsëri)*

POCO: Qenkeni të ashpër. *(Vladimirit)* Sa vjeç jeni, më falni për

pyetjen. (*Heshtje*) Gjashtëdhjetë?... Shtatëdhjetë? (*Estragonit*) Sa vjeç mund të jetë?

ESTRAGONI: Pyeteni vetë.

POCO: E teprova. (*Boshatis llullën duke e goditur pas kamzhikut, ngrihet*) Po ju lë. Falemnderit që më bëtë shoqëri. (*Mendohet*) Ta heq edhe një herë llullën me ju. Ç'thoni? (*Ata nuk flasin*) Oh, nuk pi shumë duhan, jo, nuk pi shumë, s'e kam zakon të pi dy llulla njëra pas tjetrës, (*vë dorën në zemër*) më jep rrahje zemre (*Heshtje për pak*) E ka fajin nikotina, e thithim, sado që bëjmë kujdes. (*Psherëtin*) Ç'të bësh? (*Heshtje*) Ju nuk e pini duhanin? E pini? Nuk e pini? Nejse, gjë pa rëndësi. (*Heshtje*) Po si të ulem tani që u ngrita? Si të ulem, si ta them, pa u përkulur? (*Vladimir*) Thatë gjë? (*Qetësi*) Mbase nuk keni thënë gjë? (*Heshtje*) S'ka rëndësi. Kështu... (*Mendohet*)

ESTRAGONI: Ah! Tani jam më mirë. (*bedh kockat*)

VLADIMIRI: Nisemi.

ESTRAGONI: Që tani?

POCO: Një sekondë! (*tërheq litarin*) Karrigen! (*Tregon me kamzhik. Luki zhvendos karrigen*) Akoma! Atje! (*Ulet. Luki zbrapset, merr valizhen dhe shportën*) Ja ku u ula përsëri (*fillon të mbushë llullën*)

VLADIMIRI: Nisemi.

POCO: Shpresoj se nuk po ikni prej meje. Rrini dhe pak, nuk do të pendoheni.

ESTRAGONI: (*duke nuhatur lëmoshën*) Kemi kohë.

POCO: (*ka ndezur llullën*) E dyta shijon gjithmonë më pak (*heq llullën nga goja dhe e kundron*) se e para, dua të them (*e vë llullën përsëri në gojë*) Megjithatë s'është e keqe.

VLADIMIRI: Unë po iki.

POCO: Ai nuk më duron dot më. Nuk jam dhe aq njerëzor, po pse arsye është kjo? (*Vladimir*) Mendohuni mirë sa s'keni bërë ndonjë të pabërë. Ta zëmë se do të niseni sa është ende ditë, se fundja ditë është akoma. (*Të tre shikojnë qiellin*) Bukuri. Po ikët... (*heq llullën nga goja, e sheh*)... qenka fikur (*e rindez*) Po ikët, si do t'ia bëni për të takuar atë Godonë... Godonë... Godinin. (*Heshtje*)... e kuptoni pra se ç'dua të them. Nga ky takim varet... (*Heshtje*)... e ardhmja juaj e afërt.



ESTRAGONI: Ka të drejtë.

VLADIMIRI: Nga e dini ju?

POCO: Ja që po më flet përsëri! Do të bëhemi miq në fund.

ESTRAGONI: Pse nuk i ul bagazhet ai?

POCO: Edhe unë do të desha ta takoja. Sa më shumë njerëz takoj, aq më i lumtur jam. Edhe nga njeriu më i parëndësishëm mëson diçka, fiton diçka, shijon më mirë lumturinë. Dhe vetë ju *(i sheh të dy me vëmendje, në mënyrë që ta kuptojnë se e ka me të dy)* ndoshta më mësuat diçka.

ESTRAGONI: Përse nuk i lë përtokë bagazhet ai?

POCO: Kjo do të më çudiste.

VLADIMIRI: Po ju bëjmë një pyetje.

POCO: *(i kënaqur)* Një pyetje? Kush po ma bën? Ç'pyetje? *(Qetësi)* Para pak çastesh po më thërrisnit zotëri, duke u dridhur. Tani po më bëni pyetje. Do të përfundojë keq kjo punë.

VLADIMIRI: *(Estragonit)* Më duket se po të dëgjon.

ESTRAGONI: *(vjen përsëri vërdallë Lukit)* Çfarë?

VLADIMIRI: Mund ta pyesësh tani! Ai po pret!

ESTRAGONI: Për çfarë ta pyes?

VLADIMIRI: Pse nuk i ul bagazhet.

ESTRAGONI: Edhe unë këtë po thosha me vete.

VLADIMIRI: Po pyete pra.

POCO: *(që i ka ndjekur në këtë bisedë me vëmendje dhe me ankth, duke patur frikë se mos pyetja shkon dëm)* Ju po më pyesnit përse ai nuk i lëshon në tokë bagazhet, apo jo?

VLADIMIRI: Tamam.

POCO: *(Estragonit)* Kjo është pyetja?

ESTRAGONI: *(duke u sjellë rreth Lukit)* Dihat si fokë.

POCO: Do t'ju përgjigjem. *(Estragonit)* Mos lëvizni, ju lutem, se më nervozoni.

VLADIMIRI: Eja këtu.

ESTRAGONI: Ç'është?

VLADIMIRI: Do të flasë. *(Pa lëvizur, pranë njëri-tjetrit, ata presin.)*

POCO: Shkëlqyeshëm. Këtu jeni të gjithë? Po më shihni të gjithë? *(sheh Lukin dhe tërbeq litarin, Luki ngre kokën)* Ngrije kokën, derr! *(Luki e sheh)* Bukuri! *(Vë llullën në xhep, nxjerr një spërkatëse dhe lag grykën, e fut spërkatësen në*

*xhep, kruan zërin, pështyn, nxjerr prapë spërkatësen, lag grykën, e vë në xhep*) Unë jam gati. Po më dëgjoni? (*shoh Lukin, tërbeq litarin*) Ec! (*Luki ecën*) Atje! (*Luki ndalet*) Jeni gati të gjithë? (*I shoh të tre, Lukin të fundit dhe tërbeq litarin*) Hë pra? (*Luki ngre kokën*) Nuk më pëlqen të flas në hava. Mirë. Fillojmë. (*Mendohet*)

ESTRAGONI: Po iki.

POCO: Si qe tamam pyetja?

VLADIMIRI: Pse...

POCO: (*i nevrikosur*) Mos më ndërprisni! (*Hesht një çast. Më i qetë*) Po folëm të gjithë njëherësh, s'do të nxjerrim gjë! (*Hesht një çast*) Ç'po thosha? (*Hesht një çast. Ngre zërin*) Ç'po thosha? (*Vladimiri bën sikur mban një peshë të rëndë mbi supe. Poco e shoh pa kuptuar gjë*)

ESTRAGONI: (*me forcë*) Bagazhet! (*tregon me gisht Lukin*) Pse? Gjithmonë i ngarkuar. (*bën sikur përkulet, duke gulçuar*) Asnjëherë nuk i ul. (*hap duart, drejton trupin i çliruar*) Pse?

POCO: E mora vesh. Duhet të ma kishit thënë më parë. Pse s'rehatohet? Të shohim si qëndron puna. Nuk ka të drejtë të çplodhet? Kjo është më e saktë. Po përse nuk do? (*hesht një çast*) Do t'jua them unë zotërinj.

VLADIMIRI: Kujdes.

POCO: E bën që të më prekë mua, që ta mbaj me vete.

ESTRAGONI: Si?

POCO: Ndoshta u shpreha keq. Rreket të më mallëngjejë që të mos ndahem prej tij. Jo, nuk është tamam kështu.

VLADIMIRI: Ju doni ta hiqni qafe?

POCO: Kërkon të ma hedhë, por unë s'e ha atë rreng.

VLADIMIRI: Doni ta hiqni qafe?

POCO: E gënjen mendja se duke qenë hamall i zoti do ta mbaj në punë edhe në të ardhmen.

ESTRAGONI: Nuk e doni më për hamall?

POCO: Në fakt, ai është si kalë, por s'e ka për zanat hama-llëkun.

VLADIMIRI: Ju doni ta hiqni qafe?

POCO: Ai pandeh se duke u treguar i palodhur, do më bëjë të pendohem për vendimin tim. Kaq ia pret rradakja. A thua se jam keq për hamall unë! (*Të tre shohin Lukin*) Atlas, o bir i

Jupiterit! (*Qetësi*) Kështu, pra. Mendoj se iu përgjigja pyetjes tuaj. A keni të tjera? (*Nxjerr spërkatësen*)

VLADIMIRI: Ju doni ta hiqni qafe?

POCO: Shikoni, mund të isha unë në vendin e tij, po ja që s'desh fati. Secilit hakun.

VLADIMIRI: Ju doni ta hiqni qafe?

POCO: Si thatë?

VLADIMIRI: Doni ta hiqni qafe?

POCO: I keni rënë pikës. Por në vend që ta dëboja, t'i jepja një shqelm bythës e ta nxirrja nga porta e jashtë, jam aq zemërmirë sa po e çoj në pazarin e Shën Shpëtimtarit, ku ma do mendja s'do dal pa gjë. Me thënë të drejtën, është e pamundur të dëbosh të tillë njerëz. E mira e të mirave është t'i vrasësh.

*Luki qan.*

ESTRAGONI: Ai po qan.

POCO: Qeni plak ka më dinjitet. (*I zgjat shaminë e tij Estragonit*) Ngushëllojeni, meqë ju dhimbset! (*Estragoni ngurron*) Merreni. (*Estragoni merr shaminë*) Fshijani lotët. Kështu s'do ta ndjejë veten krejt të braktisur.

*Estragoni mëdyshet.*

VLADIMIRI: Ma jep, se ia fshij unë. (*Estragoni nuk do t'ia japë shaminë dhe sillet si fëmijë*)

POCO: Jepini, shpejt! Pas pak s'do të derdhë më asnjë pikë lot. (*Estragoni i afrohet Luki dhe ulet t'i fshijë lotët. Luki i këput një shqelm në kërcij. Estragoni lëshon shaminë, kërcen prapa, i vjen skenës rrotull duke çaluar dhe duke ulëritur nga dhimbja*) Shaminë! (*Luki lë valixhen dhe çantën, merr shaminë, bën përpara dhe ia jep Pocos, zbrapset, merr përsëri valixhen dhe shportën*)

ESTRAGONI: Maskarai! Kafsha! (*Përvesh pantallonin*) Më dërrmoi!

POCO: Jua thashë që s'i honeps të huajt.

VLADIMIRI: (*Estragonit*) Dale ta shoh! (*Estragoni i tregon këmbën. I drejtohet Pocos me inat*) Po i rrjedh gjak!

POCO: Kjo është shenjë e mirë!

ESTRAGONI: (*duke ngritur këmbën e plagosur*) Nuk do të ec dot më!

VLADIMIRI: *(me dhembshuri)* Të mbaj unë. *(Hesht një çast)* Po qe nevoja.

POCO: Nuk po qan më. *(Estragonit)* Si të thuash, po qani ju në vend të tij, me pamje të përhumbur. Lotët e botës janë po ato. Kur dikush nis e qan këtu, një tjetër pushon diku gjetkë. E njëjta gjë si me të qeshurën. *(Qesh)* Të mos flasim keq për kohën tonë, ajo nuk është më e keqe se kohët e shkuara. *(Qetësi)* Por as të mos e lëvdojmë. *(Qetësi)* Më mirë të mos e zënë fare ngoje. *(Qetësi)* Është e vërtetë që popullsia është shtuar.

VLADIMIRI: Pa provo të ecësh.

*Estragoni nis të ecë duke çaluar, ndalon para Lukit dhe e pëshqytyn, pastaj shkon e ulet atje ku ishte para se të hapej perdja.*

POCO: E dini kush m'i ka mësuar gjithë këto gjëra të bukura? *(Hesht një çast. Tregon me gisht Lukin)* Ai!

VLADIMIRI: *(duke vështruar qiellin)* S'paska ndërmend të erret sonte?

POCO: Po të mos ishte ai, do kisha menduar e ndjerë veç gjëra të ulëta që kanë të bëjnë me zanatin tim prej – pak rëndësi ka. Bukuria, hiret, e vërteta e kulluar më dukeshin të paarrishme... pak rëndësi ka... më dukeshin të pakapshme. Ahere mora një sejmen.

VLADIMIRI: *(pa dashje, pushon së pyeturi qiellin)* Një sejmen?

POCO: Kjo histori ka gjashtëdhjetë vjet... *(llogarit me mend)* po, po, së shpejti bëhen 60. *(Duke u krekosur)* Nuk e tregoj moshën, apo jo? *(Vladimiri shikon Lukin)* Pranë tij dukem si djalosh, pse jo? *(Pauzë. I drejtohet Lukit)* Kapelen! *(Luki ul shportën, merr kapelen. Një floknajë e dendur e thinjur, i bie në fytyrë. E vë kapelen nën sqetull dhe merr prapë shportën)* Tani shikoni! *(Poco heq kapelen<sup>1</sup>. Ai është tullë fare. E vë sërisht kapelen)* E patë?

VLADIMIRI: Ç' do të thotë sejmen?

POCO: Nuk qenkeni nga këto anë. A jeni të këtij shekulli, të paktën? Dikur mbanin gaztorë. Tani mbajnë sejmenë. Ata që ua mban xhepi, sigurisht.

VLADIMIRI: Dhe po e përzini tani? Një copë plak, një shërbëtor kaq besnik.

ESTRAGONI: Plehër!

1. Të gjithë personazhet mbajnë kapele të rrumbullakët.

*Poco gjithnjë e më i shqetësuar.*

VLADIMIRI: Pasi ia thithët edhe palcën, e flakët tej si një...  
(*kërkon fjalën...*) si një lëkurë bananeje. Pranoje që...

POCO: (*duke rënkuar, duke vënë duart në kokë*) Nuk mundem më... nuk duroj dot më... se ç'bën ai ju nuk e dini... është e tmerrshme... ai duhet të ikë... (*Ngre lart e tund kërcënueshëm krahët*)... po çmendem (*shembet përdhe dhe fsheh kryet nën krahë*) Nuk mundem më... nuk mundem më.

*Qetësi. Të gjithë shohin Pocon. Luki dridhet.*

VLADIMIRI: Ai s'mban më.

ESTRAGONI: Është e tmerrshme.

VLADIMIRI: Ai po çmendet.

ESTRAGONI: Të kall krupën.

VLADIMIRI: (*Lukit*) Si guxoni? Turp! Një padron kaq të mirë!

Ta bësh të vuajë kështu! Pas kaq vitesh! S'e marr vesh!

POCO: (*duke qarë me dënësë*) Dikur... ishte i sjellshëm... më ndihmonte... më zbaviste... falë tij isha më i mirë... tani... po më vret.

ESTRAGONI: (*Vladimirit*) Mos ka ndërmend ta zëvendësojë.

VLADIMIRI: Si?

ESTRAGONI: S'po e marr vesh, do ta zëvendësojë Lukin, apo s'do më tjetër njeri në vend të tij.

VLADIMIRI: Nuk e besoj.

ESTRAGONI: Si?

VLADIMIRI: Nuk e di.

ESTRAGONI: Ta pyesim.

POCO: (*i qetësuar*) Zotërinj, nuk e di se ç'më hipi. Ju kërkoi ndjesë. Harrojini të gjitha. (*Sa vjen e e mbledh veten*) Nuk mbaj mend mirë ç'thashë, por ju siguroj se s'ka asgjë të vërtetë në këtë mes. (*Drejton trupin, i bie gjoksit*) Mos kam gjë pamjen e njeriut që ia plasin buzën? Ç'ne more. (*Kërkon në xhepa*) Ç'e bëra llullën?

VLADIMIRI: Mbrëmje e mrekullueshme!

ESTRAGONI: E paharruar.

VLADIMIRI: Dhe s'ka mbaruar ende.

ESTRAGONI: Sigurisht që s'ka mbaruar.

VLADIMIRI: Tani sapo filloi.

ESTRAGONI: Është e tmerrshme.

VLADIMIRI: Krejt si në shfaqje.

ESTRAGONI: Si në cirk.

VLADIMIRI: Në «music-hall».

ESTRAGONI: Në cirk.

POCO: Po ç'e bëra atë dreq llulle?

ESTRAGONI: Na shkriu! Ka humbur çibukun! (*Qesh zburmshëm*)

VLADIMIRI: Erdha! (*Drejtohet nga prapaskena*)

ESTRAGONI: Në fund të korridorit, majtas.

VLADIMIRI: Më ruaj vendin. (*Del*)

POCO: Më ka humbur Abdullai!

ESTRAGONI: (*shkrihet së qeshuri*) Na shkuli gazit!

POCO: (*ngre kokën*) Mos jua zuri gjë syri? (*Vë re që Vladimiri ka ikur. I pikëlluar*) Oh! Paska ikur!... Pa më thënë mirupafshim. Kjo nuk është e hijshme! Duhet ta kishit ndalur.

ESTRAGONI: U ndal vetë ai.

POCO: Oh! (*Hesht një copë herë*) Sa mirë!

ESTRAGONI: (*ngrihet*) Ejani këtej.

POCO: E përse?

ESTRAGONI: Do ta shihni vetë.

POCO: Vërtet doni që të ngrihem.

ESTRAGONI: Ejani... ejani... shpejt.

*Poco ngrihet dhe shkon drejt Estragonit.*

ESTRAGONI: Shikoni.

POCO: Uaa. Uaa.

ESTRAGONI: Kaq ishte.

*Vladimiri kthehet, i ngrysur, i jep një të shtyrë Lukit, rrëzon karrigen me shqelm, vete e vjen i shqetësuar.*

POCO: Nuk është i kënaqur?

ESTRAGONI: Sa keq, s'e ke idenë se ç'mrekullira humbe.

*Vladimiri ndalet, drejton karrigen, nis përsëri ecejaken e tij, më i qetë.*

POCO: Po qetësohet! (*Shikon përçark*) Le që, gjithçka po qetësohet, e ndiej. Paqja po zbret. Dëgjoni. (*Ngre dorën*) Gjithësia po fle.

VLADIMIRI: (*duke qëndruar në vend*) S'ka ndërmend të ngryset sonte?

*Të tre shohin qiellin.*

POCO: Nuk doni të ikni pa rënë nata?

- ESTRAGONI: Domethënë... E kuptoni...
- POCO: Është e natyrshme, krejt e natyrshme. Po të isha në vend tuaj e të kisha takim me Godinin... Godenë... Godonë, e kuptoni se ç'dua të them, do të prisja sa të bëhej natë pus pa të ikja. (*Sheh karrigen*) Do të doja të ulesha, po s'di se si.
- ESTRAGONI: Mund t'ju ndihmoj?
- POCO: Ndoshta, po të më kërkonit...
- ESTRAGONI: Çfarë?
- POCO: Të më kërkonit të ulesha përsëri?
- ESTRAGONI: Kjo do t'ju ndihmonte?
- POCO: Ma do mendja po.
- ESTRAGONI: Fillojmë pra. Zotëri, uluni ju lutem.
- POCO: Jo, jo, s'ka gjë. (*Hesht një çast. Me zë të ulët*) Këmbëngulni një çikë.
- ESTRAGONI: Dale, mos qëndroni në këmbë kështu, do të ftoheni.
- POCO: Vërtet?
- ESTRAGONI: Pa as më të voglin dyshim.
- POCO: Keni të drejtë. (*Ulet*) Falemnderit i dashur. Ja ku u ula (*Estragoni ulet sërish. Poco shikon orën.*) Tani më duhet t'ju lë shëndenë, ndryshe do të më vejë vonë.
- VLADIMIRI: Koha nuk ecën fare.
- POCO: (*duke vënë orën te veshi*) Nuk është ashtu zotëri. Nuk është ashtu. (*E vë orën në xhеп*) Mund të thoni ç'të doni, por këtë jo.
- ESTRAGONI: (*Pocos*) Atij çdo gjë i duket e zezë sot.
- POCO: Veç kupa qiellore jo. (*Qesh i kënaqur që gjeti një shprehje të goditur*) Durim, se do të nxihet edhe ajo. E mora vesh si qëndron puna, ngaqë s'jeni nga këto anë s'e keni idenë se ç'do të thotë muzg këtej nga anët tona. Doni t'jua them unë? (*Heshtje. Estragoni dhe Vladimiri kanë filluar të këqyrin njëri këpucën dhe tjetri kapelen. Lukit i bie kapelja, por ai as që e ndjen*) Dua t'jua sqaroj deri më një. (*nxjerr spërkatësen*) Këtu mendjen, ju lutem. (*Estragoni dhe Vladimiri vazhdojnë avazin e tyre, Luki aty fle, aty zgjohet. Poco përplas kamzhikun, që bën fare pak zhurmë*) Ç'dreqin ka ky kamzhik? (*Ngrihet dhe e përplas më fort, dhe kësaj here me sukses. Luki hidhet përpyjetë. Estragonit i bie këpuca nga dora,*

*Vladimirit i bie kapelja. Poco flak tej kamzhikun*) S'vlen më një grosh ky kamzhik. Ç'po thosha?

VLADIMIRI: Eja të ikim.

ESTRAGONI: Mos rrini në këmbë pra, do merrni ndonjë plevit.

POCO: Keni të drejtë. (*Ulet. Estragonit*) Si ju quajnë?

ESTRAGONI: (*aty për aty*) Katul.

POCO: (*që nuk e ka dëgjuar*) Ah po, nata. (*Ngre kokën*) Këtu pra mendjen, përndryshe nuk nxjerrim dot gjë në dritë. (*Sheh qiellin*) Shikoni. (*Të gjithë shikojnë qiellin, me përjashtim të Lukit që dremit; Pocoja e sheh dhe tërheq litarin*) Do ta shohësh qiellin, mor derr! (*Luki ngre kokën*) Mirë, kaq, mjafton! (*Ata ulin kryet*) E ç'paska kaq të jashtëzakonshme ky qielli? Është pa ngjyrë dhe i ndritshëm, si çdo qiell tjetër në këtë orë të ditës. (*Hesht një hop*) Në këto vise! (*Hesht një çast*) Kur është kohë e bukur. (*Zëri i bëhet më melodioz*) Vjen një orë (*Sheh orën, ton prozaik*) aty rreth (*mëdyshet, tani ulet*) orës dhjetë të mëngjesit (*toni përsëri lirik*) kur qielli, që na ka hedhur (*toni ngrihet*) pa u lodhur lumenj drite të kuqe e të bardhë, nis e humb shkëlqimin, zbehet (*duart ulen poshtë gradualisht*) gjithnjë e më shumë, gjersa (*ton dramatik, krabët hapen shumë horizontalisht*) bam! S'ka më! Nuk luan më vendit. (*Heshtje*) Por (*ngre dorën me një gjest paralajmërues*) – por pas kësaj velloje butësie e qetësie, (*ngre sytë nga qielli, të tjerët e imitojnë me përjashtim të Lukit*) nata rend me të katra, (*zëri bëhet më i thekshëm*) ajo dhe vjen e lëshohet mbi ne (*kërcet gishtat*) pëëf! ja kështu (*s'ka më frymëzim*) tamam kur nuk e presim. (*Qetësi, zë i trishtuar*) Ja kështu ndodh në këtë botë të poshtër.

*Heshtje e gjatë.*

ESTRAGONI: Po kur e di që më parë...

VLADIMIRI: Mund të presësh.

ESTRAGONI: Di se ç'duhet të bësh.

VLADIMIRI: S'ke pse shqetësohesh.

ESTRAGONI: Veç duhet të presësh.

VLADIMIRI: Ja kemi marrë dorën pritjeve ne. (*Merr kapelen, sheh brenda, e shkund, e vë*)

POCO: Si ju dukem? (*Estragoni dhe Vladimiri e shikojnë pa kuptuar gjë*) Mirë? Çka? Kalueshëm? Njëfarësoj? Beterr fare?



VLADIMIRI: (*e kupton i pari*) Oh, shumë mirë, goxha mirë.

POCO: (*Estragonit*) Po juve zotëri?

ESTRAGONI: (*me theks anglez*) Oh, shumë mirë, shumë, shumë mirë.

POCO: (*me vrull*) Falemnderit, zotërinj. (*Hesht një kobë*) Kam shumë nevojë për një fjalë të mirë. (*Mendohet*) Sikur e prissha një çikë, aty nga fundi. Nuk e vutë re?

VLADIMIRI: Oh, ndoshta fare pak.

ESTRAGONI: Kujtova se e bëtë me qëllim.

POCO: E ka fajin kujtesa ime e dobët.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: S'po ndodh hiçgjë.

POCO: (*i dëshpëruar*) U mërzitët?

ESTRAGONI: Shumë.

POCO: (*Vladimirit*) Po ju zotëri?

VLADIMIRI: S'shtyhet fare.

*Qetësi. POCO jep e merr me veten.*

POCO: Zotërinj, ju u treguat... (*kërkon fjalët*) të njerëzishëm me mua.

ESTRAGONI: Ç'ne!

VLADIMIRI: Ç'është ajo fjalë?

POCO: Po, po, ju u sollët aq mirë. Ndaj pyes veten... Po unë, ç'mund të bëj për këta njerëz të mirë që po mërziten?

ESTRAGONI: Edhe ndonjë grosh s'do të ishte keq.

VLADIMIRI: Nuk jemi lypsarë ne.

POCO: Ç'mund të bëj, thashë me vete, të mos u duket dita vit? U dhashë kocka, s'u lashë gjë pa treguar, u shpjegova si bie muzgu, për këtë ishim marrë vesh. Dhe s'po i përmend të gjitha. Po a mjafton vetëm kaq? Kjo po më torturon... A mjafton vallë?

ESTRAGONI: Sikur njëqind grosh të na jepnit.

VLADIMIRI: Qepe.

ESTRAGONI: I hyra kësaj pune tani.

POCO: A kam bërë sa duhet? Pa dyshim! Por unë jam zemërgjerë. Ja që kështu jam. Sot për sot aq më keq për mua. (*Tërheq litarin. Luki e shikon*) Sepse e di që do të vuaj, është e sigurt. (*Pa u ngritur, përkulet e merr kamzhikun*) Çfarë do t'ju pëlqente më shumë? Doni që të kërcejë, të këndoje, të mendoje, të...

ESTRAGONI: Kush?

POCO: Kush! A dini të mendoni ju?

VLADIMIRI: Pse, mendon ai?

POCO: Në mënyrë të përsosur. Me zë. Dikur mendonte gjëra të bukura, mund ta dëgjoja për orë të tëra. Tani... (*Dridhet*) Në fund të fundit, aq më keq për të. A doni që të mendojë diçka për ne?

ESTRAGONI: Më mirë të kërcente. Do të zbavitëshim më shumë.

POCO: S'është e thënë.

ESTRAGONI: Si thua ti Didi, nuk do të ishte më zbavitëse?

VLADIMIRI: Do të më pëlqente ta dëgjoja kur mendon.

ESTRAGONI: A mundet të kërcejë njëherë e pastaj të mendojë? Apo mos po e teprojmë?

VLADIMIRI: (*Pocos*) Si thua, e bën dot?

POCO: Ta pret mendja, s'ka gjë më të thjeshtë. Le që ai kështu bën gjithmonë. (*Qesh një hop*)

VLADIMIRI: Le të kërcejë atëhere.

*Heshtje.*

POCO: (*Lukit*) E more vesh?

ESTRAGONI: S'di të thotë ndonjëherë jo ky?

POCO: Një sekondë, se jua shpjegoj unë. (*Lukit*) Kërce, more pis!

*Luki lëshon valixhen dhe shportën, bën përpara drejt paraskenës, kthehet për nga POCOja. Estragoni ngrihet për të parë më mirë. Luki kërcen. Ndalet.*

ESTRAGONI: Kaq ishte?

POCO: Edhe një herë!

*Luki përsërit po ato lëvizje, ndalet.*

ESTRAGONI: Mirë miku im! (*Imiton lëvizjet e Lukit*) Këtë e bëj edhe unë. (*Imiton, për pak sa s'bie, ulet sërish*) Me pak stërvitje.

VLADIMIRI: U lodh.

POCO: Dikur kërcente farandolën, vallet arabe, fandangon andaluziane. E ç'nuk kërcente. Hidhej përpjetë. Tani vetëm kaq bën. E dini se si e quan këtë lloj valleje?

ESTRAGONI: Vdekja e llambëndezësit.

VLADIMIRI: Kanceri i pleqve.

POCO: Vallja e rrjetës. Atij i duket sikur është ngatërruar në një rrjetë.

VLADIMIRI: (*me spërdredhje prej esteti*) Ka diçka...

*Luki bëhet gati të kthehet te ngarkesat e tij.*

POCO: (*sikur i drejtohet kalit*) Yaaa!

*Luki ndalet në vend.*

ESTRAGONI: S'di të thotë ndonjëherë jo ky?

POCO: Do t'jua shpegoj edhe këtë. (*Kërkon nëpër xhepa*) Prisni! (*Kërkon*) Ç'e bëra spërkatësen? (*Kërkon*) E po kjo! (*Ngre kokën i shastisur. Me zë të mekur*) E humba spërkatësen!

ESTRAGONI: (*me një fije zëri*) Mushkërinë e majtë e kam copë. (*Kollitet lehtas. Me zë shpues*) Po mushkërinë e djathtë e kam top fare, ama!

POCO: (*me zë normal*) S'ke ç'i bën. Do të bëj si të bëj edhe pa të. Ç'po thosha? (*Mendohet*) Prisni! (*Mendohet*) Ta hajë dreqi! (*Ngre kokën*) Hë pra, më ndihmoni!

ESTRAGONI: Po përpiqem.

VLADIMIRI: Edhe unë.

POCO: Prisni. (*të tre kanë vënë dorën në ballë, përqendrohen të shtrembëruar në fytyrë. Heshtje e gjatë*)

ESTRAGONI: (*triumfues*) Ah!

VLADIMIRI: E gjeti.

POCO: (*me padurim*) Hë pra, nxirre.

ESTRAGONI: Pse s'i ul ato bagazhe ai?

VLADIMIRI: Po jo, more, jo!

POCO: A jeni i sigurt!

VLADIMIRI: Si jo, këtë na e thatë qëparë.

POCO: Jua thashë?

ESTRAGONI: Na e tha?

VLADIMIRI: Le që, ai i ka lëshuar përtokë.

ESTRAGONI: (*i hedh një vështrim Lukit*) Vërtet, i paska lënë përdhe. Po pastaj?

VLADIMIRI: Përderisa ai i ka ulur bagazhet, është e pamundur që ne të paskeshim pyetur pse nuk i lë përdhe.

POCO: Fjalë me mend!

ESTRAGONI: Po pse i ka lënë përdhe?

POCO: Hë pra, pse.

VLADIMIRI: Që të kërcejë.

ESTRAGONI: Ke të drejtë.

*Heshtje e gjatë.*

ESTRAGONI: *(duke u ngritur)* Asgjë s'po ndodh. As vete as vjen njeri. Kjo është e tmerrshme.

VLADIMIRI: *(Pocos)* I thoni të mendojë.

POCO: Jepini kapelen.

VLADIMIRI: Kapelen?

POCO: Ai nuk mendon dot pa kapele.

VLADIMIRI: *(Estragonit)* Jepi kapelen.

ESTRAGONI: Unë? Pas atij shqelmi? Kurrë!

VLADIMIRI: Ia jap vetë. *(Nuk lëviz)*

ESTRAGONI: Ta marrë vetë.

POCO: Është më mirë t'ia japin.

VLADIMIRI: Po ia jap unë.

*Merr kapelen dhe ia zgjat Lukit. Luki s'luan vendit.*

POCO: Duhet t'ia vësh në kokë.

ESTRAGONI: *(Pocos)* I thoni ta marrë.

POCO: Është më mirë t'ia vësh.

VLADIMIRI: Mirë, po ia vë unë.

*I vjen rrotull Lukit me kujdes, afrohet nga prapa, ia vë kapelen në kokë dhe zbrapset menjëherë. Luki nuk luan vendit. Qetësi.*

ESTRAGONI: Ç'pret ky?

POCO: Largohuni. *(Estragoni dhe Vladimiri largohen nga Luki. Poco tërbeq litarin. Luki e sheh)* Mendo, derr! *(Luki fillon të kërcëjë)* Ndal! *(Luki ndalet)* Ec përpara! *(Luki shkon drejt Pocos)* Aty! *(Luki ndalet)* Mendo! *(Kalon një çast)*

LUKI: Nga ana tjetër, përse i përket...

POCO: Ndal! *(Luki hesht)* Prapa kthehu! *(Luki zbrapset)* Aty! *(Luki ndalet)* Hya! *(Luki kthehet nga publiku)* Mendo!

LUKI: *(me ritëm monoton)* Meqë ekziston, ashtu siç del nga punimet e fundit publike të Puansonit dhe të Vatmanit një Zot vetjak kuakuakuakua me mjekër të bardhë kuakua jashtë kohës hapësirës që nga maja e apatisë së tij hyjnore e atambisë së tij hyjnore e afazisë së tij hyjnore na do të gjithëve me pak përjashtime nuk dihet përse por kjo ndodh dhe vuan në shembullin e hyjnoses Miranda me ata që janë nuk dihet përse por kemi kohë në vuajtje në zjarre – në zjarret e të cilëve flakët që sikur të zgjatnin edhe pak s'ka pikë dyshimi do

Vladimiri dhe Estragoni shumë të vëmendshëm. Poco i lodhur e i pështirosur.

të dilnin majë çatisë dhe sa për dijeni do ta ngrinin ferrin në qiejt që ende sot hera-herës janë kaq të kaltër e kaq të qetë, të qetë me një qetësi që ndonëse e paqëndrueshme është e mirëpritur, por le të mos ngutemi dhe meqë nga ana tjetër sipas përfundimeve të kërkimeve të papërfunduara të mos flasim para kërkimeve të papërfunduara por megjithatë të kurorëzuara nga Akkakakademia e Antropopometrisë në Bernë-an-Bresë të Testysë dhe Konardit është provuar shumë saktësi me përjashtim të ndonjë gabimi që lidhet me përllogaritetet njerëzore që përpos kërkimeve të papërfunduara të Testysë dhe Konardit është provuar vuar vuar si vijon vijon më poshtë sa përtaditur, por të mos ngutemi s'dihet përse pas punimeve të Puansonit dhe Vatmanit duket sheshit, po aq qartë sa në punimet e Fartovit dhe Belsherit të papërfunduara të papërfunduara nuk dihet përse të Testysë dhe Konardit të papërfunduara të papërfunduara duket se njeriu në kundërshtim me opinionin e kundërt se njeriu në Bresë të Testysë dhe Konardit se njeriu në fund të fundit që njeriu shkurt që me një fjalë njeriu, megjithë progresin në sferën e ushqimit dhe të eliminimit të mbeturinave po dobësohet dhe njëkohësisht nuk dihet përse megjithë zhvillimin e kulturës fizike të praktikës së sporteve si si si tenisi futbollit vrapimi çiklizmi noti garat me kuaj avacioni tenisi patinazhi në asfalt dhe në akull tenisi aviacioni sportet sportet e dimrit të verës të vjeshtës të vjeshtës tenisi në lëndinë në degë të fikut në tokë të fortë aviacioni tenisi hokei në tokë në det dhe në ajër penicilina dhe surrugatot shkurt po nis përsëri paralelisht në të njëjtën kohë të zvogëlojmë s'dihet pse megjithë tenisit po marr aviacionin golfin me nëntë dhe tetëmbëdhjetë vrima tenisit në akull nuk dihet përse në Senë Senë dhe Uazë Senë dhe Marnë Marnë dhe Uazë sa për dijeni njëherësh paralelisht s'dihet përse të dobësohesh të tretësh po rimarr Uazë Marnën shkurt humbja e pariparueshme në njerëz që prej vdekjes së Volterit duke qenë dy gisht njëqind gram për njeri afërsisht mesatarisht afërsisht shifra të rumbullakosura një peshë neto në Normandi nuk dihet pse shkurt s'ka rëndësi faktet ja ku janë dhe duke parë nga ana tjetër ajo çka është ku e ku më e rëndë që del në pah çka

Vuajtja e Pocos sa vjen e rritet. Dëgjohej murmurimat e para të Vladimirit e Estragonit

Vladimiri dhe Estragoni qetesohen dhe fillojnë përsëri të dëgjojnë. Pocos se zë vendi, lëviz sa andej-këndej, dëgjohej rënkime të tij

është më e rëndë në dritën në dritën e përvojave në leksionet e Steinvegut dhe Petermanit del se ajo që është më e rëndë që del në pah ajo që është më e rëndë në dritën e përvojave të braktisura të Steinvegut dhe Petermanit që në fshat në mal dhe në breg të detit dhe në ujë në zjarr ajër është e njëjta gjë dhe toka që ta dini ajri dhe toka kur bën ftohtë ajri dhe toka të bërë për gurët në mot të ftohtë medet në erën e tyre të shtatë eteri toka deti për gurët në kohë të ftohtë mbi det mbi tokë po rikujtoj nuk dihet pse megjithë tenis faktet ja ku janë nuk dihet pse po kaloj tek tjetri shkurt në fund të fundit medet tjetri për gurët kujt mund t'i shkojë mendja por të mos flasim para kohe po rikujtoj koka në të njëjtën kohë paralelisht dihet përse megjithë tenis tjetri mjekra flakët lotët gurët kaq blu kaq të qeta medet koka koka koka në Normandi megjithë tenis punimet e lënapasdore të papërfunduara më e rënda gurët shkurt po e përmend përsëri medet medet të lëna pas dore të papërfunduara koka koka në Normandi megjithë tenis koka sa keq gurët Konard Konard... *(Përleshje, Luki lëshon ende disa ulërime)* Tenis!... gurët!... Kaq të qeta!... Konard!... Të papërfunduara!...

Thirrje cudie të Vladimirit e të Estragonit. Poco ngrihet pupthi e tërheq litarin. Të gjithë bërtasin. Luki tërheq litarin, pengohet, ulërin. Të gjithë hidhen mbi Lukin që u bën ballë dhe e reciton tekstin duke ulëritur.

POCO: Kapelen!

*Vladimiri kap kapelen e Lukit, që hesht e rrëzohet. Qetësi e thellë. Dihatje të fitimtarëve.*

ESTRAGONI: M'u mor haku.

*Vladimiri kundron kapelen e Lukit, e sheh nga brenda.*

POCO: Ma jep mua! *(ia tërheq kapelen nga duart Vladimirit, e hedh përtokë dhe e shkel)* Le të mendojë tani po deshi!

VLADIMIRI: Po tani, si do t'ia bëjë për t'u orientuar?

POCO: E orientoj unë! *(I fut ca shqelma Lukit)* Çohu! Derr!

ESTRAGONI: Mbase ka vdekur.

VLADIMIRI: Do ta vrisni.

POCO: Çohu! Qelbanik! *(Tërheq litarin, Luki rrëshqet një çikë. Estragonit dhe Vladimirit)* Më ndihmoni, ç'prisni?

VLADIMIRI: Po si?

POCO: Çojeni peshë!

*Estragoni dhe Vladimiri e ngrenë Lukin në këmbë, e mbajnë një çast, pastaj e lëshojnë. Ai bie përsëri.*

ESTRAGONI: E bën vetë.

POCO: Duhet ta mbani. (*Kalon një kohë*) Hajt, jepini, ngrijeni peshë!

ESTRAGONI: Mjaft më! Mua më erdhi në majë të hundës.

VLADIMIRI: Hajt, ta provojmë edhe një herë.

ESTRAGONI: Për kë na merr ky ne?

VLADIMIRI: Hopa.

*E ngrenë Lukin në këmbë, e mbajnë.*

POCO: Mos e lëshoni! (*Estragonit dhe Vladimirit i merren këmbët*) Mos lëvizni! (*Poco shkon të marrë valixhen dhe shportën dhe i shpie te Luki*) Mbajeni mirë! (*Ia vë valixhen në dorë Lukit, i cili e lëshon menjëherë*) Mos e lëshoni! (*Rifillon pak nga pak, duke prekur valixhen, Luki rimerr veten dhe gishtat e tij pak nga pak shtrëngojnë dorezën e valixhes*) Mbajeni, akoma. Mos e lëshoni! (*Në të njëjtën mënyrë vepron edhe me shportën*) Tani mund ta lëshoni. (*Estragoni dhe Vladimiri largohen nga Luki që pengohet, i merren këmbët, përkulet, por qëndron në këmbë me valixhen dhe shportën në dorë. Poco zbrapset, përplas kamzhikun*) Para marsh! (*Luki bën përpara*) Prapësohu! (*Luki zbrapset*) Kthehu! (*Luki kthehet*) Në rregull, mund të ecë. (*Duke iu drejtuar Estragonit dhe Vladimirit*) Falemnderit zotërinj, dhe më lejoni - (*kërkon në xhepa*) t'ju uroj - (*kërkon*) t'ju uroj (*rrëmon*) po ku e lashë orën? (*kërkon*) Ta hajë dreqi! (*Ngre kokën, i prisbur në fytyrë*) Një goxha sahat me kapak, zotërinj, me akrep edhe për sekondat! Ma pat dhënë babagjyshi. (*kërkon*) Do të më ketë rënë. (*Kërkon përtokë, po kështu edhe Vladimiri dhe Estragoni. Poco trazon me këmbë mbeturinat e kapeles së Lukit*) E po kjo pikë e zezë!

VLADIMIRI: Mos e keni në xhepin e jelekut?

POCO: Prisni! (*Përthyyhet më dysb, afron kokën te barku, mban vesh*) Nuk dëgjoj gjë. (*U bën shenjë të afrohen*) Ejani të shihni. (*Estragoni dhe Vladimiri shkojnë drejt tij, përkulen mbi barkun e tij. Qetësi*) Duhej të dëgjonim tik-takun.

VLADIMIRI: Qetësi!

*Të gjithë dëgjojnë të përkulur.*

ESTRAGONI: Seç po dëgjoj.

POCO: Ku?

VLADIMIRI: Është zemra.

POCO: (*i zhgënjyer*) Ta marrë dreqi!

VLADIMIRI: Qetësi!

*Ata mbajnë vesh.*

ESTRAGONI: Mbase ora ka ngelur.

*Drejtojnë trupin.*

POCO: Cili prej jush kutërbon kështu?

ESTRAGONI: Atij i qelbet erë goja, kurse mua këmbët.

POCO: Tani po ju lë.

ESTRAGONI: Po sahatin?

POCO: Do ta kem lënë në kështjellë.

ESTRAGONI: Atëherë lamtumirë.

POCO: Lamtumirë.

VLADIMIRI: Lamtumirë.

ESTRAGONI: Lamtumirë.

*Heshtje. Askush s'luan vendit.*

VLADIMIRI: Lamtumirë.

POCO: Lamtumirë.

ESTRAGONI: Lamtumirë.

*Qetësi.*

POCO: Dhe falemnderit.

Vladimiri. Falemnderit prej jush.

POCO: S'ka përse.

ESTRAGONI: Ka që çke me të.

POCO: S'ka përse.

VLADIMIRI: Ka që çke me të.

ESTRAGONI: S'ka përse.

*Qetësi.*

POCO: S'më bëjnë këmbët të iki.

ESTRAGONI: I ka jeta këto.

*Poco kthehet, largohet nga Luki, ecën drejt prapaskenës, ndërkohë që zhdredh litarin.*

VLADIMIRI: Po ngatërroji rrugën.

POCO: Duhet të marr vrull. (*Ka arritur te prapaskena, e ka tendosur litarin, ndalet, kthehet, bërtet*) Largohuni! (*Estragoni dhe Vladimiri shkojnë në fund, shohin Pocon. Dëgjohet zhurma e kamzhikut*) Ec përpara! (*Luki nuk lëviz*)

ESTRAGONI: Para marsh!

VLADIMIRI: Para marsh!



*Zhurme kamzhiku, Luki lekundet.*

ESTRAGONI: Ec para!

VLADIMIRI: Ec para!

*Zhurme kamzhiku. Luki nis te ecë.*

POCO: Më shpejt! *(Del nga prapaskena, pershkon skenën duke ndjekur pas Lukin. Shfaqen Estragoni dhe Vladimiri që përshëndesin me dorë. Luki del nga skena. Poco Përplas litarin dhe kamzhikun)* Më shpejt! Më shpejt! *(Para se të dalë nga skena, Poco kthehet. Litari tendoset. Dëgjohet zhurma e Lukit që bie)* Dua karrigen time! *(Vladimiri shkon ta kërkojë dhe ia jep Pocos, i cili ia hedh Lukit)* Lamtumirë!

ESTRAGONI, VLADIMIRI: *(duke tundur dorën)* Lamtumirë! Lamtumirë!

POCO: Çohu! Derr! *(Dëgjohet zhurma e Lukit që ngrihet)* Ec përpara! *(Poco del nga skena. Dëgjohet zhurma e kamzhikut)* Përpara! Lamtumirë! Më shpejt! Derr! Hya! Lamtumirë!

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Prej tij koha na kaloi pa u kuptuar.

ESTRAGONI: Koha do të kishte kaluar edhe pa të.

VLADIMIRI: Po, por më ngadalë ama.

*Kalon një çast.*

ESTRAGONI: Ç' do bëjmë tani?

VLADIMIRI: Nuk e di.

ESTRAGONI: Të ikim që këtej.

VLADIMIRI: Nuk mundemi.

ESTRAGONI: Përse?

VLADIMIRI: Po presim Godonë.

ESTRAGONI: Ke të drejtë.

*Kalon një çast.*

VLADIMIRI: Paskan ndryshuar shumë.

ESTRAGONI: Kush?

VLADIMIRI: Ata të dy atje.

ESTRAGONI: Bukuri, le të bëjmë pak muhabet.

VLADIMIRI: Pse, a s'kanë ndryshuar?

ESTRAGONI: Ka shumë të ngjarë. Vetëm ne s' do të ndryshojmë kurrë.

VLADIMIRI: Ka të ngjarë the? Është e sigurt. I pe mirë?

ESTRAGONI: I pashë, si s'i pashë, po unë nuk i njoh.

VLADIMIRI: I njeh që ç'ke me të.

ESTRAGONI: Nuk i njoh, jo.

VLADIMIRI: I njohim po të them. Ti s'mban mend fare. (*Hesht një çast*) Vetëm në mos qofshin ata.

ESTRAGONI: Është fakt që ata s'na njohën.

VLADIMIRI: S'do të thotë gjë. Edhe unë bëra sikur nuk i njoha. Le që, kush na njeh ne.

ESTRAGONI: Mjaft. Duhet – O le le! (*Vladimiri s'bën zë*) O le le!

VLADIMIRI: Veç në mos qofshin ata!

ESTRAGONI: Didi! Këmba tjetër! (*Drejtobet duke çaluar për nga vendi ku ishte ulur kur i ngrit perdja*)

NJË ZË NË PRAPASKENË: Zotëri!

*Estragoni mban këmbët. Të dy shohin andej nga vjen zëri.*

ESTRAGONI: Filloi prapë avazi.

VLADIMIRI: Afrohu, biri im.

*Hyn me ndrojtje një djalosh. Ndalet.*

DJALI: Zoti Albert!

VLADIMIRI: Unë jam.

ESTRAGONI: Çfarë dëshiron?

VLADIMIRI: Afrohu.

*Djali nuk lëviz nga vendi.*

ESTRAGONI: (*me forcë*) Afrohu të thonë!

*Djali afrohet me ndrojtje, ndalet.*

VLADIMIRI: Si është puna?

DJALI: Vij nga ana e Zotit Godo. (*Hesht*)

VLADIMIRI: Sigurisht. (*Hesht një çast*) Afrohu.

*Djali nuk lëviz nga vendi.*

ESTRAGONI: (*me forcë*) Afrohu, të thonë. (*Djali bën përpara me ndrojtje, ndalet*) Pse erdhe kaq vonë?

VLADIMIRI: Ke ndonjë mesazh nga zoti Godo?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Hë pra, nxirre të shkretën.

ESTRAGONI: Pse erdhe kaq vonë?

*Djali sheh sa njërin sa tjetrin, pa ditur se kujt t'i përgjigjet.*

VLADIMIRI: (*Estragonit*) Mos i bjerë në qafë.

ESTRAGONI: (*Vladimirit*) Mos më çaj kokën. (*Bën përpara dhe i drejtobet djalit*) E ke idenë sa është ora?

DJALI: (*duke u zbrapsur*) Nuk është faji im zotëri.

ESTRAGONI: Mos është gjë i imi?

- DJALI: Kisha frikë, zotëri.
- ESTRAGONI: Nga se kishe frikë? Nga ne? (*Hesht një çast*) Fol!
- VLADIMIRI: E more vesh, i kanë futur datën ata të tjerët.
- ESTRAGONI: Sa kohë ke që je këtu?
- DJALI: Fare pak, zotëri.
- VLADIMIRI: Pate frikë nga kamzhiku?
- DJALI: Po, zotëri.
- VLADIMIRI: Po nga sokëllimat?
- DJALI: Po, zotëri.
- VLADIMIRI: Dhe nga ata dy zotërinjtë?
- DJALI: Po, zotëri.
- VLADIMIRI: I njeh ti ata.
- DJALI: Jo, zotëri.
- VLADIMIRI: Nga këto anë je?
- DJALI: Po, zotëri.
- ESTRAGONI: Profka të gjitha! (*E kap djalin nga krabu dhe e tund*) Na thuaj të vërtetën!
- DJALI: (*duke u dridhur*) Të vërtetën ju thashë zotërinj.
- VLADIMIRI: Lëre pra, mos i bjer në qafë. Ç'pate? (*Estragoni e lëshon, djali zbrapset, mbulon fytyrën me duar. Vladimiri dhe djali e ndjekin me sy. Estragoni zbulon protretin e tij të shpërfytyruar*) Ç'të gjeti?
- ESTRAGONI: Jam fatzi.
- VLADIMIRI: Mos more! Që kur kështu?
- ESTRAGONI: E kisha harruar.
- VLADIMIRI: Kujtesa na e punon keq nganjëherë. (*Estragoni do të flasë, heq dorë, shkon duke çaluar të ulet dhe fillon të heqë këpucët. I drejtohet djalit*) Pa, hë?
- DJALI: Zoti Godo...
- VLADIMIRI: (*duke e ndërprerë*) Se ku të kam parë, ë?
- DJALI: Nuk e di, zotëri.
- VLADIMIRI: Ti s'më njeh?
- DJALI: Jo, zotëri.
- VLADIMIRI: Nuk erdhe dje ti?
- DJALI: Jo, zotëri.
- VLADIMIRI: Hera e parë është që vjen?
- DJALI: Po, zotëri?

VLADIMIRI: E zëmë se është kështu. (*Hesht një çast*) Pa, hë, vazhdo.

DJALI: (*përnjëherësh*) Zoti Godo më tha t'ju them se nuk do të vijë sonte, por nesër do të vijë patjetër.

VLADIMIRI: Kaq?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Për zotin Godo punon ti?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Ç'punë bën?

DJALI: Ruaj dhinë, zotëri.

VLADIMIRI: A sillet mirë me ty?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Nuk të rreh?

DJALI: Mua, jo.

VLADIMIRI: Po kë rreh?

DJALI: Rreh tim vëlla, zotëri.

VLADIMIRI: Ah, paske vëlla?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Ç'punë bën ai?

DJALI: Ruan delet, zotëri.

VLADIMIRI: Po ty pse s'të rreth?

DJALI: Nuk e di zotëri.

VLADIMIRI: Ty duhet të të ketë për zemër.

DJALI: Nuk e di, zotëri.

VLADIMIRI: Të jep për të ngrënë? (*Djali ngurron*) A të jep të hash me bollëk?

DJALI: Më jep ca, zotëri.

VLADIMIRI: A e ndjen veten fatkeq? (*Djali ngurron*) Dëgjon, apo jo?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Atëherë?

DJALI: Nuk e di, zotëri.

VLADIMIRI: Nuk e di në je fatkeq apo jo?

DJALI: Jo, zotëri.

VLADIMIRI: Njëlloj si unë. (*Hesht një çast*) Ku fle?

DJALI: Në papafingo, zotëri.

VLADIMIRI: Bashkë me vëllain?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Në kashtë?

DJALI: Po, zotëri.

*Kalon një çast pa folur.*

VLADIMIRI: Mirë, ik.

DJALI: Çfarë t'i them zotit Godo, zotëri?

VLADIMIRI: I thuaj... *(mëdysbet)* I thuaj që na takove. *(Hesht një çast)* Ti na takove, apo jo?

DJALI: Po, zotëri. *(Ai zbrapset, mëdysbet, kthehet dhe del duke vrapuar)*

*Drita papritur nis e fashitet. Brenda disa çastesh bëhet natë. Hëna ngrihet në sfond, fiksohet në qiell dhe derdh në skenë një dritë të argjendtë.*

VLADIMIRI: Më në fund! *(Estragoni ngrihet dhe shkon drejt Vladimirit, me dy këpucët në dorë. I vë në skaj të skenës, ngrihet në këmbë dhe shikon hënën)* Ç'po bën?

ESTRAGONI: Ja, si ty, po shoh hënëzën.

VLADIMIRI: Dua të them, ç'po bën me këpucët.

ESTRAGONI: Do t'i lë atje. *(Hesht një çast)* Do të vijë ndonjë tjetër, si... si... unë, por me këmbë më të vogël dhe do të gëzohet kur t'i gjejë.

VLADIMIRI: Por s'mund të ecësh zbathur.

ESTRAGONI: E pra, Jezui ka ecur zbathur.

VLADIMIRI: Jezui! Ku të shkon mendja. Mos do të krahasohesh gjë me të?

ESTRAGONI: Gjithë jetën time e kam krahasuar veten me të.

VLADIMIRI: Po atje ishte ngrohtë! Bënte kohë e mirë!

ESTRAGONI: Po, dhe i mbërthenin njerëzit në kryq tak-fak.

*Heshtje.*

VLADIMIRI: S'kemi ç'bëjmë më këtu.

ESTRAGONI: Se mos gjetkë kemi ç'të bëjmë.

VLADIMIRI: Dale, Gogo, mos bëj kështu. Nesër do të na ecë më mbarë.

ESTRAGONI: E nga e di ti?

VLADIMIRI: Nuk e dëgjove ç'tha ai çilimi?

ESTRAGONI: Jo.

VLADIMIRI: Ai tha se Godoja do të vijë se s'bën nesër. *(Hesht një çast)* Hë s'të mbushet mendja?

ESTRAGONI: Atëherë s'na mbetet veçse të presim këtu.

VLADIMIRI: Mos ke luajtur mendsh? Duhet të gjejmë një strehë të fusim kokën. *(E merr Estragonin nga krabu)* Eja. *(E tërheq Estragoni dorëzohet në fillim, pastaj e kundërshton. Mbajnë këmbët)*

ESTRAGONI: *(duke parë pemën)* Sa keq që s'kemi një copë litar.

VLADIMIRI: Eja. Po fillon të bëjë ftohtë. *(E tërheq si herën e parë)*

ESTRAGONI: Më kujto të marr një copë litar nesër.

VLADIMIRI: Mirë. Eja *(e tërheq përsëri)*.

ESTRAGONI: Sa kohë kemi që jemi bashkë?

VLADIMIRI: Nuk e di. Pesëdhjetë vjet ndoshta.

ESTRAGONI: E mban mend ditën kur u hodhe në Dyransë?

VLADIMIRI: Ishte koha e vjeljes së rrushit.

ESTRAGONI: Ti më nxore nga uji.

VLADIMIRI: Të shkuara të harruara.

ESTRAGONI: Teshat e mia u thanë në diell.

VLADIMIRI: Harroji këto tani. Eja. *(E tërheq)*

ESTRAGONI: Prit.

VLADIMIRI: Kam ftohtë.

ESTRAGONI: Mbase do të kish qenë më mirë të rrinim veç e veç, secili për hesap të vet. *(Hesht një çast)* Nuk jemi prerë njësoj.

VLADIMIRI: *(pa u nxehur)* Ku ta dish.

ESTRAGONI: Asgjë s'është e sigurt.

VLADIMIRI: Mund të ndahemi, po qe se mendon që është më mirë kështu.

ESTRAGONI: Tani është e kotë.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Ke të drejtë, tani është e kotë.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Atëherë, ikim?

VLADIMIRI: Ikim.

*Nuk lëvizin nga vendi.*

BIE PERDJA

## AKTI I DYTË

*Dita e nesërme. E njëjta orë. I njëjti vend.*

*Këpucët e Estragonit janë pranë fundit të skenës, thembrat e bashkuara, majat të larguara. Kapelja e Lukit në të njëjtin vend.*

*Pema ka ca gjethe.*

*Hyn Vladimiri, me furi. Ndalet dhe shikon për një kohë të gjatë pemën. Pastaj papritur nis t'i bjerë skenës rreth e përqark. Ndalet përsëri përpara këpucëve, ulet dhe merr një rëndë, e këqyr, i merr erë, e vë me kujdes në vendin e vet. Fillon të ecë sa andej-kënde me nxitim. Ndalet te prapaskena e djathtë, shoh për një kohë të gjatë lart, me dorën mbi sy. Vete e vjen. Ndalet tek prapaskena e majtë, vepron po njëjloj. Ecën sa andej-kënde. Ndalet papritur, lidh duart në gjoks, rrëzon kryet pas dhe fillon të këndojë me sa ka në kokë.*

VLADIMIRI:

Një qen erdhi në...

*E ka nisur shumë poshtë, ndalet, kollitet dhe e fillon më lart:*

Një qen erdhi në kuzhinë  
Dhe rrëmbeu një salçikë.  
Kuzhinieri me garuzhdë  
E bëri çopë e çikë.

Qentë e tjerë që gjithçka panë  
Shpejt e shpejt në varr e kallnë...

*Ndalon, pushon sakaq pastaj fillon të këndojë sërish:*

Qentë e tjerë që gjithçka panë  
 Shpejt e shpejt në varr e kallnë  
 E poshtë kryqit prej dërrase të bardhë  
 Shkruan këto fjalë për çdo kalimtar:  
 Një qen erdhi në kuzhinë  
 Dhe rëmbeu një salçiqkë.  
 Kuzhinieri me garuzhde  
 E bëri copë e çikë.  
 Qentë e tjerë që gjithçka panë  
 Shpejt e shpejt në varr e kallnë...

*Ndalet. Vepron po njëlloj si më parë*

Qentë e tjerë që gjithçka panë  
 Shpejt e shpejt në varr e kallnë...

*Ndalet. Vepron po njëlloj si më parë. Këndon me zë më të ulët.*

Shpejt e shpejt në varr e kallnë...

*Hesht, qëndron një çast pa lëvizur, pastaj si në ethe nis t'i bjerë skenës kryq e tërthor. Ndalet përsëri para pemës, vete e vjen para këpucëve, vete e vjen, vrapon te prapaskena e majtë, shëh larg, vrapon tek prapaskena e djathtë, shëh larg. Në këtë kohë Estragoni byn nga prapaskena e majtë, zbathur, me kryet varur, dhe përsëkon ngadalë skenën. Vladimiri kthehet dhe e shëh.*

**VLADIMIRI:** Prapë ti! (*Estragoni ndalet, por nuk e ngre kokën. Vladimiri shkron drejt tij*) Eja të të përqafoj.

**ESTRAGONI:** Mos më prek.

*Vladimiri e ndal vrullin, i pikëlluar. Qetësi.*

**VLADIMIRI:** Do që të iki. (*Heshtje për një kohë*) Gogo! (*Heshtje për një kohë*) Gogo! (*Estragoni gjithmonë hesht, kryeulur*) Ku e kalove natën? (*Qetësi. Vladimiri bën përpara*)

**ESTRAGONI:** Mos më prek! Mos më pyet për asgjë! Mos më thuaj asgjë! Rri këtu me mua!



VLADIMIRI: Të kam lënë ndonjëherë vetëm?

ESTRAGONI: Ti më le të ikja vetëm.

VLADIMIRI: Shikomë! (*Estragoni nuk lëviz. Me një zë buçitës*)  
Shikomë të thashë!

*Estragoni ngre kokën. Shohin njëri-tjetrin për një kohë të gjatë; zbrapsen, bëjnë përpara dhe anojnë kryet si përpara një veprë arti, duke u dridhur gjithnjë e më shumë, por papritur shtrëngojnë njëri-tjetrin duke rrahur krahët. Mbaron përçafimi. Estragoni, duke mos qenë i mbështetur askund, desh bie.*

ESTRAGONI: Ç' ditë!

VLADIMIRI: Kush të ka dërrmuar kështu? Fol!

ESTRAGONI: Edhe një ditë tjetër e mundshme!

VLADIMIRI: Këtë nuk mund ta thuash ende.

ESTRAGONI: Për mua dita ka mbaruar, sido që të vijë puna.  
(*Qetësi*) Para pak çastesh, të dëgjova që këndoje!

VLADIMIRI: Ke të drejtë, më kujtohet.

ESTRAGONI: Kënga jote më hidhëroi. Thashë me vete, ai është vetëm, kujton se unë ika përgjithmonë dhe po këndon.

VLADIMIRI: Humorit s'ke ç'i bën. Gjatë gjithë ditës kam qenë në formë. (*Hesht për një kohë*) Gjithë natën kam fjetur top, s'më doli gjumi asnjëherë.

ESTRAGONI: (*i trishtuar*) E sheh, ti shurron më mirë kur nuk jam unë.

VLADIMIRI: Më merрте malli për ty dhe në të njëjtën kohë isha i kënaqur. Nuk të duket e çuditshme?

ESTRAGONI: (*i zemëruar*) I kënaqur?

VLADIMIRI: (*pasi mendohet*) Ndoshta s'di ta shpreh tamam.

ESTRAGONI: Po tani?

VLADIMIRI: (*pasi e bluan në mendje*) Tani... (*i gëzuar*) ja ku je... (*pa shprehje*) ja ku jemi... (*i trishtuar*) ja ku jam.

VLADIMIRI: Ja ku jemi... (*i trishtuar*) ja ku jam.

ESTRAGONI: E sheh, ti nuk ndihesh mirë kur unë jam këtu. Edhe unë, ndihem më mirë vetëm.

VLADIMIRI: (*i xhindosur*) Atëherë ç'të preu që erdhe?

ESTRAGONI: Nuk e di.

VLADIMIRI: Unë e di, sepse ti nuk di të mbrohesh. Unë nuk do të të kisha lënë të ziheshe.

ESTRAGONI: Nuk do të kishe bërë dot gjë.

VLADIMIRI: Pse?

ESTRAGONI: Ata ishin dhjetë vetë.

VLADIMIRI: Po jo mo, desha të them që nuk do të të lija të zihsa me ta.

ESTRAGONI: Unë nuk po bëja gjë.

VLADIMIRI: Po pse të rrahën atëherë?

ESTRAGONI: Nuk e di.

VLADIMIRI: Jo, Gogo, e di si është puna, ka gjëra që ty të shpëtojnë, ndërsa mua jo. Ti duhet ta kuptosh kaq gjë.

ESTRAGONI: Të thashë që unë s'po bëja gjë.

VLADIMIRI: Mbase s'po bëje gjë. Po duhet të dish si të sillesh nëse të dhimbset lëkura. Nejsë, le t'i vëmë kapak këtij muhabeti. Ja ku u ktheve dhe unë jam shumë i kënaqur.

ESTRAGONI: Ata ishin dhjetë.

VLADIMIRI: Edhe ti duhet të jesh i kënaqur. Pranoje!

ESTRAGONI: I kënaqur për çfarë?

VLADIMIRI: Që më gjete përsëri.

ESTRAGONI: Vërtet e ke?

VLADIMIRI: Thuaj po, edhe po s'qe e vërtetë.

ESTRAGONI: Çfarë duhet të them?

VLADIMIRI: Thuaj, jam i kënaqur.

ESTRAGONI: Jam i kënaqur.

VLADIMIRI: Edhe unë.

ESTRAGONI: Edhe unë.

VLADIMIRI: Ne jemi të kënaqur.

ESTRAGONI: Ne jemi të kënaqur. (*Qetësi*) E ç'do bëjmë tani që jemi të kënaqur?

VLADIMIRI: Do presim Godonë.

ESTRAGONI: Ah po, vërtet.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Diçka ka ndryshuar këtu që nga dje.

ESTRAGONI: Po sikur të mos vijë?

VLADIMIRI: (*Për një moment nuk kupton se ç'do të thotë Estragoni*) Do ta mendojmë edhe këtë. (*Heshtje për një kohë*) Po të them se këtu seç ka ndryshuar, që dje deri sot.

ESTRAGONI: Këtu gjithçka loton.

VLADIMIRI: Shiko pemën.

ESTRAGONI: Nuk shkel njeriu dy herë në të njëjtin vend.

VLADIMIRI: Shiko pemën të them.

*Estragoni sheh pemën.*

ESTRAGONI: Po dje sikur nuk ishte atje?

VLADIMIRI: Si nuk ishte. Nuk të kujtohet. *(Ndan fjalët)* Ne për pak sa s'u varëm në atë pemë. *(Mendohet)* Tamam, desh - varëm - veten. Por ti nuk deshe. Nuk të kujtohet?

ESTRAGONI: Mos ke parë gjë ëndërr.

VLADIMIRI: Si është e mundur që ta kesh harruar kaq shpejt?

ESTRAGONI: Kështu e kam unë. Ose harroj menjëherë, ose nuk harroj kurrë.

VLADIMIRI: Po Pocon dhe Lukin s'i mban mend?

ESTRAGONI: Pocon dhe Lukin?

VLADIMIRI: I ka harruar të gjitha!

ESTRAGONI: Më kujtohet një i fandaksur që më këputi ca shqelma të mira. Ishte një kokërr budallai.

VLADIMIRI: Luki!

ESTRAGONI: Ah po, m'u kujtua. Por kur ka ndodhur?

VLADIMIRI: Po ai tjetri që e mbante Lukin nën hyqëm, të kujtohet?

ESTRAGONI: Ai më dha kocka.

VLADIMIRI: Ai ishte Pocoja.

ESTRAGONI: E të gjitha këto kanë ndodhur dje sipas teje?

VLADIMIRI: Po, pra, shiko...

ESTRAGONI: Tamam këtu?

VLADIMIRI: Sigurisht! Nuk po e njeh këtë vend?

ESTRAGONI: *(papritur i tërbuar)* Ta njoh? Ç'ka këtu për të njohur? E kalova këtë zuskë jetë në mes të rërave! Dhe ti më kërkon tani që të dalloj edhe vendet *(sheh rreth e qark)*. E sheh këtë qelbësirllëk! S'kam bërë kurrë çap prej këtej!

VLADIMIRI: Ngadalë, ngadalë.

ESTRAGONI: Atëherë mos më çaj kokën me gjithë peizazhet e tua! Më fol për nëntokën!

VLADIMIRI: Se mos na thuash që kjo zonë *(bën me dorë)* këtu ngjan me Voklyzën! Se sidoqoftë ndryshon goxha.

ESTRAGONI: Voklyza! E kush e zuri ngoje Voklyzën?

VLADIMIRI: A ke qenë vërtet në Voklyzë?

ESTRAGONI: Ç'ne unë në Voklyzë, as që kam shkëlur ndonjëherë! Jam tërhequr zvarrë këtu, po të them! Këtu! Në Mutklyzë!

VLADIMIRI: Vë dorën në zjarr që kemi qenë bashkë në Voklyzë.

Kemi vjelur rrush bashkë, te një farë Boneli, në Rusijon.

ESTRAGONI: (*Më i qetë*) Ka mundësi. S'kam vënë re gjë.

VLADIMIRI: Atje çdo gjë është e kuqe!

ESTRAGONI: (*që i ka ardhur në majë të hundës*) S'kam vënë re gjë, të thashë.

*Qetësi. Vladimiri psherëtin thellë.*

VLADIMIRI: Me ty s'jeto het, Gogo.

ESTRAGONI: Do të ishte më mirë të ndaheshim.

VLADIMIRI: Kështu thua gjithmonë ti, dhe vjen prapë pastaj.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Që t'i vë kapak kësaj pune, duhet të më vrasësh si atë tjetrin.

VLADIMIRI: Cilin? (*Heshtje për një kohë*) Cilin tjetër?

ESTRAGONI: Si miliarda të tjerë.

VLADIMIRI: (*Solemn*) Secili ka fatin e vet. (*Psherëtin*)

ESTRAGONI: Ndërkohë që presim, le të përpiqemi të bisedojmë pa marrë zjarr, meqë nuk rrimë dot pa folur.

VLADIMIRI: Ke të drejtë, s'na mbyllet goja.

ESTRAGONI: Flasim që mos të mendojmë.

VLADIMIRI: Kemi arsye të flasim.

ESTRAGONI: Flasim që mos të dëgjojmë.

VLADIMIRI: Kemi arsyet tona.

ESTRAGONI: Që mos të dëgjojmë zërat e vdekur.

VLADIMIRI: Ata ngjajnë me zhurmën e flatrave.

ESTRAGONI: Me zhurmën e gjetheve.

VLADIMIRI: Me zhurmën e rërës.

ESTRAGONI: Me zhurmën e gjetheve.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Ata flasin të gjithë njëherësh.

ESTRAGONI: Secili thellë brenda vetes.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Në të vërtetë, pëshpërisin.

ESTRAGONI: Mërmërisin.

VLADIMIRI: Fëshfërijnë.

ESTRAGONI: Mërmërisin.

VLADIMIRI: E ç'thonë?



*Qetësi.*

ESTRAGONI: Flasin për jetën e tyre.  
 VLADIMIRI: Nuk u mjafton që jetuan.  
 ESTRAGONI: Duhet që dhe të flasin për jetën e tyre.  
 VLADIMIRI: Nuk u mjafton që kanë vdekur.  
 ESTRAGONI: Jo, s'mjafton.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Duket si shpupuritje puplash.  
 ESTRAGONI: Si zhurmë gjethesh.  
 VLADIMIRI: Si zhurmë hiri.  
 ESTRAGONI: Si zhurmë gjethesh.

*Qetësi e gjatë.*

VLADIMIRI: Fol një fjalë.  
 ESTRAGONI: S'di ç'të them.

*Qetësi e gjatë.*

VLADIMIRI: (*gjithë ankth*) Thuaj ç'të të vijë për mbarë!  
 ESTRAGONI: Ç'po bëjmë tani?  
 VLADIMIRI: Po presim Godonë!  
 ESTRAGONI: Ke të drejtë.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Sa e vështirë është të presësh!  
 ESTRAGONI: Po t'ia merrje një kënge?  
 VLADIMIRI: Jo, jo (*seç kërkon*). Nuk na mbetet veçse t'ia nisim nga e para.  
 ESTRAGONI: Në fakt s'më duket dhe aq e vështirë.  
 VLADIMIRI: Fillimi ama është i vështirë.  
 ESTRAGONI: Mund t'ia nisësh nga të duash.  
 VLADIMIRI: Po, por duhet ta ndash mendjen.  
 ESTRAGONI: Ke të drejtë.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Ndihi momë!  
 ESTRAGONI: Po kërkuj të gjej diçka.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Mund të kërkosh dhe të dëgjosh njëherësh.  
 ESTRAGONI: Ke të drejtë.  
 VLADIMIRI: Po kur dëgjon nuk gjen dot atë që do.  
 ESTRAGONI: Atë thuaj!  
 VLADIMIRI: Kur dëgjon nuk mendon dot.  
 ESTRAGONI: Mendon që ç'ke me të.

VLADIMIRI: Jo pra, është e pamundur.

ESTRAGONI: Në rregull, le të hahemi me njëri-tjetrin.

VLADIMIRI: Është e pamundur!

ESTRAGONI: Ashtu thua ti?

VLADIMIRI: Zor se mendojmë më.

ESTRAGONI: Atëherë pse të qahemi?

VLADIMIRI: Të menduarit nuk është gjëja më e keqe.

ESTRAGONI: Sigurisht, sigurisht, po ja që tani ajo është më e keqja.

VLADIMIRI: Ç' do të thuash me këtë «ajo është më e keqja»?

ESTRAGONI: Shumë mirë, hajt i bëjmë ca pyetje njëri-tjetrit.

VLADIMIRI: Ç' do të thuash me këtë?

ESTRAGONI: Që tani kjo është një e keqe më pak.

VLADIMIRI: Natyrisht.

ESTRAGONI: Po sikur ta quanim veten të lumtur?

VLADIMIRI: Më e tmerrshmja është se kemi menduar.

ESTRAGONI: Pse, e kemi bërë ndonjëherë këtë ne?

VLADIMIRI: Nga vijnë gjithë këto kufoma?

ESTRAGONI: Këto eshtra.

VLADIMIRI: Tamam.

ESTRAGONI: Natyrisht.

VLADIMIRI: Na u desh të mendonim.

ESTRAGONI: Vetëm në fillim.

VLADIMIRI: Një gropë me kufoma, një gropë me kufoma.

ESTRAGONI: Mjafton të mos vështrosh andej.

VLADIMIRI: Ajo gropë të tërheq vëmendjen.

ESTRAGONI: Ke të drejtë.

VLADIMIRI: Megjithëse s'kemi frikë.

ESTRAGONI: Si?

VLADIMIRI: Megjithëse s'kemi frikë.

ESTRAGONI: Duhet t'i kthehemi me guxim natyrës.

VLADIMIRI: Jemi përpjekur.

ESTRAGONI: Ke të drejtë.

VLADIMIRI: Oh, sigurisht nuk qëndron aty më e keqja.

ESTRAGONI: Ku?

VLADIMIRI: Në faktin që kemi menduar.

ESTRAGONI: Natyrisht.

VLADIMIRI: Mund të bënim edhe pa të.

ESTRAGONI: Ç't'i bësh.

VLADIMIRI: E di, e di.

ESTRAGONI: Nuk është keq si fillim.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Po, por tani na duhet të gjejmë marifete të tjera.

ESTRAGONI: Ta shohim.

VLADIMIRI: Ta shohim!

ESTRAGONI: Ta shohim!

*Mendoben.*

VLADIMIRI: Ç'po thosha? Mund ta nisnim aty ku e kemi lënë.

ESTRAGONI: Kur?

VLADIMIRI: Në fillim fare.

ESTRAGONI: Në fillim të kujt?

VLADIMIRI: Sonte. Po thosha... po thosha...

ESTRAGONI: Për besë, po kërkon ca si shumë nga unë.

VLADIMIRI: Prit... U përqaftuam... ishim të kënaqur... të kënaqur... ç'të bëjmë tani që jemi të kënaqur... të rrimë e të presim... dale... u pa puna... po presim... tani që jemi të kënaqur... po presim pa dale... ah! Pema!

ESTRAGONI: Pema?

VLADIMIRI: Nuk e mban mend?

ESTRAGONI: Ndihem i lodhur.

VLADIMIRI: Shikoje.

*Estragoni sheh pemën.*

ESTRAGONI: Nuk shoh gjë.

VLADIMIRI: Mbrëmë pema ishte një kërcu i zi, i tharë. Sot është plot gjethe.

ESTRAGONI: Me gjethe!

VLADIMIRI: Është mbushur me gjethe brenda një nate!

ESTRAGONI: Duhet të jemi në pranverë!

VLADIMIRI: Të mbushet me gjethe brenda një nate?

ESTRAGONI: Mbrëmë nuk kemi qenë tek kjo pemë, po të them. Ke parë ndonjë ëndërr të keqe.

VLADIMIRI: E ku kemi qenë mbrëmë sipas teje?

ESTRAGONI: Nuk e di. Gjetkë. Në një zonë tjetër. Vetëm hapësira s'mungon këtu.

VLADIMIRI: *(i sigurt në atë që thotë)* Mirë. Nuk kemi qenë këtu. Por, ç'kemi bërë dje në mbrëmje?

ESTRAGONI: Ç'kemi bërë?

VLADIMIRI: Po vrite pak mendjen.

ESTRAGONI: Ë po... kemi bërë muhabet me siguri.

VLADIMIRI: (*duke u përmbajtur*) E për çfarë kemi folur?

ESTRAGONI: Oh... kodra pas bregu, sa për t'u gjendur në muhabet. (*I sigurt*) Po po, m'u kujtua, mbrëmë kemi thënë gjepura sa për të vrarë kohën. Ehu, që kur ka ky avaz!

VLADIMIRI: S'të kujtohet asnjë fakt, asnjë rrethanë?

ESTRAGONI: (*i lodhur*) Mos më mundo, Didi.

VLADIMIRI: Dielli? Hëna? Nuk të kujtohet?

ESTRAGONI: S'besoj të kenë lëvizur vendit.

VLADIMIRI: Nuk vure re ndonjë gjë të pazakontë?

ESTRAGONI: Për fat të keq jo.

VLADIMIRI: Po Pocon, Lukin?

ESTRAGONI: Pocon?

VLADIMIRI: Kockat!

ESTRAGONI: Halat më mirë!

VLADIMIRI: Pocoja t'i dha.

ESTRAGONI: Nuk e di.

VLADIMIRI: Po shqelmi?

ESTRAGONI: Shqelmi? Po, ke të drejtë, hëngra ca shqelma.

VLADIMIRI: Luki të goditi.

ESTRAGONI: Dje kanë ndodhur të gjitha këto?

VLADIMIRI: Dale ta shoh këmbën.

ESTRAGONI: Cilën këmbë?

VLADIMIRI: Të dyja. Ngriji pantallonat. (*Estragoni qëndron mbi një këmbë dhe i zgjat tjetrën Vladimirit, por desh bie. Vladimiri ia kap këmbën. Estragonit i merren këmbët*) Ngriji pantallonat.

ESTRAGONI: (*këmbëmarrë*) Nuk mundem.

*Vladimiri ngre pantallonin, sheh këmbën, e lëshon. Estragoni desh bie.*

VLADIMIRI: Tjetrën! (*Estragoni i zgjat të njëjtën këmbë*) Tjetrën të thashë! (*Bën të njëjtat veprime edhe me këmbën tjetër*) E sheh, plaga po të infektohet.

ESTRAGONI: Po pastaj?

VLADIMIRI: Ku i ke këpucët?

ESTRAGONI: Duhet t'i kem hedhur.

VLADIMIRI: Kur?



- ESTRAGONI: Nuk e di.  
 VLADIMIRI: Pse?  
 ESTRAGONI: Nuk më kujtohet.  
 VLADIMIRI: Dua të them, përse i hodhe?  
 ESTRAGONI: Më vrisnin.  
 VLADIMIRI: *(duke treguar këpucët)* Ja ku janë! *(Estragoni sheh këpucët)* Tamam aty ku i ke lënë mbrëmë.  
*Estragoni shkon drejt këpucëve, përkulet dhe i këqyr nga afër.*  
 ESTRAGONI: Nuk janë të miat.  
 VLADIMIRI: Nuk janë të tuat!  
 ESTRAGONI: Të miat ishin të zeza. Këto këtu janë të verdha.  
 VLADIMIRI: Je i sigurt që të tuat ishin të zeza?  
 ESTRAGONI: Domethënë ishin gri.  
 VLADIMIRI: Po këto të verdha janë? Dale t'i shoh.  
 ESTRAGONI: *(duke ngritur një këpucë)* Këto vijnë si të gjelbërta.  
 VLADIMIRI: *(duke bërë përpara)* Dale t'i shoh! *(Estragoni i jep këpucën. Vladimiri e sheh dhe e hedh i nevrikosur)* Ta hajë dreqi!  
 ESTRAGONI: E kupton, kjo është...  
 VLADIMIRI: E mora vesh. E kuptoj fare mirë ç'ka ngjarë.  
 ESTRAGONI: E gjithë kjo është...  
 VLADIMIRI: Është fare e thjeshtë. Erdhi një tip, mori të tuat dhe të la të tijat.  
 ESTRAGONI: Pse?  
 VLADIMIRI: Se të vetat nuk i rrinin mirë. E kështu mori të tuat.  
 ESTRAGONI: Këpucët e mia ishin shumë të vogla.  
 VLADIMIRI: Për ty, por jo për atë.  
 ESTRAGONI: Jam i lodhur. *(Heshtje për një kohë)* Ikim që këtej!  
 VLADIMIRI: Nuk mund të ikim.  
 ESTRAGONI: Pse?  
 VLADIMIRI: Po presim Godonë.  
 ESTRAGONI: Ah, po *(heshtje për një kohë)*. Si t'ia bëjmë atëherë?  
 VLADIMIRI: S'kemi ç'bëjmë.  
 ESTRAGONI: Unë sharrova.  
 VLADIMIRI: Do një rrepkë?  
 ESTRAGONI: Vetëm rrepka ka?  
 VLADIMIRI: Ka rrepka dhe panxhar.

ESTRAGONI: S'ka më karrota?

VLADIMIRI: Jo. Na vdiqe me ato karrotat.

ESTRAGONI: Atëherë më jep një rrepkë. (*Vladimiri kërkon në xhepa, gjen vetëm panxharë, nxjerr më në fund një rrepkë dhe ia jep Estragonit që e këqyr dhe i merr erë*) Qenka e zezë!

VLADIMIRI: Rrepkë është.

ESTRAGONI: Ti e di mirë që mua vetëm të kuqet më pëlqejnë.

VLADIMIRI: S'e do rrepkën?

ESTRAGONI: Mua më pëlqejnë veç të kuqet.

VLADIMIRI: Atëherë ma kthe rrepkën.

*Estragoni ia kthen.*

ESTRAGONI: Po vete të kërkoj një karrotë.

*Nuk lëviz vendit.*

VLADIMIRI: Kjo s'ka kuptim.

ESTRAGONI: Tani për tani ka njëfarë kuptimi.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Provoji njëherë.

ESTRAGONI: I kam provuar të gjitha.

VLADIMIRI: E kam fjalën për këpucët.

ESTRAGONI: Me gjithë mend e ke?

VLADIMIRI: Sa për të shtyrë kohën. (*Estragoni mëdysbet*) Dëgjo mua, do zbavitësh.

ESTRAGONI: Do të jetë një çlodhje.

VLADIMIRI: Një zbavitje.

ESTRAGONI: Një çlodhje.

ESTRAGONI: Një çlodhje.

VLADIMIRI: Provoje njëherë.

ESTRAGONI: Do më ndihmosh?

VLADIMIRI: S'do mend.

ESTRAGONI: Ia kemi marrë dorën bashkë, hë Didi?

VLADIMIRI: Po mor, po. Jepi, provojmë të majtën në fillim.

ESTRAGONI: Gjendet gjithmonë diçka për t'u englendirur, hë Didi?

VLADIMIRI: (*me padurim*) Po, mor po, jemi magjistarë ne. Vazhdojmë tani atë punë që nisëm. (*Merr një këpucë*) Eja, nëma këmbën! (*Estragoni afrohet, ngre këmbën*) Tjetrën, mor derr! (*Estragoni ngre këmbën tjetër*) Më lart! (*Ngatërrohen me njëri-tjetrin dhe u merren këmbët nëpër skenë. Vladimiri*

*më në fund arrin t'ia veshë këpucën.) Pa provo të ecësh.  
(Estragoni ecën)*

ESTRAGONI: Mirë e kam.

VLADIMIRI: *(duke marrë spangon në xhëp)* Tani ta lidhim.

ESTRAGONI: *(me rrëmbim)* Jo, jo, nuk dua lidhëse.

VLADIMIRI: E ke gabim. Provojmë tjetrën. *(Vepron si me rastin e parë)* Pa, hë?

ESTRAGONI: Mirë e kam dhe këtë.

VLADIMIRI: Nuk të vrasin?

ESTRAGONI: *(bën disa hapa)* Akoma jo.

VLADIMIRI: Atëherë mund t'i mbash.

ESTRAGONI: Janë shumë të mëdha.

VLADIMIRI: Mbase një ditë do të kesh edhe çorape.

ESTRAGONI: E pra.

VLADIMIRI: Atëherë si thua, do t'i mbash?

ESTRAGONI: Si shumë e zgjatëm me këpucët.

VLADIMIRI: Po, por...

ESTRAGONI: Mjaft! *(Qetësi)* Po ulem.

*Kërkon me sy se ku mund të ulet dhe zë vend atje ku ishte ulur në fillim të aktit të parë.*

VLADIMIRI: Je ulur atje ku ishe ulur mbrëmë.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Sikur të mund të flija.

VLADIMIRI: Mbrëmë të zuri gjumi.

ESTRAGONI: Po e provoj njëherë.

*Mblidhet kruspull, me kokën mes këmbëve.*

VLADIMIRI: Prit! *(Afrohet pranë Estragonit dhe fillon të këndojë me zë të fortë)*

Nani na ni

ESTRAGONI: *(Ngre kokën)* Jo kaq fort.

VLADIMIRI: *(disi më butë)*

Nani nani,

Nani nani,

Nani nani,

Nani...

*Estragonin e zë gjumi, Vladimiri heq xhaketën dhe ia hedh Estragonit krahëve, pastaj i bie skenës kryq e tërthor duke fërkuar krahët për t'u ngrohur. Estragoni zgjohet i trembur,*

*ngrihet, bën disa hapa si i shastisur. Vladimiri vrapon drejt tij, i hedh krabun.*

VLADIMIRI: Ja... Ja... më ke mua... mos ki frikë.

ESTRAGONI: Ah!

VLADIMIRI: Aq... aq qe... mbaroi.

ESTRAGONI: Po bija.

VLADIMIRI: Mbaroi. Hiqe mendjen andej.

ESTRAGONI: Isha mbi një...

VLADIMIRI: Jo, jo, mos thuaj gjë. Eja, të ecim pak.

*E merr Estragonin për krabu dhe e shtyn të ecë lart e poshtë skenës, deri sa Estragoni nuk pranon të shkojë më tej).*

ESTRAGONI: Mjaft! Jam i lodhur.

VLADIMIRI: Të pëlqen më mirë të rrish aty si trung pa bërë asgjë?

ESTRAGONI: Po.

VLADIMIRI: Si të duash.

*E lë Estragonin, shkon të marrë xhaketën dhe e vesh.*

ESTRAGONI: Ikim.

VLADIMIRI: Nuk mund të ikim.

ESTRAGONI: Pse?

VLADIMIRI: Po presim Godonë.

ESTRAGONI: Ke të drejtë. *(Vladimiri nis përsëri ecejaken e zakonshme)* Nuk mund të rrish në një vend?

VLADIMIRI: Kam ftohtë.

ESTRAGONI: Kemi ardhur herët.

VLADIMIRI: Gjithmonë kur bie nata kemi ardhur.

ESTRAGONI: Po nata s'po bie se.

VLADIMIRI: Do të bjerë përnjëherësh, si mbrëmë.

ESTRAGONI: Pastaj do të bëhet natë.

VLADIMIRI: Dhe do të mund të nisemi.

ESTRAGONI: Pastaj do të bëhet prapë ditë. *(Hesht për një farë kobe)* Ç't'i bësh? S'ke ç'i bën!

VLADIMIRI: *(duke qëndruar në vend, me rrëmbim)* Mjaft u qave! Më çave kokën me ato rënkimet e tua?

ESTRAGONI: Po iki.

VLADIMIRI: *(duke parë kapelen e Lukit)* Shiko!

ESTRAGONI: Lamtumirë!

VLADIMIRI: Kapelja e Lukit! *(Afrohet pranë kapeles)* Kam një

orë që rri këtu dhe s'e kisha parë! (*Shumë i kënaqur*) Shkëlqyeshëm!

ESTRAGONI: S'ke për të më parë më.

VLADIMIRI: Domethënë s'e paskam ngatërruar vendin. Tani jemi rehat. (*Merr kapelen e Lukit, e kundron, e ndreq*) Duhet të ketë qenë kapele e bukur! (*E vë në vend të kapeles së vet, të cilën ia zgjat Estragonit*) Mbaje.

ESTRAGONI: Çfarë?

VLADIMIRI: Ma mbaj një çikë!

*Estragoni merr kapelen e Vladimirit. Vladimiri rregullon me të dy duart kapelen e Lukit. Estragoni vë kapelen e Vladimirit dhe ia zgjat të tijën këtij të fundit. Vladimiri merr kapelen e Estragonit. Estragoni rregullon me dy duart kapelen e Vladimirit. Vladimiri vë kapelen e Estragonit dhe i zgjat këtij të fundit kapelen e Lukit. Estragoni merr kapelen e Lukit. Vladimiri rregullon me të dy duart kapelen e Estragonit; Estragoni vë kapelen e Lukit dhe i zgjat Vladimirit kapelen e tij. Vladimiri merr kapelen e tij. Estragoni rregullon me të dy duart kapelen e Lukit. Vladimiri vë kapelen e tij dhe i zgjat Estragonit të vetën. Estragoni merr kapelen e vet. Vladimiri rregullon me dy duart kapelen e tij. Estragoni vë kapelen e tij dhe i zgjat kapelen e Lukit Vladimirit. Vladimiri merr kapelen e Lukit. Estragonit rregullon me dy duart kapelen e tij. Vladimiri vë kapelen e Lukit dhe të tijën ia zgjat Estragonit. Vladimiri rregullon me dy duart kapelen e Lukit. Estragoni i zgjat Vladimirit kapelen e tij. Ky e merr dhe ia zgjat Vladimirit kapelen e tij. Ky e merr dhe ia zgjat Estragonit përsëri, Estragoni e merr dhe ia zgjat Vladimirit, i cili e merr dhe e hedh. E gjithë kjo kryhet shumë shpejt.*

VLADIMIRI: Më shkon?

ESTRAGONI: Nuk e di.

VLADIMIRI: Jo, më thuaj si të dukem?

*Vladimiri e kthen kokën si spitullaq sa majtas-djathtas dhe merr qëndrime manekini.*

ESTRAGONI: I shpifur.

VLADIMIRI: Por jo më i shpifur se zakonisht.

ESTRAGONI: Njëlluj.

VLADIMIRI: Atëherë mund ta mbaj. E imja më shtrëngonte.

(Hesht një farë kobe) Si ta them? (Hesht një farë kobe) Më shkaktonte kruarje.

ESTRAGONI: Po iki.

VLADIMIRI: Nuk do të luash?

ESTRAGONI: Ç'lojë të luajmë?

VLADIMIRI: Mund të luanim «Poco me Lukin».

ESTRAGONI: S'e di këtë lojë.

VLADIMIRI: Unë do bëj Lukin, ti do bësh Pocon. (Bëhet si Luki, përkulur nën peshën e bagazheve. Estragoni e sheh i habitur) Fillo.

ESTRAGONI: Ç'duhet të bëj?

VLADIMIRI: Shamë!

ESTRAGONI: Qelbanik!

VLADIMIRI: Më fort!

ESTRAGONI: Plehrë! Maskara!

*Vladimiri bën përpara, zbrapset, gjithmonë i përkulur.*

VLADIMIRI: Thuamë të mendoj.

ESTRAGONI: Si?

VLADIMIRI: Thuaj: Mendo, derr!

ESTRAGONI: Mendo, derr!

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Nuk mundem!

ESTRAGONI: Mjaft!

VLADIMIRI: Thuamë të kërcëj.

ESTRAGONI: Po iki.

VLADIMIRI: Kërce, derr! (Përdridhet në vend. Estragoni del me nxitim) Nuk mundem! (Ngre kokën, sheh që Estragoni nuk është më aty, lëshon një piskamë që të copëton zemrën) Gogo! (Qetësi. Ai fillon t'i bjerë skenës lart e poshtë, gati duke vrapuar. Estragoni kthehet me nxitim, duke iu marrë fryma, vrapon drejt Vladimirit. Ndalojnë disa hapa larg njëri-tjetrit) Ja ku erdhe prapë, më në fund!

ESTRAGONI: (duke iu marrë fryma) Më kanë mallkuar!

VLADIMIRI: Ku ishe? Kujtova se ike përgjithmonë.

ESTRAGONI: Shkova deri buzë rrëpirës. Po vijnë.

VLADIMIRI: Kush?

ESTRAGONI: Nuk e di.

VLADIMIRI: Sa ishin?

ESTRAGONI: Nuk e di.

VLADIMIRI: *(i ngazëllyer)* Godoja! Më në fund *(Përqafton me zvar- Estragonin)* Gogo! Është Godoja! Shpëtuam! Shkojmë ta prisim. Eja! *(E tërbeq Estragonin drejt prapaskenës. Estragoni kundërshton, çlirohet prej Vladimirit dhe vrapon në anën tjetër)* Gogo! Eja! *(Qetësi. Vladimiri vrapon drejt prapaskenës dhe sheh diku larg. Estragoni kthehet nxitimthi, vrapon drejt Vladimirit që kthehet)* Ja ku erdhe përsëri!

ESTRAGONI: Më kanë mallkuar!

VLADIMIRI: Shkove larg?

ESTRAGONI: Gjer buzë rrëpirës.

VLADIMIRI: Tamam, jemi në një rrafshnaltë. S'ka pikë dyshimi që dukemi si në pëllëmbë të dorës.

ESTRAGONI: Po vijnë edhe andej.

VLADIMIRI: Jemi si në çark! *(I alarmuar, Estragoni nxiton drejt sfondit, pengohet aty dhe bie)* Budalla! Nuk dilet andej! *(Vladimiri shkon ta ngrejë, e çon drejt paraskenës. Drejtohet nga publiku)* Këtej s'ka njeri. Mbathja këtej. Nisu. *(Vladimiri e shtyn drejt gropës. Estragoni zbrapset i llahtaritur)* Nuk do? Për besë, s'ke faj. Pa prit. *(Mendohet)* Nuk të mbetet veçse të zhdukesh!

ESTRAGONI: Ku të zhdukem?

VLADIMIRI: Prapa pemës. *(Estragoni ngurron)* Shpejt! Prapa pemës! *(Estragoni vrapon të fshihet pas pemës, që nuk arrin ta maskojë plotësisht)* Mos lëviz më! *(Estragoni del që pas pemës)* Me sa duket kjo pemë s'na hyn fare në punë. *(Estragonit)* Mos u çmende?

ESTRAGONI: *(më i qetë)* E kam humbur toruan. *(Ul kokën i turpëruar)* Më fal! *(Ngre kokën me krenari)* Kaq ishte, mbaroi! Që këtej e tutje do ta shohësh. Më thuaj se ç'duhet të bëj!

VLADIMIRI: Asgjë s'ke ç'bën.

ESTRAGONI: Ti rri atje! *(E tërbeq Vladimirin drejt prapaskenës majtas, e vendos në qendër të rrugës, me kurriz nga skena)* Aty qëndro, mos lëviz më, dhe hap sytë. *(Drejtohet për nga prapaska tjetër. Vladimiri e sheh me bisht të syrit, pa kthyer kokën. Estragoni ndalet, sheh larg, kthehet. Të dy shohin njëri-tjetrin me bisht të syrit, pa kthyer kokën)* Shpinë më shpinë si njëherë

e një kohë. (*Vazhdojnë të shohin njëri-tjetrin për një çast, pastaj secili nis të bëjë roje. Heshtje e gjatë*) Po sheh gjë?

VLADIMIRI: (*duke u kthyer nga Estragoni*) Si?

ESTRAGONI: (*me zë më të lartë*) Po sheh gjë?

VLADIMIRI: Jo.

ESTRAGONI: As unë.

*Nisin përsëri të përgjojnë. Pauzë e gjatë.*

VLADIMIRI: Do të jesh gabuar.

ESTRAGONI: (*duke u kthyer nga Vladimiri*) Si?

VLADIMIRI: (*me zë të lartë*) Do të jesh gabuar.

ESTRAGONI: Mos bërtit.

*Vazhdojnë të përgjojnë. Pauzë e gjatë*

VLADIMIRI, ESTRAGONI: (*duke u kthyer nga njëri-tjetri njëherësh*) A...

VLADIMIRI: Oh, më fal!

ESTRAGONI: Po të dëgjoj.

VLADIMIRI: Jo, jo s'ka gjë.

ESTRAGONI: Fol, pra!

VLADIMIRI: Të preva fjalën.

ESTRAGONI: Përkundrazi

*Shikojnë njëri-tjetrin me inat.*

VLADIMIRI: Shprehu, lëri ceremonitë.

ESTRAGONI: Mos u bëj kokëfortë, pra.

VLADIMIRI: (*me forcë*) Thuaje ç'kishe për të thënë, po të them.

ESTRAGONI: (*po kështu*) Thuaje ti njëherë.

*Heshtje. Shikojnë drejt njëri-tjetrit, ndalen.*

VLADIMIRI: I poshtër.

ESTRAGONI: Hë bravo, le të shahemi. (*Shkëmbejmë sharje.*

*Qetësi*) Tani të pajtohemi.

VLADIMIRI: Gogo.

ESTRAGONI: Didi.

VLADIMIRI: Toke këtu!

ESTRAGONI: Ja, e toka!

VLADIMIRI: Eja në krahët e mi.

ESTRAGONI: Në krahët e tu?

VLADIMIRI: (*hap krahët*) Po, mu këtu në kraharor.

ESTRAGONI: Erdha.

*Përqafohen. Qetësi.*



VLADIMIRI: Sa shpejt ikën koha kur zbavitësh!

ESTRAGONI: Ç' do bëjmë tani?

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Ndërkohë që presim.

ESTRAGONI: Ndërkohë që presim.

VLADIMIRI: Sikur të bënim ato ushtrimet tona?

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Ato lëvizjet.

VLADIMIRI: Ushtrimet e shkrythjes.

ESTRAGONI: Ato të shtendosjes.

VLADIMIRI: Ato lëvizjet rrotulluese.

ESTRAGONI: Lëvizjet e shtendosjes.

VLADIMIRI: Për t'u ngrohur.

ESTRAGONI: Për t'u qetësuar.

VLADIMIRI: Fillojmë.

*Fillon të kërcejë. Estragoni e imiton.*

ESTRAGONI: (*ndalon*) Mjaft. U lodha.

VLADIMIRI: (*ndalon*) Nuk jemi në terezi. Megjithatë le të bëjmë ca ushtrime për frymëmarrjen.

ESTRAGONI: Nuk dua të marr më frymë.

VLADIMIRI: Ke të drejtë. (*Pauzë*) Bëjmë sikur jemi pemë, për të forcuar ekuilibrin.

ESTRAGONI: Sikur jemi pemë?

*Vladimiri qëndron si pemë duke u kalamendur.*

VLADIMIRI: (*ndalet*) E ke radhën ti.

*Estragoni qëndron si pemë, duke u kalamendur.*

ESTRAGONI: A thua më sheh Zoti?

VLADIMIRI: Duhet mbyllur sytë.

*Estragoni mbyll sytë, këmbët i merren më shumë.*

ESTRAGONI: (*ndalet, tund grushtet dhe bërtet me sa ka në kokë*) Zot ki mëshirë për mua!

VLADIMIRI: (*i nxehur*) Po për mua?

ESTRAGONI: (*përsëri*) Për mua! Për mua! Mëshirë për mua!

*Hyjnë Poco dhe Luki. Poco është verbuar. Luki i ngarkuar si në aktin e parë. Litari është më i shkurtër, në mënyrë që Pocoja ta ndjekë më me lehtësi. Luki ka vënë një kapele tjetër. Sapo sheh Vladimirin dhe Estragonin ndalet. Poco, që vazhdon të ecë, përplasë pas Lukit. Vladimiri dhe Estragoni zbrampsen.*

POCO: *(duke u kapur fort pas Lukit, të cilit nga pesha i merren këmbët)* Ç'është? Kush bërtiti?  
Luki rrëzohet, duke lëshuar gjithçka dhe duke tërhequr dhe Pocon me vete. Të dy mbeten shtrirë në mes të bagazheve.

ESTRAGONI: Godoja është?

VLADIMIRI: Tamam në kohën e duhur. *(Drejtohet për tek grumbulli i ndjekur nga Estragoni)* Më në fund na erdhën përforcime!

POCO: *(me zë të fikur)* Ndhimë!

ESTRAGONI: Godoja është?

VLADIMIRI: Ne kishim nisur të ligështoheshim, por ja që për sonte ia hodhëm.

POCO: Ndhimomëni!

ESTRAGONI: Ai po kërkon ndihmë.

VLADIMIRI: Nuk jemi më vetëm, duke pritur natën, duke pritur Godonë, duke pritur e duke pritur. Gjithë mbrëmjen luftuam me ç'mundëm. Tani gjithçka mbaroi. Po jetojmë të nesërmen.

POCO: Ndhimomëni!

VLADIMIRI: Tashmë koha po rrjedh ndryshe. Dielli do të perëndojë, do të dalë hëna. dhe ne do të ikim që këtej.

POCO: Mëshirë!

VLADIMIRI: I gjori Poco.

ESTRAGONI: E dija që ishte ai.

VLADIMIRI: Kush?

ESTRAGONI: Godoja.

VLADIMIRI: Po nuk është Godoja.

ESTRAGONI: Nuk është Godoja?

VLADIMIRI: Jo, nuk është Godoja.

ESTRAGONI: E kush është atëherë?

VLADIMIRI: Është Poco.

POCO: Jam unë! Jam unë! Më ngrini.

VLADIMIRI: Nuk ngrihet dot.

ESTRAGONI: Eja të ikim këtej.

VLADIMIRI: Nuk mundemi.

ESTRAGONI: Pse?

VLADIMIRI: Po presim Godonë.

ESTRAGONI: Ke të drejtë.

VLADIMIRI: Mbase i kanë mbetur ende kocka për ty.

ESTRAGONI: Kocka?

VLADIMIRI: Kocka pule. Nuk të kujtohet?

ESTRAGONI: Ky është?

VLADIMIRI: Po.

ESTRAGONI: Pyete.

VLADIMIRI: Sikur ta ndihmonim njëherë?

ESTRAGONI: Ta ndihmonim për çfarë?

VLADIMIRI: Që të ngrihej.

ESTRAGONI: Nuk ngrihet dot?

VLADIMIRI: Do që të ngrihet.

ESTRAGONI: Le të ngrihet, atëherë.

VLADIMIRI: Nuk mundet.

ESTRAGONI: Pse, ç'ka?

VLADIMIRI: Nuk e di.

*Poco përthyeret dysh, rënkon, godet tokën me grushta.*

ESTRAGONI: Sikur t'i kërkonim kockat njëherë? Po s'pranoi e lëmë atje ku është.

VLADIMIRI: Do të thuash që e kemi në dorë?

ESTRAGONI: Po.

VLADIMIRI: Dhe që duhet t'i vëmë kushte për shërbimin që do t'i bëjmë.

ESTRAGONI: Po.

VLADIMIRI: Kjo më duket punë me mend, por kam frikë se...

ESTRAGONI: Se çfarë?

VLADIMIRI: Kam frikë se mos ngrihet Luki dhe na piu e zeza pastaj.

ESTRAGONI: Luki?

VLADIMIRI: Ai që të sulmoi dje.

ESTRAGONI: Po të them që ata qenë dhjetë vetë.

VLADIMIRI: Po jo ore, jo, më përpara, ai që të goditi me shqelma.

ESTRAGONI: Këtu është ai?

VLADIMIRI: Hapi sytë! *(Tregon me dorë)* Tani për tani duket si i vdekur, por mund të tërbohohet brenda minutit.

ESTRAGONI: Sikur t'i jepnim një dru të mirë, të dy bashkë.

VLADIMIRI: Mos do të thuash ta shqepnim tani që po fle?

ESTRAGONI: Po.

VLADIMIRI: E di që s'e ke keq ti. Po a ia dalim dot? Fle, thua, vërtet? (*Heshtje për një hop*) Jo, më mirë do të ishte të ndihmonim Pocon që kërkon ndihmë e të përfitonim pastaj nga mirënjohja e tij.

ESTRAGONI: Por ai nuk...

VLADIMIRI: Mos të humbasim kohë me fjalë boshe. (*Hesht për një kohë. Me pasion*) Le të bëjmë diçka tani që na jepet rasti! Jo gjithmonë na kërkojnë ndihmë. S'është se kanë vërtet nevojë për ne. Të tjerë mund ta bënin punën po aq mirë, në mos më mirë. Kjo thirrje, që sapo dëgjuam, i drejtohet gjithë njerëzimit. Por në këtë vend, në këtë çast, njerëzimi jemi ne, na pëlqen apo s'na pëlqen neve. Le të përfitojmë, sa s'është vonë, t'i përfaqësojmë një herë të vetme denjësisht fundërrinat me të cilat na mpleksi fati i zi. Si thua? (*Estragoni nuk thotë asgjë.*) Vërtet që duke ndenjtur duarkryq e duke peshuar anët e mira e të këqija, ne nderojmë vetveten. Tigri hidhet në ndihmë të sojit të vet pa një pa dy. Ose ia mbath thellë e më thellë zabelit. Po nuk është puna aty. Ç'bëjmë ne këtu, këtë pyetje duhet t'i bëjmë vetes. Kemi fatin ta dimë përgjigjen. Po, në gjithë këtë ngatërresë, një gjë është e qartë: ne po presim Godonë.

ESTRAGONI: Ke të drejtë.

VLADIMIRI: Ose po presim të bjerë nata. (*Hesht një hop*) Kemi një takim dhe kaq. Nuk jemi shenjtorë, kemi thjesht një takim. Sa njerëz mund të ndodhen në këtë pozitë?

ESTRAGONI: Sa të duash.

VLADIMIRI: Kështu thua ti?

ESTRAGONI: Nuk e di.

VLADIMIRI: Ka mundësi.

POCO: Ndhimë!

VLADIMIRI: S'ka as më të voglin dyshim që në kushtet tona koha nuk shtyhet, dhe pikërisht këtë gjë na bën që ta mbushim me bëmat tona që, si të thuash, në pamje të parë mund të duken të menduara mirë, por që s'janë veç veprime të zakonshme. Ti do thuash se e bëjmë që të mos na erret mendja. Mirë, por nganjëherë pyes veten: A s'endet vallë mendja në thellësitë e natës së përhershme? Po më ndjek?

ESTRAGONI: Ne të gjithë lindim të çmendur. Disa mbeten të tillë për gjithë jetën.

POCO: Ndhimë, do t'ju jap para!

ESTRAGONI: Sa?

POCO: Njëqind franga!

ESTRAGONI: Nuk mjaftojnë.

VLADIMIRI: Mos e tepro.

ESTRAGONI: Thua janë boll?

VLADIMIRI: Jo, desha të them se e tepron kur thua që kur kam lindur s'i kisha trutë në vend. Nuk është aty puna.

POCO: Dyqind.

VLADIMIRI: Po presim. Po mërzitemi (*Ngre dorën*) Jo, mos kundërshto, po mërzitemi, që ç'ke me të, kjo s'ka diskutim. Ashtu. Na jepet rasti të englandisemi pak dhe ç'bëjmë ne? E lëmë të shkojë dëm. Shpejt, t'i përvishemi punës! (*Bën për nga Pocolja, ndalet*) Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, çdo gjë do të zhduket, ne do të jemi përsëri vetëm, si kërcu. (*Ëndërron*)

POCO: Dyqind!

VLADIMIRI: Erdhëm.

*Përpiqet të ngrëjë Pocon, nuk ia del dot, mbledh forcat, pengohet te bagazhet, rrëzohet, përpiqet të ngrihet, por nuk mundet.*

ESTRAGONI: Ç'ju gjeti kështu të gjithëve?

VLADIMIRI: Ndhimë!

ESTRAGONI: Po iki.

VLADIMIRI: Mos më braktis! Ata do të më vrasin!

POCO: Ku jam këtu?

VLADIMIRI: Gogo!

POCO: Më ndihmo!

ESTRAGONI: Unë po iki.

VLADIMIRI: Më ndihmo njëherë mua. Pastaj ikim bashkë.

ESTRAGONI: Do ta mbash fjalën?

VLADIMIRI: Të betohem.

ESTRAGONI: Dhe nuk do të kthehem kurrë më.

VLADIMIRI: Kurrë!

ESTRAGONI: Do të shkojmë në Ariezhë.

VLADIMIRI: Ku të duash ti.

POCO: Treqind! Katërqind!

ESTRAGONI: Kam patur gjithmonë qejf të bredh nëpër Ariezhë!

VLADIMIRI: Do të bredhësh sa të duash.

ESTRAGONI: Kush pordhi?

VLADIMIRI: Pocolja.

POCO: Unë, unë. Mëshirë!

ESTRAGONI: Na e shpifi.

VLADIMIRI: Shpejt, shpejt! Ma jep dorën.

ESTRAGONI: Po iki. (*Hesht një copë herë. Me zë më të lartë*) Po iki.

VLADIMIRI: Fundi i fundit, do të arrij të ngrihem vetë! (*Përpiqet të ngrihet, rrëzohet përsëri*) Herët a vonë.

ESTRAGONI: Çfarë ke?

VLADIMIRI: Zhduku!

ESTRAGONI: Do rrish aty?

VLADIMIRI: Tani për tani, po.

ESTRAGONI: Çohu, pra, do marrësh plevitin.

VLADIMIRI: Mos u merakos për mua.

ESTRAGONI: Lëri këto, Didi, mos ngul këmbë si mushka. (*I zgjat dorën Vladimirit, që nxiton ta kapë*) Hajde, çohu!

VLADIMIRI: Më tërhiq!

*Estragoni e tërheq, i merren këmbët, rrëzohet. Heshtje.*

POCO: Ndhimomëni!

VLADIMIRI: Ja ku na ke.

POCO: Kush jeni ju?

VLADIMIRI: Njerëz jemi.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Sa mirë që është këtu përtokë!

VLADIMIRI: A mund të ngrihesh?

ESTRAGONI: Nuk e di.

VLADIMIRI: Pa provoje.

ESTRAGONI: Prit një çikë, prit.

*Qetësi.*

POCO: Ç'ndodhi?

VLADIMIRI: (*me forcë*) Mbylle të shkretën! Zullap! Vetëm për vete mendon.

ESTRAGONI: Sikur të përpiqeshim të flinim.

VLADIMIRI: Dëgjon ti? Do të dijë ç'ka ndodhur!

ESTRAGONI: Varja! Fli!

*Qetësi.*

POCO: Mëshirë! Mëshirë!

ESTRAGONI: *(duke kërcyer përpjjetë)* Çfarë? Ç'është?

VLADIMIRI: Po flije?

ESTRAGONI: Ashtu më duket.

VLADIMIRI: Prapë ky qelbaniku, Poco!

ESTRAGONI: Thuaj ta qepi! Thyeja turinjtë!

VLADIMIRI: *(duke goditur Pocon)* Mbarove? Do ta qepësh?  
Kopuk! *(Poco shkëputet prej tij duke bërtitur nga dhimbja dhe largohet duke u tërhequr zvarrë. Kohë pas kohe ndalet, çan ajrin me gjestet e tij prej të verbri, duke thirrur Lukin. Vladimiri, i mbështetur mbi bërryl, e ndjek me sy)* Ia mbathi!  
*(Pocoja shembet përdhe. Qetësi)* U rrëzua.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Ç' do bëjmë tani?

VLADIMIRI: Sikur të tërhiqem zvarrë deri tek ai.

ESTRAGONI: Mos më lër vetëm!

VLADIMIRI: Sikur ta thërrisja?

ESTRAGONI: Ashtu po, thirre.

VLADIMIRI: Poco! *(Heshtje një copë herë)* Poco! *(Heshtje një copë herë)* Nuk përgjigjet më.

ESTRAGONI: E thërrasim bashkë.

VLADIMIRI, ESTRAGONI: Poco! Poco!

VLADIMIRI: Lëvizi!

ESTRAGONI: Je i sigurt që e quajnë Poco?

VLADIMIRI: *(gjithë ankth)* Zoti Poco! Kthehu! Nuk të bëjmë gjë.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Sikur ta thërrisim me emra të tjerë?

VLADIMIRI: Kam frikë se mos i ka ngelur hatri me gjithë mend.

ESTRAGONI: Sa e lezetshme do të ishte.

VLADIMIRI: Çfarë do të ishte e lezetshme?

ESTRAGONI: Ta thërrisim me emra të tjerë, njëri pas tjetrit. Do të englandiseshim. Në fund do të gjenim emrin e tij të vërtetë.

VLADIMIRI: Unë të them që quhet Poco.

ESTRAGONI: Do ta shohim. Pa prit! *(Mendohet)* Abel! Abel!

POCO: Ndihamomëni!

ESTRAGONI: E sheh!

VLADIMIRI: Po më vjen në majë të hundës kjo mesele.

ESTRAGONI: Mbase quhet Kain! (*E thërret*) Kain! Kain!

POCO: Ndhimomëni!

ESTRAGONI: Ky na qenka njerëzimi mbarë. (*Qetësi*) Pa shikoje atë renë e vockël.

VLADIMIRI: (*duke ngritur sytë*) Ku?

ESTRAGONI: Atje, në mes të qiellit.

VLADIMIRI: Po pastaj? Ç'na paska kaq të veçantë ajo re?

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Po deshe, e lëmë këtë muhabet.

VLADIMIRI: Këtë doja të të thosha edhe unë.

ESTRAGONI: Po për çfarë të flasim?

VLADIMIRI: Hë, pra!

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Sikur të ngriheshim, njëherë.

VLADIMIRI: Le të përpiqemi.

*Ngrihen.*

ESTRAGONI: S'është ndonjë gjë e madhe.

VLADIMIRI: Mjafton të kesh vullnet!

ESTRAGONI: Po tani?

POCO: Ndhimë!

ESTRAGONI: Ikim!

VLADIMIRI: Nuk mundemi!

ESTRAGONI: Pse?

VLADIMIRI: Po presim Godonë.

ESTRAGONI: Ke të drejtë! (*Heshtje për një copë herë*) Ç't'i bësh?

POCO: Ndhimë!

VLADIMIRI: Sikur ta ndihmonim?

ESTRAGONI: Ç'duhet të bëjmë?

VLADIMIRI: Ai do të ngrihet.

ESTRAGONI: Po pastaj?

VLADIMIRI: Do që ta ndihmojmë të ngrihet.

ESTRAGONI: Epo mirë, e ndihmojmë. Ç'presim?

*E ndihmojnë Pocon të ngrihet, hiqen mënjane. Ai bie prapë.*

VLADIMIRI: Duhet ta mbajmë. (*Bëjnë po të njëjtat veprime. Poco qëndron në këmbë midis të dyve, u varet në qafë*) Duhet të mësohet të qëndrojë prapë në këmbë. (*Pocos*) A je më mirë?



POCO: Kush jeni ju?  
 VLADIMIRI: Nuk po na njeh?  
 POCO: Jam i verbër.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Mbase ai e sheh qartë të ardhmen?  
 VLADIMIRI: (*Pocos*) Që prej sa kohe?  
 POCO: Kisha sy shumë të fortë – por, a jeni miq?  
 ESTRAGONI: (*qesh me zhurmë*) Pyet nëse jemi miq!  
 VLADIMIRI: Jo, e ka fjalën në jemi miq të tij.  
 ESTRAGONI: Po pastaj?  
 VLADIMIRI: Përderisa e ndihmuam.  
 ESTRAGONI: Tamam! A do ta kishim ndihmuar po të mos ishim miq të tij?  
 VLADIMIRI: Mbase.  
 ESTRAGONI: S'ka pikë dyshimi.  
 VLADIMIRI: Të mos kapemi pas fjalëve tani.  
 POCO: Mos jeni banditë?  
 ESTRAGONI: Banditë? Mos dukemi gjë si banditë?  
 VLADIMIRI: Ç'pret! Ai është i verbër.  
 ESTRAGONI: Ta hajë dreqi! Ke të drejtë! (*Heshtje për një copë herë*) E tha vetë.  
 POCO: Mos më lini vetëm.  
 VLADIMIRI: As që bëhet fjalë.  
 ESTRAGONI: Tani për tani.  
 POCO: Sa është ora?  
 ESTRAGONI: (*duke këqyrur qiellin*) Ta shohim...  
 VLADIMIRI: Shtatë?... Tetë?..  
 ESTRAGONI: Varet nga stina.  
 POCO: Ka rënë mbrëmja?  
*Qetësi. Vladimiri dhe Estragoni shohin perëndimin.*  
 ESTRAGONI: Duket sikur po lind dielli.  
 VLADIMIRI: Nuk është e mundur.  
 ESTRAGONI: Po sikur të ishte agim?  
 VLADIMIRI: Mos këput broçkulla. Andej është perëndimi.  
 ESTRAGONI: Nga e di ti?  
 POCO: (*gjithë ankth*) Darkë është tani?  
 VLADIMIRI: Nuk ka lëvizur vendit.  
 ESTRAGONI: Unë të them që dielli po ngrihet në horizont.

POCO: Përse nuk përgjigjeni?

ESTRAGONI: Sepse nuk duam t'ju themi broçkulla.

VLADIMIRI: (*duke dashur ta qetësojë*) Është mbrëmje, zotëri. Erdhi mbrëmja. Miku im përpigjet të më ngjallë dyshim për këtë, dhe duhet të pohoj se për një çast u lëkunda. Por unë e kalova vetë në kurriz gjithë këtë ditë të gjatë, dhe ju siguroj se asaj po i vjen fundi. (*Heshtje një copë herë*) Po t'i lemë këto, si ndiheni?

ESTRAGONI: Akoma do ta mbajnë ne këtë? (*Gati e lëshojmë, por e kapin përsëri sepse e shohim se Pocoja po bie*) Ç'u bëjnë ne, hamej?

VLADIMIRI: Nëse nuk gabohem, ju thatë se shikonit shumë mirë dikur?

POCO: Po, shikoja goxha mirë.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: (*i acaruar*) Flisni shkoqur! Shpjegohuni!

VLADIMIRI: Lëre rehat. Nuk e sheh se po kujton të shkuarën e tij të lumtur. (*Heshtje për një copë herë*) *Memoria praeteritorum honorum* – duhet të jetë e dhimbshme.

POCO: Po, shikoja goxha mirë.

VLADIMIRI: Dhe u verbuat krejt papritur?

POCO: Goxha mirë.

VLADIMIRI: Ju pyeta nëse u verbuat krejt papritur.

POCO: Një ditë të bukur, u zgjova i verbër si fati. (*Pauzë*) Nganjëherë pyes veten mos jam akoma në gjumë.

VLADIMIRI: Kur ndodhi kjo?

POCO: Nuk e di.

VLADIMIRI: Jo më larg se dje...

POCO: Mos më bëni pyetje. Të verbërit e humbasin nocionin e kohës. (*Heshtje një copë herë*) Dhe gjithçka që lidhet me kohën ata nuk mund ta shohin.

VLADIMIRI: Shiko, shiko! Unë isha i bindur se ndodhte e kundërta.

ESTRAGONI: Po iki.

POCO: Ku jemi këtu?

VLADIMIRI: Nuk e di.

POCO: Mos jemi në vendin e quajtur «Dërrasa»?

VLADIMIRI: S'e kam idenë.

POCO: Me çfarë të ngjan ky vend?

VLADIMIRI: (*shëh rreth e përçark*) S'përshkruhet dot. Është tepër i veçantë. Nuk ka asgjë, ka vetëm një pemë.

POCO: Atëherë nuk është «Dërrasa».

ESTRAGONI: (*duke u përçulur*) Do të thuash që kemi dalë në tjetër vend?

POCO: Ku është shërbëtori im?

VLADIMIRI: Këtu e ke.

POCO: Përse nuk përgjigjet kur e thërras?

VLADIMIRI: Nuk e di. Duket sikur fle. Mbase ka vdekur;

POCO: Çfarë ndodhi në të vërtetë?

ESTRAGONI: Në të vërtetë!

VLADIMIRI: Ju u rrëzuar që të dy.

POCO: Shkoni shihni se mos është plagosur.

VLADIMIRI: Po nuk mundemi t'ju lëmë vetëm.

POCO: S'është nevoja të shkoni të dy.

VLADIMIRI: (*Estragonit*) Shko ti.

POCO: Bukuri, le të shkojë miku juaj. Ai qelbet erë. (*Kalon një copë herë*) Ç'pret ai, pse s'ikën?

VLADIMIRI: (*Estragonit*) Ç'pret ti?

ESTRAGONI: Po pres Godonë.

VLADIMIRI: (*Pocos*) Çfarë duhet të bëjë ai pra?

POCO: Po ja, të tërheqë njëherë litarin, duke bërë kujdes natyrisht që të mos e mbysë. Zakonisht kështu reagon. Në mos po le t'i japë ca shqelma në fund të barkut e fytyrës me sa të mundet.

VLADIMIRI: (*Estragonit*) E sheh, s'ke pse të kesh frikë. Madje ke rastin të hakmerresh.

ESTRAGONI: Po sikur të mbrohet?

POCO: Jo, jo, ai nuk mbrohet kurrë.

VLADIMIRI: Unë do të të vija në ndihmë me një frymë.

ESTRAGONI: Mos m'i ndaj sytë! (*Niset drejt Lukit*)

VLADIMIRI: Shiko njëherë a është gjallë. Po të ketë vdekur s'është nevoja ta godasësh.

ESTRAGONI: (*duke u përçulur mbi Lukin*) Merr frymë.

VLADIMIRI: Atëherë, jepi.

*Estragoni si i shkalluar e shqep Lukin në shqelma, duke sokëllitur. Por vret këmbën dhe largohet duke çaluar dhe duke rënkuar. Luki vjen në vete.*

ESTRAGONI: (*duke ndenjur me një këmbë*) Oh, kafsha!  
 Estragoni ulet, përpiqet të heqë këpucët. Por shpejt heq dorë,  
 mblidhet kruspull kokë e këmbë bashkë dhe mbulon kokën  
 me krabë.

POCO: Ç'ndodhi prapë?

VLADIMIRI: Miku im u vra.

POCO: Po Luki?

VLADIMIRI: Ai qenka pra?

POCO: Si?

VLADIMIRI: Ky është Luki, hë?

POCO: Nuk po kuptoj gjë.

VLADIMIRI: Po ju, Pocoja jeni?

POCO: Sigurisht, Pocoja jam.

VLADIMIRI: Ata të djeshmit?

POCO: Të djeshmit?

VLADIMIRI: Jemi parë bashkë dje. (*Qetësi*) Nuk ju kujtohet?

POCO: Nuk më kujtohet të kem takuar njeri dje. Por edhe  
 nesër nuk do të më kujtohet që kam takuar njeri sot. Mos  
 mbani shpresën tek unë për të marrë të dhëna. Le që si  
 shumë e zgjatëm. Çohu!

VLADIMIRI: Ju po e çonit në Shën-Sovër për ta shitur. Kështu  
 na thatë. Ai kërceu, mendoi. Ju shikonit mirë.

POCO: Meqë e thoni ju. Lëshomëni, ju lutem. (*Vladimiri hiqet  
 mënjanë*) Çohu!

VLADIMIRI: Po ngrihet.

*Luki ngrihet dhe merr bagazhet.*

POCO: Dhe bën mirë.

VLADIMIRI: Për ku jeni nisur kështu?

POCO: Nuk merrem unë me këtë punë.

VLADIMIRI: Sa keni ndryshuar!

*Luki, i ngarkuar me bagazhet, vjen e qëndron prapa Pocos.*

POCO: Kamzhikun! (*Luki lë përtokë bagazhet, kërkon  
 kamzhikun, e gjen, ia jep Pocos, merr përsëri bagazhet*) Lita-  
 rin! (*Luki lë përtokë bagazhet, ia jep litarin në dorë Pocos,  
 merr përsëri bagazhet*)

VLADIMIRI: Çfarë ka në valixhe?

POCO: Rërë! (*Tërheq litarin*) Nisu! (*Luki fillon të ecë, Poco e  
 ndjek pas*)

VLADIMIRI: Prisni dhe pak.

POCO: (*duke u ndalur në vend*) Po nisem.

VLADIMIRI: Si ia bëni kur rrëzoheni dhe s'keni kurrkend aty pranë që t'ju ndihmojë?

POCO: Presim deri sa të ngrihemi dhe pastaj nisemi përsëri.

VLADIMIRI: Para se të ikni, i thoni të këndoje.

POCO: Kujt?

VLADIMIRI: Lukit.

POCO: Të këndoje?

VLADIMIRI: Po. Ose të mendojë. Ose të recitojë.

POCO: Po ai është memec.

VLADIMIRI: Memec?

POCO: Dhe çfarë memeci se. As për të rënkuar s'rënkon dot.

VLADIMIRI: Memec! Që kur kështu?

POCO: (*papritur nevrikoset*) Më nxitë jetën me ato muhabetet e kohës! Kjo s'ka pikë logjike! Kur? Kur? Një ditë prej ditësh, një ditë si gjithë të tjerat ai e humbi gojën, nuk ju mjafton kjo? Një ditë unë u verbova, një ditë do të shurdhohemi, një ditë kemi lindur, një ditë do të vdesim, në të njëjtën ditë, në të njëjtin çast, nuk ju mjafton kjo? (*Më shtruar*) Ato pjellin kaluar mbi një varr, dita shkëlqen për një çast, pastaj vjen sërish nata. (*Tërheq litarin*) Nisu!

*Dalin nga skena. Vladimiri e ndjek deri te kufiri i skenës dhe i sheh tek largohen. Një zburmë rënieje, e shoqëruar me mikën e Vladimirit, lë të kuptojë që ata janë rrëzuar përsëri. Qetësi. Vladimiri shkon drejt Estragonit që fle, e kundron për disa çaste dhe pastaj e zgjon.*

ESTRAGONI: (*bën gjeste prej të alarmuari, thotë fjalë pa lidhje logjike*) Përse nuk më lë njëherë të fle rehat?

VLADIMIRI: Ndihesha i vetmuar.

ESTRAGONI: Po shikoja në ëndërr sikur isha i lumtur.

VLADIMIRI: E paske shtyrë kohën bukuri.

ESTRAGONI: Po shihja në ëndërr sikur...

VLADIMIRI: Qepe! (*Qetësi*) Pyes veten nëse është me të vërtetë i verbër?

ESTRAGONI: Kush?

VLADIMIRI: Si tha, i verbër që s'e kish idenë e kohës?

ESTRAGONI: Kush?

VLADIMIRI: Poco.

ESTRAGONI: Pse, i verbër qenka?

VLADIMIRI: Ashtu na tha.

ESTRAGONI: Po pastaj?

VLADIMIRI: M'u duk sikur na shihte.

ESTRAGONI: Ke parë ëndërr. (*Heshtje për një copë herë*) Ikim që këtej. Nuk mundemi. Vërtet. (*Hesht një copë herë*) Je i sigurt që nuk ishte ai?

VLADIMIRI: Kush?

ESTRAGONI: Godoja?

VLADIMIRI: Po kush pra?

ESTRAGONI: Poco.

VLADIMIRI: Jo mor jo! Jo! (*Heshtje për një copë herë*) Jo mor jo.

ESTRAGONI: Sidoqoftë unë po ngrihem. (*Ngrihet me mundim*) O le le!

VLADIMIRI: Nuk di ç'të mendoj.

ESTRAGONI: Këmbët, vdiqa! (*Ulet prapë, përpiqet të heqë këpucët*) Ndihmomë!

VLADIMIRI: Mos ia mora me gjumë kur të tjerët vuanin? Mos po fle tani? Nesër kur të zgjohem, ç'do të them për ditën e sotme? Që me Estragonin, mikun tim, këtu, në këtë vend, deri sa ra nata, prita Godonë? Që kaloi Pocoja me hamallin e tij edhe që na foli? Padyshim që do t'i them këto. Po a ka ndonjë gjë të vërtetë në këtë mes? (*Estragoni, pasi jep e merr kot me këpucët e tij, dremit përsëri. Vladimiri e sheh*) Ai nuk do të marrë vesh gjë nga kjo botë, asgjë. Do të flasë për shqelmat që hëngri dhe unë do t'i jap një karrotë. (*Hesht një copë herë*) Kaluar mbi një varr, një lindje e vështirë. Në fund të gropës i përhumbur, varmihësi jep e merr me hekurat e tij. Kemi kohë të plakemi. Rrath e qark dëgjohen britmat tona. (*Mban vesh*) Kur mësohesh, nuk të bën më përshtypje (*Sheh Estragonin*) Edhe mua, dikush tjetër më sheh dhe thotë, Ai po fle, ai nuk di se ç'ngjet, le të flerë! (*Hesht për një copë herë*) Nuk vazhdoj dot më. (*Hesht një copë herë*) Çfarë thashë?

*Vete e vjen i shqetësuar, ndalet më në fund te prapaskena majtas, sheh larg. Hyn nga e djathta djali i një dite më parë. Ndalet. Qetësi.*

DJALI: Zotëri... (*Vladimiri kthehet*) Zoti Albert...

VLADIMIRI: Si, si the? Edhe njëherë? (*Hesht një çast. Djalit*)  
Nuk më njeh?

DJALI: Jo, zotëri.

VLADIMIRI: Ai ishte ti dje këtu?

DJALI: Jo, zotëri.

VLADIMIRI: Hera e parë është që vjen këtu?

DJALI: Po zotëri.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Zoti Godo të ka dërguar?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Nuk do të vijë sonte.

DJALI: Jo, zotëri.

VLADIMIRI: Po do të vijë nesër.

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Është e sigurt.

DJALI: Po, zotëri.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: A takove njeri?

DJALI: Jo, zotëri.

VLADIMIRI: Dy (*ngurron*)... njerëz të tjerë.

DJALI: Nuk kam parë njeri, zotëri.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Me se merret zoti Godo? (*Hesht një çast*) Dëgjon?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Hë pra, me se merret?

DJALI: Nuk merret me asgjë, zotëri.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Si ia çon yt vëlla?

DJALI: Është i sëmurë, zotëri.

VLADIMIRI: Mos ishte ai dje këtu?

DJALI: Nuk e di, zotëri.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Ka mjekër zoti Godo?

DJALI: Po, zotëri.

VLADIMIRI: Të verdhë apo (*mëdyshtet*)... të zezë?

DJALI: (*mëdyshtet*) Më duket se të bardhë, zotëri.

*Qetësi.*

VLADIMIRI: Sa keq.

DJALI: T'i them gjë zotit Godo, zotëri?

VLADIMIRI: Do t'i thuash – (*e pret fjalën në mes*) – t'i thuash që më takove – (*mendohet*) – që më takove. (*Hesht një çast. Vladimiri bën përpara, djali zbrapset, Vladimiri ndalet, djali po ashtu*) Pa më thuaj, je i sigurt që më takove, se mos më thuash nesër që nuk më ke parë kurrë?

*Qetësi. Papritur Vladimiri kërcen përpara, djali ia mbath si shigjetë. Qetësi. Dielli perëndon, del hëna. Vladimiri qëndron pa lëvizur. Estragoni zgjohet, z bath këpucët, ngrihet me këpucë në dorë, i vë në fund të skenës, shkon drejt Vladimirit, e vështron.*

ESTRAGONI: Ç'ke kështu?

VLADIMIRI: S'kam gjë.

ESTRAGONI: Unë po iki.

VLADIMIRI: Edhe unë.

*Heshtje.*

ESTRAGONI: Kam shumë që fle?

VLADIMIRI: Nuk e di.

*Heshtje.*

ESTRAGONI: Ku do shkojmë?

VLADIMIRI: Jo dhe aq larg.

ESTRAGONI: Jo, jo, do të ikim larg që këtej.

VLADIMIRI: Nuk mundemi.

ESTRAGONI: Pse?

VLADIMIRI: Duhet të kthehem nesër.

ESTRAGONI: Pse ç'do bëjmë këtu?

VLADIMIRI: Do të presim Godonë.

ESTRAGONI: Ke të drejtë! (*Hesht një copë herë*) Nuk erdhi?

VLADIMIRI: Jo.

ESTRAGONI: Tani u bë shumë vonë.

VLADIMIRI: Po, u bë natë.

ESTRAGONI: Sikur ta linim fare këtë punë? (*Hesht një çast*)

Sikur ta linim fare?

VLADIMIRI: Ai do të na ndëshkonte. (*Qetësi. Sheh pemën*)

Vetëm pema jeton.

ESTRAGONI: (*duke parë pemën*) Ç'është kjo?

VLADIMIRI: Është pemë.



ESTRAGONI: Desha të them ç'lloj peme është?

VLADIMIRI: Nuk e di. Shelg.

ESTRAGONI: Eja këtu të shohësh. (*E tërheq Vladimirin drejt pemës. Ndalet para saj. Qetësi*) Sikur të varnim veten?

VLADIMIRI: Me se të varemi?

ESTRAGONI: Nuk ke ndonjë copë litar?

VLADIMIRI: Jo.

ESTRAGONI: Atëherë, s'bëjmë dot gjë.

VLADIMIRI: Ikim.

ESTRAGONI: Prit, kam rripin.

VLADIMIRI: Është shumë i shkurtër.

ESTRAGONI: Më tërhiq ti nga këmbët.

VLADIMIRI: Po mua, kush të më tërheqë?

ESTRAGONI: Ke të drejtë.

VLADIMIRI: Megjithatë dale ta shoh njëherë. (*Estragoni zgjidh ushkurin që i mban pantallonat. Pantallonat, shumë të gjera, i bien deri te nyajt. Të dy shohin ushkurin.*) Fundi i fundit, edhe mund ta përdorim. Po a është i fortë?

ESTRAGONI: Ta shohim. Mbaje.

*Kapin secili nga një skaj të ushkurit dhe e tërheqin. Ushkuri këputet. Të dy sa s'bien.*

VLADIMIRI: S'vlen një grosh.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Si the që duhet të vijmë prapë nesër?

VLADIMIRI: Po.

ESTRAGONI: Atëherë të marrim me vete një litar të fortë.

VLADIMIRI: Mirë e ke.

*Qetësi.*

ESTRAGONI: Didi.

VLADIMIRI: Po.

ESTRAGONI: Nuk mund ta shtyj më kështu.

VLADIMIRI: Kështu thonë të gjithë.

ESTRAGONI: Sikur të ndaheshim? Mbase do të na ecte më mirë.

VLADIMIRI: Do të varemi nesër. (*Hesht një çast*) Veç në ardh të Godoja.

ESTRAGONI: Po erdhi?

VLADIMIRI: Atëherë e hodhëm lumin.

*Duke pritur Godonë*

*Vladimiri heq kapelen – atë të Lukit – shikon brenda saj, fut dorën, e shkund dhe e vë prapë.*

ESTRAGONI: Si thua, ikim?

VLADIMIRI: Ngri pantallonat.

ESTRAGONI: Si?

VLADIMIRI: Ngri pantallonat.

ESTRAGONI: Të heq pantallonat.

VLADIMIRI: Ngri pantallonat.

ESTRAGONI: Ah, po vërtet!

*Ngre pantallonat. Qetësi.*

VLADIMIRI: Atëherë ikim?

ESTRAGONI: Ikim.

*Nuk lëvizin vendit.*

BIE PERDJA

*Oh ato ditë të bukura*

*Përktheu  
Anton Papleka*



PERSONAZHET

VINI, rreth të pesëdhjetave  
VILI, rreth të gjashtëdhjetave

## AKTI I PARË

*Një sipërfaqe me bar të zhuritur, e cila ka në mes një sukë të vogël. Në të majtë, në të djathtë dhe nga ana e paraskenës suka ka shpate të buta. Brinja që ndodhet në anën e prapme të saj është më e pjerrët dhe zbret deri në nivelin e skenës. Sa më shumë thjeshtësi e simetri.*

*Dritë verbuese.*

*Një sfond tepër konvencional, një qiell pa re dhe një rrafshinë e zhveshur që puqen në horizontin e largët.*

*VINI ndodhet mu në mes të sukës, e futur në dhe deri në bel. Rreth të pesëdhjetave, ende ruan diçka nga bukuria e mëparshme, mundësisht flokëverdhe, e kolme, me krahë e supe të zhveshura, ka një dekolte shumë të ngrënë, kraharor të bëshëm, një gjerdan me perla. Vini po fle me krahët mbështetur mbi sukë e me kryet mbi krahë. Përbri saj, në të majtë, ka një çantë të madhe, të zezë, nga ato çantat si trasta, në të djathtë ka një ombrellë që mblidhet (tani e mbledhur), së cilës i duket vetëm doreza si kokë bastuni.*

*Prapa saj, në të djathtë, shtrirë përtokë, po fle VILI, të cilin suka nuk e lë të duket.*

*Pauzë e gjatë. Tringëllima e mprehtë e një zileje, që zgjat pesë sekonda, pastaj ndërpritet. Vini s'luan vendit. Një tringëllimë më e mprehtë, që zgjat tre sekonda. Vini zgjohet. Tringëllima ndërpritet. Ngre kokën, vështron përpara. Pauzë e gjatë. Ajo drejton shtatin, mbështet shuplakat mbi sukë, rrëzon kryet pas dhe ia ngul sytë zenitit. Pauzë e gjatë.*

*VINI: (Duke vështruar ngultas zenitin) Edhe një ditë hyjnore. (Pauzë. Ajo e mban kokën drejt, vështron përpara. Pauzë. Bashkon duart mbi gjoks, mbyll sytë. Lëviz buzët, tek thotë një lutje pa zë, për pesë sekonda. Buzët nuk lëvizin më, duart mbeten të puqura. Me zë të ulët) O Jezu-Krisht, amin. (I hap*

sytë, i shkëput duart dhe i mbështet prapë mbi sukë. Pauzë. Ajo i puq sërish duart, i ngre sërish para krabrorit. Lëviz buzët përsëri, tek vazhdon lutjen pa zë për tre sekonda. Me zë të ulët) Në jetë të jetëve, amin. (Hap sytë, shkëput duart dhe i mbështet prapë mbi sukë. Pauzë) Filloje, Vini. (Pauzë) Filloje ditën tënde, Vini. (Pauzë. Ajo kthehet nga çanta, rrëmon në të pa e lëvizur vendit, nxjerr prej saj një furçë dhëmbësh, rrëmon prapë, nxjerr një tubet pastë dhëmbësh të shtypur, kthehet përpara, i heq kapakun tubetit, e vë kapakun mbi sukë, hedh me vështirësi pak pastë mbi furçë, në një dorë mban tubetin, në tjetrën furçën e dhëmbëve. Si me turp kthen kokën djathtas, e përkul praptas për të pështyrë matanë sukës. Kështu e ka Vilin para syve. Pështyn, pastaj përkulet pak më shumë) Hu-Hu! (Pauzë. Më fort) Hu-hu! (Pauzë. Teksa kthehet përpara, buzëqesh me dhembshuri. E lë në vend furçën e dhëmbëve) I gjori Vili – (ajo këqyr tubetin, buzëqeshja shuhet) – është në të mbaruar – (kërkon kapakun) – po fundja – (merr kapakun) – s'ke ç'i bën – (vë kapakun) – s'është ndonjë e keqe e madhe – (e lë tubetin në vend) – një e keqe më shumë – (kthehet kah çanta) – që s'gjen derman (rrëmon në çantë) – kurrfarë dermani – (nxjerr një pasqyrë të vogël, kthehet përpara) – ah, po – (i këqyr me kujdes dhëmbët në pasqyrë) – i gjori Vili im i dashur – (i kontrollon me gishtin e madh dhëmbët prerës të nofullës së sipërme, me zë gati të mekur) – ta marrë dreqi! – (përvesh buzën e sipërme për të kontrolluar nullat, me po atë zë) – O zot i madh! – (tërheq anash një cep të gojës, duke e mbajtur gojën hapur, me po atë zë) – po fundja – (tërheq cepin tjetër të gojës, me po atë zë) – s'qenkan më keq – (i jep fund të kontrolluarit, me zë normal) – as më mirë, as më keq – (e lë në vend pasqyrën) – njësoj janë – (fshin gishtat pas barit) – dhimbje s'kam – (kërkon furçën e dhëmbëve) – pothuaj s'kam fare – (merr furçën) – kjo është mrekullia vetë – (këqyr bishtin e furçës) – s'ka si kjo furçë – (këqyr bishtin e furçës e lexon) – e pastër... çfarë? – (Pauzë) – çfarë? – (e lë furçën në vend) – ah, po (kthehet kah çanta) – i gjori Vili – (rrëmon në çantë) – s'ka shije fare – (rrëmon) – për asgjë – (nxjerr një këllëf syzesh) – s'ka asnjë qëllim – (kthehet përpara) – në jetë – (nxjerr syzet nga këllëfi)

– i gjori Vili im i dashur – *(e lë në vend këllëfin)* – vetëm t’ia këpusë gjumit di – *(i hap bishtat e syzeve)* – dhunti e mreku-llueshme – *(i vë syzet)* – S’ka më mirë *(kërkon furçën e dhëmbëve)* – për mendimin tim – *(merr furçën)* e kam thënë ngaherë – *(këqyr bishtin e furçës)* – ah, ta kisha edhe unë! – *(këqyr bishtin dhe lexon)* – e vërtetë e pastër... çfarë? – *(e lë në vend furçën)* – tani po më lënë edhe sytë – *(i heq syzet)* – po fundja – *(i lë në vend syzet)* – mjaft kam parë – *(kërkon shaminë futur në gji)* – sigurisht – *(nxjerr shaminë e palosur)* – prej kohësh – *(e shpalos shaminë, duke e shkundur)* – si thonë ato vargjet e mreku-llueshme? – *(fshin njërin sy)* – o fat i zi – *(fshin syrin tjetër)* – ç’po shohin sytë e mi – *(kërkon syzet)* – ah, po – *(i merr syzet)* – do të bëj si do të bëj edhe pa to – *(i fshin syzet me shami, duke hukatur xhamat)* – megjithëse s’i dihet – *(vazhdon të fshijë)* – dritë e bekuar – *(vazhdon të fshijë)* – humnerë e zezë – *(vazhdon të fshijë)* – të dalësh në sipërfaqe – *(vazhdon të fshijë)* – zjarr i dritës skë-terrore. *(Resht së fshiri, rrëzon kryet pas, vështron qiellin, e drejton kokën, zë të fshijë prapë, ndalet, e rrëzon kryet pas nga e djathta)* Hu-hu! *(Pauzë. Ajo buzëqesh me dhembshuri, teksa kthehet përpara dhe zë prapë të fshijë. Buzëqeshja shuhet)* Dhunti e mreku-llueshme – *(resht së fshiri, lë në vend syzet)* – ah, ta kisha edhe unë! – *(e palos prapë shaminë)* – po fundja – *(e vë shaminë në gji)* – nuk mund të qahem – *(kërkon syzet)* – jo, jo – *(vë syzet)* nuk duhet të qahem – *(i ngre syzet para syve)* – ka shumë arsye – *(vështron përmes njërit xham)* – për të qenë mirënjohëse – *(vështron përmes xhamit tjetër)* – s’kam dhimbje – *(vë syzet)* – pothuaj fare – *(kërkon furçën e dhëmbëve)* – kam këtë furçë të mreku-llueshme – *(merr furçën)* – që s’ke ku e gjen – *(këqyr bishtin e furçës)* – nganjëherë kam dhimbje koke të lehta – *(këqyr bishtin e furçës e lexon)* e garantuar... e vërtetë... e pastër... çfarë? – *(vështron më nga afër)* – e vërtetë, e pastër... *(merr shaminë në gji)* – ah, po – *(e shpalos shaminë duke e shkundur)* – herë pas here një migrenë fare e lehtë – *(fshin bishtin e furçës)* – më zë – *(vazhdon të fshijë)* – pastaj më kalon – *(fshin mekanikisht)* – ah, po – *(vazhdon të fshijë)* – ç’shpi-rt-madhësi! – *(vazhdon të fshijë)* – O Zot të qofsha falë! –

(resht së fshiri, me një vështrim të ngulët e të përhumbur, me një zë që i këputet) – ndoshta nuk është punë e kotë të lutesh – (Pauzë, me po atë zë) – në mëngjes – (Pauzë, me po atë zë) – e në mbrëmje – (ul kokën, zë prapë të fshijë, ndalet, ngre kokën, më e qetë, fshin sytë, palos prapë shaminë, e vë sërish në gjë, këqyr bishtin e furçës dhe lexon) – Publikisht... e vërtetë... e pastër... – (vështron më nga afër) ... e ga-vërtetë e pastër... – (heq syzet, i lë prapë në vend, kështu bën edhe me furçën, vështron përpara) – vjetërsira (Pauzë) Sy të plakur. (Pauzë e gjatë) – Jepi, Vini. – (vështron përreth, ia ngul sytë ombrellës një copë herë, e merr në dorë dhe hap bidorën e djathtë majën e ombrellës përkulet prapa dhe kapur me djathta, sipër Vilit) Hu-hu! (Pauzë) Vili! (Pauzë) Dhunti e mrekuullueshme. (Ajo e godet një herë me dorezën e ombrellës) Ah, ta kisha edhe unë! (E godet prapë. Ombrella i shpëton nga dora dhe bie prapa sukës. Vili ia zgjat menjëherë që prapa sukës pa u dukur) Falemnderit, i dashur. (E kalon ombrellën në dorën e majtë, kthehet përpara dhe këqyr pëllëmbën e djathtë) Gjithë djersë. (E kalon ombrellën në dorën e djathtë dhe këqyr pëllëmbën e majtë) Po fundja s'është më keq. (Ngre kokën lart, me ton gazmor) As më mirë, as më keq, njëlloj. (Pauzë. Me po atë ton) S'kam dhimbje. (Përkulet prapa për të shikuar Vilin, duke e mbajtur si më parë ombrellën nga maja) I dashur, të lutem mos u bëj i keq, mos fli prapë, mund të kem nevojë për ty. (Pauzë) Oh, pret puna, pret puna, veç mos u mblidh prapë kutullaç. (Ajo kthehet përpara, lë në vend ombrellën, i këqyr njëherësh të dyja pëllëmbët, i fshin pas barit) Sidoqoftë jam pak si paqejf, si e këputur. (Kthehet nga çanta, rrëmon në të, nxjerr që andej një revolver, e mban lart, i jep një të puthur të shpejtë; e fut prapë në çantë, rrëmon, nxjerr një shishkë që ka pak lëng të kuq, kthehet përpara, kërkon syzet, i vë, lexon etiketën) Rënie humori... këputje... mungesë oreksi... foshnja... fëmijë... të rritur... gjashtë lugë në gojë... të mbushura plot... çdo ditë. (ngre kokën, buzëqesh) – stili i vjetër! (shubet buzëqeshja, ajo përkul kokën prapë, lexon) – çdo ditë... para dhe pas... buke... përmirësim... (vështron më nga afër) – i menjëher-



shëm. (Heq syzet, i lë në vend, ngre lart shishkën për të parë deri ku arrin niveli i lëngut, heq kapakun, e pi përnjëherësh tërë lëngun e shishkës, me kokë të përkulur prapa, i hedh shishkën e kapakun nga ana e Vilit, dëgjohet zhurma e qelqit të thyer) Ah, tani jam më mirë! (Kthehet nga çanta, rrëmon në të, nxjerr një të kuq buzësh, kthehet përpara, e këqyr) Është në të mbaruar. (Kërkon syzet) Po fundja... (I vë syzet, kërkon pasqyrën) Nuk duhet të qahem. (Merr pasqyrën në dorë, fillon të lyejë buzët) Si thotë ai vargu i mrekuullueshëm? (Lyen buzët) Oh, gëzime fluturake – (lyen buzët) oh... tra-la-la kobe që të sosur s'keni. (Ajo lyen buzët. E ndërpret rrëmuja që bëhet atje ku ndodhet Vili. Ai përpiqet të ngrihet e të rrijë ndjenjur. Ajo largon nga fytyra pasqyrën, të kuqin dhe përkulet prapa për të parë. Pauzë. Koka e shogët e Vilit, pjesa e pasme, ku rrjedh një curril gjaku, del mbi shpatin e sukës, pastaj nuk lëviz më. Vini i ngre syzet mbi ballë. Pauzë. Duket dora e Vilit që mban një shami, e hap mbi kokë, mandej zhduket. Pauzë. Duket prapë dora që mban një kapele kashte të stolisur me një fjongo dyngjyrëshe, e rregullon mbi kokë, me sqimë, pak mënjane, pastaj zhduket. Pauzë. Vini përkulet pak më shumë, nga ana e tij) Vishi mbathjet, i dashur, do të digjesh në diell. (Pauzë) Jo? (Pauzë) Oh, e shoh, të paska mbetur edhe pak krem. (Pauzë) Lyeju mirë, shpirt. (Pauzë) Tjetrën tani. (Pauzë. Ajo kthehet përpara, vështron drejt. I qesh fytyra nga lumturia) Oh, ç'ditë e bukur do të jetë edhe sot! (Pauzë. E qeshura shubet ngapak. Ul syzet mbi hundë dhe zë prapë të lyejë buzët. Vili shpalos një gazetë, por duart nuk i duken. Nga fletët e zverdhura i del vetëm koka. Vini mbaron së lyeri buzët, e largon pakëz pasqyrën dhe i këqyr me vëmendje) Gojë e vogël me buzë të kuqe. (Vili kthen fletën. Vini lë pasqyrën e të kuqin dhe kthehet kah çanta. Buzkat janë zbehur. Vili kthen fletën. Vini rrëmon në çantë, nxjerr një kapele të vogël grash, me pupël të shprishur, kthehet përpara, rregullon kapelen, shtrin puplën, matet ta vërë në kokë. E ndal zëri i Vilit)

VILI: (Duke lexuar) Shumë i Përnderti Imzot Karolus Shaspò vdiq teksa bënte banjo.

Pauzë.

VINI: *(Duke vështruar përpara, me kapele në dorë, me tonin e zjarhtë të dikujt që sjell ndërmend një kujtim të dashur)* Shaspo! *(Pauzë)* Mbyll sytë – *(heq syzet dhe mbyll sytë, me kapelen në njërën dorë e me syzet në tjetrën)* dhe e shoh veten përsëri ulur në prehrin e tij, në oborrin e rrethuar të Fugaks-e-Barinef, pas shtëpisë, nën akacien e bardhë. *(Pauzë)* Ajo hap sytë, vë syzet, luan me kapelen *(Oh, ato ditë të bukura të kohës së lumtur!)* *(Pauzë. Ajo matet të vërë kapelen, por e ndal zëri i Vilit)*

VILI: *(Duke lexuar)* Kërkohej një djalosh i shkathët.

*Pauzë. Ajo matet të vërë kapelen në kokë, por prapë nuk e vë, heq syzet, vështron përpara, me syzet në njërën dorë; me kapelen në tjetrën.*

VINI: O balloja ime e parë! *(Pauzë)*. O balloja ime e dytë! *(Pauzë. Ajo mbyll sytë)*. O puthja ime e parë! *(Pauzë. Vili kthen fletën e gazetës. Vini hap sytë)*. Një mjek masazhier Dëmulen... a Dymulen...madje ka të ngjarë Demulen. Me mustaqe të dendura e të kuqërreme. *(Gjithë respekt)* Që vinin si në ngjyrë karrote! *(Pauzë)*. Në një kolibe kopshtari, por as që më bie në mend se ku. Në shtëpinë time s'ka pasur kurrfarë kolibeje kopshtari, po me sa duket as në shtëpinë e tij jo. *(Ajo mbyll sytë)*. Më dalin para syve radhët me vazo lulesh. *(Pauzë)*. Vargjet me hudhra. *(Pauzë)*. Mugëtira që bëhej më e dendur midis trarëve të tavanit.

*Pauzë. Ajo hap sytë, vë syzet, matet të vërë kapelen në kokë, por e ndal zëri i Vilit.*

VILI: *(Duke lexuar)*. Një hyrje e këndshme, me dy dhoma e kuzhinë, e qetë, me diell.

*Pauzë. Vini vë vrulltas kapelen në kokë, kërkon pasqyrën. Vili kthen fletën e gazetës. Vini merr pasqyrën, shikon si i rri kapelja, lë në vend pasqyrën, kthehet nga çanta. Gazeta zhduket. Vini rrëmon në çantë, nxjerr së andejmi një lente, kthehet përpara, kërkon furçën e dhëmbëve. Gazeta e palosur duket sërisht, Vili bën fresk me të, por dora nuk duket. Vini merr furçën e dhëmbëve dhe këqyr bishtin me lente.*

VINI: Publikisht e garantuar... *(Vini resht së bëri fllad)*... e vëretetë, e pastër... *(Pauzë. Vili zë prapë të bëjë fllad. Vini vështron më nga afër)*. Publikisht e garantuar... *(Pauzë. Vili zë*

prapë të bëjë fresk)... qime... (Vili resht së bëri fresk)...  
 qime... derri. (Pauzë. Vini lë në vend lentin dhe furçën. Ga-  
 zeta zhduket. Vini heq syzet, i lë në vend, vështron përpara).  
 Qime derri. (Pauzë). Është mrekullia vetë që s'ka ditë –  
 (buzëqesh) – stili i vjetër! – (shubet buzëqeshja) – s'ka ditë që  
 njohuritë tona të mos pasurohen sadopak, të mos pasu-  
 rohen, dua të them, mjafton të bëjmë një përpjekje të vogël.  
 (Shfaqet përsëri dora e Vilit që mban një kartolinë, të cilën e  
 këqyr nga shumë afër). Në qoftë se për shkaqe që nuk njihen,  
 nuk mund të bësh asnjë përpjekje, atëhere s'të mbetet veç të  
 mbyllësh sytë (i mbyll) – dhe të presësh që të vijë dita – (i  
 hap sytë) – e bukura ditë kur trupin ta shkrin i nxehti i madh  
 dhe nata me hënë zgjat me qindra orë. (Pauzë). Kjo më ngu-  
 shëllon, kur më ligështohet zemra dhe zileps kafshët që i  
 therin. (Duke u kthyer kah Vili). Shpresoj se ti nuk humbet  
 asgjë po të – (Ajo sheh kartolinën, rrëzon trupin pas edhe më  
 tepër) Ç'ke në dorë, Vili, a mund ta shoh? (Ajo zgjat dorën  
 dhe Vili i jep kartolinën. Krahu del mbi shpatin e sukës dhe  
 do të rrijë kështu i zgjatur, me dorë të hapur, derisa t'i japin  
 prapë kartolinën) O Perëndi! Me çfarë qenkan duke luajtur  
 ata? (Ajo kërkon syzet, i vë dhe këqyr kartolinën). Mor po  
 qenka tamam ndyrësirë! (Ajo këqyr kartolinën). Ia sillka  
 zorrët në fyt (këqyr kartolinën) – çdo njeriu që ka respekt  
 për veten. (Gishtat e Vilit lëvizin me padurim. Ajo kërkon  
 lentin, e merr në dorë dhe e drejton mbi kartolinë. Pauzë e  
 gjatë). Po ai i treti aty, në fund, ç'po kurdis? (Ajo vështron  
 më nga afër). Oh, jo, s'ka mundësi. (Gishtat e Vilit lëvizin me  
 padurim. E vështron për herë të fundit, gjatë. Ajo lë lentin në  
 vend, e kap kartolinën mu në cep me gishtin e madh e me tre-  
 guesin e dorës së djathtë, shtrin krahu djathtas, e kthen  
 kokën majtas, zë majën e hundës me gishtin e madh e me tre-  
 guesin e dorës së majtë). Pfy! (Ajo e lëshon kartolinën).  
 Hiqma këndeje. (Krahu i Vilit zhduket. Menjëherë shfaqet  
 dora që mban sërish kartolinën. Vini heq syzet, i lë në vend,  
 vështron përpara. Në vijim Vili eglendisët e vazhdon të këna-  
 qet me kartolinën, duke e parë nga të gjitha anët, duke e lar-  
 guar e duke e afruar te sytë). Qime derri. (Me pamje të hu-  
 tuar). Ç'është me tamam një derr? (Pauzë. Me po atë pamje).

Ç'është një dosë, këtë po, sigurisht e di, po ç'është një derr-  
 ngaherë, do të më kujtohet, është një mrekulli që gjithçka të  
 kujtohet prapë. (Pauzë). Gjithçka? (Pauzë). Jo, jo, gjithçka të  
 (Buzëqesh). Jo, jo. (Shubet buzëqeshja). Jo, gjithçka të  
 (Pauzë). Një pjesë. (Pauzë). Një ditë prej ditësh, të duket  
 sikur di nga ke ardhur. (Pauzë). Nga retë. (Pauzë). Kjo më  
 duket mrekullia vetë. (Ajo kthehet kah çanta. Dora e Vilit  
 zhduket tok me kartolinën. Vini don të rrëmojë në çantë, por  
 ndalet). Jo. (Kthehet përpara. Buzëqesh). Jo, jo. (Shubet buzë-  
 qeshja). Ngadalë, Vini. (Ajo vështron përpara. Dora e Vilit  
 duket prapë, heq kapelen e kashtës, zhduket tok me kapelen).  
 Si është puna? (Dora e Vilit duket prapë, heq shaminë,  
 zhduket tok me të. I nervozuar, sikur po flet me dikë që nuk  
 i'a vë veshin). Vini! (Vili përkulet përpara, koka e tij  
 zhduket). Pra, cila është alternativa? (Pauzë). Pra, cila është  
 al... - (Vili fshin hundët gjatë e me zburmë, koka dhe duart  
 nuk i duken. Vini kthehet nga ai. Pauzë. Koka e Vilit shfaqet  
 sërish. Pauzë. Duket prapë dora që mban një shami, e vë mbi  
 kokë, pastaj zhduket. Pauzë. Duket prapë dora që mban kash-  
 toren, e rregullon mbi kokë, me sqimë, pak mënjanë, pastaj  
 zhduket. Pauzë). Ah, si nuk të lashë të flije! (Ajo kthehet për-  
 para duke ndukur fijet e barit, pa e pasur mendjen aty, shoqë-  
 ron fjalët që vijnë më pas, duke ulur e duke ngritur kokën).  
 Ah, sikur të mos më rëndonte vetmia, desha të them, të mos  
 kisha nevojë që dikush të dëgjonte llomotitjen time. (Pauzë).  
 Jo se më rren mendja që ti, Vili, merr vesh gjë, mos e dhëntë  
 Zoti. (Pauzë). Ka ditë kur ti mbase nuk dëgjon gjë prej gjëje.  
 (Pauzë). Por ka ditë kur ti përgjigjesh. (Pauzë). Kështu që  
 mund t'i them vetes në çdo çast, madje dhe kur ti nuk më  
 përgjigjesh e ndoshta nuk dëgjon gjë, Vini, ka çaste kur ty të  
 dëgjojnë, ti nuk flet si qyqe vetëm, domethënë në shkretëtirë,  
 çka kurrë nuk kam mundur ta duroj - për një kohë të gjatë.  
 (Pauzë). Prania jote më jep mundësi të vazhdoj, të vazhdoj të  
 flas, merret vesh. Ndërsa po të vdisje - (buzëqesh) - stili i  
 vjetër! - (shubet buzëqeshja) - apo të ikje e të më braktisje, si  
 do të më vente filli atëherë, çfarë dreqin do të bëja, tërë ditën  
 e ditës, dua të them qysh nga çasti kur bie zilja për t'u zgjuar,

deri në atë çast kur bie për gjumë? (Pauzë). Vetëm të shikoja drejt përpara, gojëkyçur? (Ajo rri gojëkyçur disa çaste. Resht se ndukuri barin) Pa thënë më qoftë edhe një fjalë të vetme deri në grahmën e fundit, pa thënë asgjë që do të thyente heshtjen e këtij vendi. (Pauzë). Vetëm duke lëshuar më të rrallë ndonjë ofshamë para pasqyrës. Apo ndonjë kukurismë... të shkurtër nganjëherë po të ma ketë ënda akoma. (Pauzë. Buzëqeshja e saj duket sikur do të arrijë deri tek e qeshura, kur befas ajo i lë vendin shqetësimit). Ah, flokët e mi! (Pauzë). A i kam krehur? (Pauzë). Ndoshta po. (Pauzë). Normalisht krihem. (Pauzë). Ka kaq pak gjëra që mund të bësh. (Pauzë). Njeriu bën gjithçka. (Pauzë). Gjithçka që mundet. (Pauzë). Kjo është thjesht njerëzore. (Ajo këqyr me kujdes sukën, ngre kokën lart). Lidhet vetëm me natyrën njerëzore. (Zë prapë të këqyrë sukën, ngre kokën lart). Me dobësinë e natyrshme. (Nis prapë të shohë me kujdes sukën). S'po ma zë syri krehërin gjëkundi. (Këqyr me kujdes). S'po gjej as furçën gjëkundi. (Ajo ngre kokën lart. Me pamje të çuditur. Kthehet nga çanta e rrëmon në të). Krehri qenka në vend. (Ajo kthehet përpara. E hutuar. Kthehet nga çanta e rrëmon në të). Furça qenka në vend. (Kthehet përpara. Me pamje të çuditur). Mund t'i kem futur brenda, pasi kam mbaruar punë. (Pauzë. Me po atë pamje). Por zakonisht unë nuk i fut gjërat në çantë pasi kam mbaruar punë me to. Jo, i lë ku mund, lart e poshtë, dhe i fut në çantë të gjitha bashkë, në të ngrysur. (Buzëqesh). Stili i vjetër! (Pauzë). I ëmbli stil i vjetër! (Shubet buzëqeshja). Megjithatë... më duket... më kujtohet... (Befas merr një pamje moskokëçarëse). Oh, punë e madhe, ç' rëndësi ka, kështu them ngaherë, është fare e thjeshtë, do të krihem më vonë, lehtë fare, koha i përket Zotit dhe mua. (Pauzë). Zotit dhe mua... (Pauzë). Shprehje e çuditshme. (Pauzë). Vallë, a mund të thuhet kështu? (Duke u kthyer pakëz kah Vili). Vili, a mund të thotë njeriu se koha e tij i përket Zotit dhe atij? (Pauzë. Duke u kthyer pakëz më shumë). Vili, a do të thoshe ti se koha jote i përket Zotit dhe ty?

*Pauzë e gjatë.*

VILI: Fli!

VINI: (Duke u kthyer përpara, me fytyrë të qeshur). Oh, ai do të

flasë me mua sot, oh, sa e bukur do të jetë edhe kjo ditë!  
*(Pauzë. Shubet gëzimi që kishte në fytyrë)*. Edhe një ditë!  
*(Pauzë)* Mirë, po prit, ku e pata fjalën, ah, po, te flokët, më  
vonë do të merrem me ta, më vonë. *(Pauzë)*. Kam vënë – *(i*  
*çon duart te kapelja)* – po, kam vënë kapelen – *(i ul duart)* –  
nuk mund ta heq tani. *(Pauzë)*. Të mendosh se ka çaste kur  
nuk mund ta heqësh kapelen nga koka, edhe sikur nga kjo  
gjë të varej jeta jote. Çaste kur nuk mund ta vësh në kokë,  
çaste kur nuk mund ta heqësh. *(Pauzë)*. Sa herë i kam thënë  
vetes: Vëre kapelen tani, Vini, veç kjo punë të ka mbetur,  
hiqe kapelen, Vini, bëhu vajzë e mbarë, kjo do të të bëjë  
mirë, por as e vija as e hiqja. *(Pauzë)*. Nuk mundja. *(Ajo ngre*  
*dorën, nxjerr që poshtë kapeles një cullufe të vogël, e afron te*  
*syri, e shikon vëngërthi, e lëshon, ul dorën)*. Të artë, the atë  
ditë, kur më në fund mbetëm vetëm për vetëm, flokë të artë  
– *(ajo çon dorën, sikur do të ngrejë dolli)* – për flokët e tu të  
artë... kurrë mos... *(i këputet zëri)*... kurrë mos... *(Ul*  
*dorën. Ul kokën. Pauzë. Me zë të ulët)*. Atë ditë. *(Pauzë. Me*  
*po atë zë)*. Cilën ditë? *(Pauzë. Ajo ngre kokën. Me zë nor-*  
*mal)*. Po tani? *(Pauzë)*. Fjalët të lënë në baltë, ka çaste kur  
edhe fjalët të lënë në baltë. *(Duke u kthyer pakëz nga Vili)*. A  
s'është kështu, Vili? *(Pauzë. Duke u kthyer pakëz më tepër)*.  
Edhe fjalët të lënë në baltë hera-herës, apo jo? *(Pauzë. Ajo*  
*ktthehet përpara)*. Si t'ia bësh atëhere, derisa fjalët të të vijnë  
prapë? Të krihesh, në mos qofsh krehur, ose po s'ishe e si-  
gurt se i ke flokët në rregull, të merresh me thonjtë, nëse  
është e nevojshme të merresh me ta, në këtë mënyrë fjalët  
mund të të kujtohen prapë. *(Pauzë)*. Këtë desha të thosha.  
*(Pauzë)*. Vetëm kaq desha të thosha. *(Pauzë)* Është mrekullia  
vetë që s'ka ditë – *(buzëqesh)* – stili i vjetër! – *(shubet buzë-*  
*qeshja)* – pothuaj s'ka ditë që e keqja – *(Prapa sukës Vili bie*  
*përdhé. Vini ktthehet për të parë ç'ndodhi)* – të mos sjellë pas  
një të mirë. *(Ajo përkulet prapa në maksimum)* Vili, kthehu  
te strofka jote tani, mjaft ndenje në diell. *(Pauzë)*. Bëj siç të  
thashë, Vili, mos rri aty shtrirë, sa gjatë gjerë nën këtë diell  
përvëlues, kthehu në strofkën tënde. *(Pauzë)*. Hajde pra,  
Vili, tundu. *(Vili që nuk duket, zë të hiqet zvarrë drejt*  
*strofkës së tij që bie nga ana e kopshtit)*. Ashtu de, bukur

fort. (*Ajo e ndjek me sy, tek bën përpara*). Jo me kokë, kaqol, si do t'ia bësh për t'u kthyer pastaj? (*Pauzë*). Ja... bëj një gjysmë rrotullimi... tani... ec praptazi. (*Pauzë*). Oh, i dashur, e di mirë se të zvarritesh praptas nuk është punë e lehtë, por në fund ama shpërblehesh për mundimin. (*Pauzë*). Mos harro kold-kremin! (*Duke u zvarritur, ai kthehet të kërkojë kold-kremin, ajo e ndjek me sy*). Kapakun! (*Duke u zvarritur, ai nisat prapë drejt strofullës, ajo e ndjek me sy. E acaruar*). Jo kokën në fillim, po të them. (*Pauzë*). Më djathtas. (*Pauzë*). Djathtas, po të them. (*Pauzë. E acaruar*) O Zot i madh, po uli ato mollaqe! (*Pauzë*). Jepi tani! (*Pauzë*). Ja ku hyre! (*Tërë këto urdhra thuhet me zë të fortë. Tani flet me zë normal, gjithnjë e kthyer nga ai*). A më dëgjon që andej? (*Pauzë*). Të lutem shumë, Vili, thuaj vetëm po ose jo, a më dëgjon që andej, vetëm po ose hiç fare?

*Pauzë.*

VILI: (*I zymtë*) Po.

VINI: (*Duke u kthyer përpara, me po atë zë*). Po tani?

VILI: (*I acaruar*). Po.

VINI: (*Me zë më të ulët*). Po tani?

VILI: (*Edhe më i acaruar*). Po!

VINI: (*Me zë dhe më të ulët*). Po tani? (*Pauzë. Pakëz më fort*).

Po tani?

VILI: (*Rreptë*) Po!

VINI: (*Me po atë zë*). Le të qajnë, oh, Zot i madh, le të dridhen nga turpi. (*Pauzë*). Dëgjove gjë?

VILI: Po.

VINI: (*Me po atë zë*). Çfarë? (*Pauzë*). Çfarë dëgjove?

VILI: (*Edhe më i acaruar*). Le të dridhen!

*Pauzë.*

VINI: (*Me po atë zë*). Nga se? (*Pauzë*). Le të dridhen nga se?

VILI: (*Me rreptësi*) Le të dridhen!

VINI: (*Me zë normal, me një frymë*) Të bekoftë, perëndia, Vili, që je kaq zemërmirë, e di sa punë e rëndë është për ty, tani çlodhu, qetësohu, nuk ta çaj më kokën me budallallëqe, veç po qe se nuk kam nga t'ia mbaj, desha të them, në mos më shterrofshin mundësitë e mia, çka ka pak të ngjarë, vetëm ta di që ti je aty, dhe më dëgjon, edhe po qe se në të

vërtetë nuk më dëgjon, kaq më mjafton, veç ta ndiej se je aty ku mund të dëgjohet zëri im dhe, kushedi, duke mbajtur vesh, kaq më mjafton mua, të mos them asgjë që nuk duhet ta dëgjosh ti, apo që mund të të bëjë të vuash, të mos ia fus kot, si të thuash, pa e pasur fare idenë, ndërsa diçka më bren përbrenda (*Pauzë. Ajo mbushet me frymë*). Dyshimi. (*Vë gishtin tregues dhe të mesit te zemra, kërkon vendin ku ndodhet ajo, e gjen*). Mu këtu. (*I zhvendos paksa gishtat*) Pak a shumë këtu. (*Heq dorë*). Oh, do të vijë një kohë kur nuk do të shtoj dot qoftë edhe një fjalë, pa qenë e bindur se ti e ke dëgjuar fjalën e fundit që kam thënë; dhe pastaj një tjetër kohë, sigurisht kur do të më duhet të mësohem që të flas fillikat, ndonëse kurrë nuk kam mundur ta duroj një shkretë të tillë. (*Pauzë*). Apo të vështroj drejt përpara, gojëkyçur. (*Ajo vështron përpara dhe kyç gojën*). Gjithë ditën e ditës. (*Me vështrim të ngulët, me gojë të kyçur*). Jo. (*Buzëqesh*). Jo, jo. (*Shubet buzëqeshja*). Natyrisht kam edhe çantën. (*Ajo kthehet kah çanta*). Çantën do të kem ngaherë. (*Kthehet përpara*). Ma do mendja po. (*Pauzë*). Madje edhe kur ti të kesh ikur, Vili. (*Ajo kthehet kah ai*). Se ti do të ikësh, Vili, apo jo? (*Pauzë. Më fort*). Vili! (*Pauzë. Ajo rrëzon trupin pas dhe anohet nga e djathta e saj për ta parë*). Shih, e paske hequr kashtoren, mirë të paska vajtur në mend. (*Pauzë*). E pyes veten, gjithnjë e pyes veten, a mund të më shohësh që andej. (*Pauzë*). Jo? (*Ajo kthehet përpara*). Oh, e di mirë, kur dy veta janë bashkë, nuk ndodh medoemos – (*i këputet zëri*) – kështu – (*me zë normal*) – që kur njeri e sheh tjetrin, edhe tjetri ta shohë njërin, jeta ma ka mësuar edhe kaq gjë. (*Pauzë*). Po, jeta, ma do mendja se nuk ka fjalë tjetër. (*Ajo kthehet pakëz nga ai*). Si thua, Vili, a do të më shikoje dot që aty ku je, po t'i ngrije sytë nga unë? (*Ajo kthehet pakëz më shumë*). Vili, ngriji sytë deri tek unë e thuajmë se mund të më shohësh, bëje këtë për mua, po e përkul kokën prapa sa mundem. (*Ajo përkulet. Pauzë*). Jo? (*Pauzë*). Nuk e bën kaq gjë për mua? (*Pauzë*). Po fundja, s'ka gjë. (*Mezi kthehet përpara*). Gropa sikur qenka ngushtuar, veç në qofsha fryrë unë. (*Pauzë. Hutueshëm, me sy të ulur*). Me siguri nga vapa e madhe. (*Ajo zë të trokëllijë me gishta dhe të përkëdhelë tokën*).



Të gjitha gjërat po bymehen. (Pauzë. Gjithnjë duke e trokëllitur me gishtat e duke e përkëdhelur tokën). Ca më shumë. (Pauzë. Duke vepruar si më parë). E ca më pak. (Pauzë. Duke vepruar si më parë). Oh, e marr me mend se ç'po bluan me vete, e po kjo, s'mjafton që e dëgjoj, tani u dashka edhe ta shikoj, pa le. (Pauzë. Duke vepruar si më parë) S'ke ç'i bën, është fare e kuptueshme. (Pauzë). S'ka si bëhet më e kuptueshme. (Pauzë. Duke vepruar si më parë). Të duket sikur nuk kërkon ndonjë gjë të madhe, madje ka çaste kur të duket fare e pamundur – (me zë të mekur) t'i kërkosha më pak... një njeriu ... Kjo është më e pakta që mund të thuash... ndërsa në të vërtetë... kur e mendon hollë-hollë... sheh në zemrën e tij... e sheh atë tjetrin... e kupton për çfarë ka nevojë... paqen... që ta lënë të qetë... ndoshta qiqra në hell... gjithë këtë kohë... ke kërkuar qiqra në hell. (Pauzë. Befas dora s'lëviz më. Me gjallëri të madhe). Pa shih! Ç'po më shohin sytë? (Duke përkulur kokën drejt tokës, me mosbesim). Ngjaka si gjallesë! (Ajo kërkon syzet, i vë, shikon më nga afër. Pauzë). Qenka milingonë! (Ajo zmbrapset. Me zë të hollë). Vili, një milingonë, qenka e gjallë! (Ajo kërkon lentin, e merr në dorë, e drejton mbi milingonën). Më iku! (Pauzë). Ah, ja ku qenka! (Ajo ndjek milingonën që ecën mbi bar). Seç ka një si toptë të bardhë në krahë. (Ajo e ndjek milingonën që ecën. Dora s'lëviz më). U fsheh në tokë. (Vazhdon një copë herë të vështrorë vendin me lente, heq syzet dhe shikon përpara, me syze në dorë. Me zë të ulët) Një si toptë të bardhë.

Pauzë. Ajo matet të lërë në vend syzet.

VILI: Vezë!

VINI: (E ndal dorën). Çfarë?

VILI: Vezë. (Pauzë. Vini matet prapë të lërë në vend syzet).

Mizëri vezësh.

VINI: (E ndal dorën). Çfarë?

Pauzë.

VILI: Mizëri vezësh.

Pauzë. Vini lë në vend syzet, vështron përpara.

VINI: (Mërmërit) O Zot! (Pauzë. Vili qesh lehtë. Pauzë. Ajo qesh tok me të. Qeshin lehtë, së toku. Vili e ndërpret të qeshurit. Qesh vetëm Vini. Pauzë. Vili qesh tok me të. Ata qeshin së

*toku. Ajo e ndërpret të qeshurit. Qesh vetëm Vili. Pauzë. Ai e ndërpret të qeshurit. Pauzë. Me zë normal). Ç'gëzim i madh se as unë, as ti nuk do të qeshnim kurrë më. (Pauzë) Pa dyshim shumëkush do të na merrte për të pasjellshëm, por nuk besoj se është kështu. S'ke si ia bën më mirë qejfin të Plotfusidomos kur ato janë pa kripë. (Pauzë). Vili, them se në këtë pikë do të jesh në një mendje me mua. (Pauzë). Apo për tjetër gjë qesha unë e për tjetër ti? (Pauzë). Po fundja, ç'rëndësi ka, kështu them ngaherë, përderisa... ti e di... si thotë ai vargu i mrekullueshëm... tra-la-la zemra pëlçet e buza qesh. (Pauzë). Po tani? (Pauzë). Vili, a kam qenë joshëse unë? (Pauzë). A kam qenë ndonjëherë joshëse? (Pauzë). Vili, mos më keqkupto, nuk po të pyes: a je joshur ti, se këtë e kemi të qartë të dy, unë po të pyes nëse ta ha mendja se mund të joshja dikë – në një çast të caktuar. (Pauzë). Jo? (Pauzë). Nuk mund të përgjigjesh? (Pauzë). Oh, e di dhe vetë, është pyetje e vështirë. Mjaft të lodha tani, shtrihu, çlodhu, nuk do të çaj më kokën, veç po qeshë e detyruar. Vetëm ta di që je aty ku mund të vijë zëri im dhe kushedi, ndoshta gjysmë i zgjuar, kjo është për mua... si një qoshkë parajse. (Pauzë). Tani dita është në të thyer (*Buzëqesh*). Stili i vjetër! (*Shuhet buzëqeshja*). Sidoqoftë është ende pak si herët për t'ia marrë këngës. Më duket se është gabim i madh të këndosh tepër herët. (*Ajo kthehet nga çanta*). Sigurisht kam edhe çantën. (*Ajo vështron çantën*). Çantën. (*Ajo kthehet përpara*). Vallë, a mund t'i numëroj ato që ka brenda? (Pauzë). Jo. (Pauzë). A do t'i përgjigjesha dot, po qe se dikush do të kalonte këndeje pari e do të më pyeste: Vini, me çfarë është mbushur kjo çantë e zezë, a do t'i përgjigjesha dot një më një? (Pauzë). Jo. (Pauzë). Sidomos në thellësi, kushedi çfarë thesaresh fsheh. Çfarë ngushëllimesh mund të gjesh. (*Ajo kthehet nga çanta*). Po, kam çantën. (*Kthehet përpara*). Por një zë më thotë: Vini, mos e tepro me atë çantën tënde, natyrisht përdore me dobi, lëre të të ndihmojë për të shkuar më tutje, kur e ke pisk, këtë po, por mendo për të ardhmen, Vini, më thotë zëri, hap sytë, mendo për çastin kur*

fjalët do të të lënë në baltë (ajo mbyll sytë, pauzë, i hap prapë) – dhe mos e tepro me atë çantën tënde. (Kthehet nga çanta). Ndoshta mund të zhytesh pak e të peshkosh diçka në të, por ama shpejt e shpejt. (Ajo kthehet përpara, mbyll sytë, zgjat krabun e majtë, zhyt dorën në çantë e nxjerr së andejmi një revolver. Me neveri). Prapë ti! (Ajo hap sytë, kthehet përpara me revolverin në dorë dhe e kundron). Brauni plak! (Ajo e peshon në pëllëmbën e dorës). S'qenke aq i rëndë sa të rrish në fund me... fishekët e fundit? Kurrsesi. Gjithnjë në krye. (Pauzë). Brauni... (Duke u kthyer pakëz nga Vili) Vili, a të kujtohet Brauni? (Pauzë). A të kujtohet ajo kohë kur ti më bezdisje orë e çast që të ta hiqja nga dora. Hiqma këtë, Vini, hiqma këtë, para se t'u kem dhënë fund vuajtjeve të mia. (Ajo kthehet përpara. Me përbuzje). Vuajtjet e tua! (Revolverit). Oh, sigurisht ngushëllohem kur e di se ti je aty, por mjaft të pashë. Do të të lë jashtë, ja ç' do të bëj. (Ajo e lë revolverin mbi sukë, në të djathtë). Aty, do të rrish ashtu, që sot e tutje. (Buzëqesh). Stili i vjetër! (Shuhet buzëqeshja. Pauzë). Po tani? (Pauzë e gjatë). Vili, më ngjan se graviteti nuk nuk është më siç ka qenë, a nuk të duket edhe ty kështu? (Pauzë). Po, sa vjen e po bindem se po të mos isha groposur – (bën një gjest) – kësodore, pa një pa dy do të çohesha peshë e do të rrija pezull në qiellin e kaltër. (Pauzë). Dhe ndoshta një ditë toka do të mposhtet, kaq shumë më tërheq lart diçka, po, do të çahet përreth meje e do të më lërë të dal. (Pauzë). Vili, nuk të duket ndonjëherë sikur diçka të thëthin? (Pauzë). Vili, a nuk e ndien të nevojshme që herë-herë të kapesh fort pas diçkaje? (Duke u kthyer pakëz nga ai). Vili.

Pauzë.

VILI: Të thëthin?

VINI: Po, pëllumbi im, përpjetë, drejt qiellit, si një fije merimange. (Pauzë). Apo jo? (Pauzë). Asnjëherë? (Pauzë). Epo mirë, ligjet e natyrës, ligjet e natyrës sigurisht janë njëlloj si gjithë gjërat e tjera të kësaj bote, gjithçka varet nga tipi i njeriut. Gjithë-gjithë mund të them se, përsa më përket mua, ligjet e natyrës nuk janë më ato që ishin një herë e një kohë, kur isha çupë e bukur e... mendjeflutur (i këputet zëri, ul kokën)... e bukur... mbase ... e hijshme... në njëfarë mënyre... për sytë.

(*Pauzë. Ajo ngre kokën*). Më fal, Vili, njeriu paska nga këto gulçe melankolie. (*Me zë normal*). Po fundja ndiej gëzim të madh, ngaqë e di se je aty, të paktën je aty, se nuk tundesh nga vendi dhe ndoshta je zgjuar e ndoshta veshëngrehur, nganjëherë, kjo do të ish... për mua... edhe një tjetër ditë e bukur. (*Pauzë*) Kaq. Na ka parë perëndia që këtu nuk rritet asgjë, merre me mend sikur tërë kjo ndyrësi të zinte të rritej. (*Pauzë*). Merre me mend. (*Pauzë*). Ah, po, falemnderës Zotit. (*Pauzë e gjatë*). Nuk mundem të flas më. (*Pauzë*). Tani për tani. (*Ajo kthehet nga çanta. Pauzë. Kthehet përpara. Buzëqesh*). Jo, jo. (*Shubet buzëqeshja. Ajo vështron ombrellën*). Sigurisht do të mundja – (*ajo merr në dorë ombrellën*) – po, pa dyshim, ta ngrija lart këtë send, është tamam koha. (*Ajo zë ta hapë. Vështirësitë që kapërcen derisa hap ombrellën ia ndërpresin ligjërimin fjalë pas fjale*) – E përmban veten – që të mos e ngresh – nga frika se mos e ngre tepër herët – dhe dita ikën – pa kthim – pa e ngritur – fare. Tani ombrella është e hapur. (*Pasi e kthen nga ana e djathtë, ajo e vërtit pa mendje herë në një drejtim, herë në tjetrin*). Ah, po, ke kaq pak për të thënë, kaq pak për të bërë, dhe ka ditë kur të kaplon një frikë kaq e madhe, ngaqë orët s'kanë të sosur, derisa bie zilja për gjumë, dhe s'ke më asgjë për të thënë, s'ke më asgjë për të bërë, dhe ditët ikin, disa ditë ikin, pa kthim, bie zilja, për gjumë, dhe asgjë, pothuaj asgjë nuk ke thënë, asgjë ose pothuaj asgjë nuk ke bërë. (*Ajo ngre lart ombrellën*). Ky është rreziku. (*Kthehet përpara*). Nga i cili duhet të ruhesh. (*Ajo vështron përpara, duke mbajtur me dorën e djathtë ombrellën mbi kokë. Pauzë*). Më shkonin djersët çurg. (*Pauzë*). Njëherë e një kohë. (*Pauzë*). Tani nuk djersij më. (*Pauzë*). Pothuaj nuk djersij më. (*Pauzë*). Vapa është shtuar. (*Pauzë*). Djersitja është pakësuar. (*Pauzë*). Ja, kësaj i them mrekuilli unë. (*Pauzë*). Mënyra se si u përshtatet njeriu (*Pauzë*). Kush-teve që ndryshojnë. (*Ajo e kalon ombrellën në dorën e majtë. Pauzë*). Ta mbash lart, të lodh krahun. (*Pauzë*). Kur ecën, jo. (*Pauzë*). Vetëm kur rri në vend. (*Pauzë*). Ja një vëzhgim interesant, s'ke ç'i thua. (*Pauzë*). Vili, shpresoj se nuk të ka shpëtuar kjo gjë, do të më vinte keq, po të të kishte shpëtuar. (*E kap ombrellën me të dyja duart. Pauzë*). Më rraskapiti, duke e

mbajtur lart, dhe nuk mund ta lë përtokë. (Pauzë). Arsyeja më thotë: Ule përtokë, Vini, ajo s'të hyn fare në punë, dhe merru me diçka tjetër. (Pauzë). Nuk mundem. (Pauzë). Jo, duhet të ngjasë diçka në botë, të ndodhë ndonjë ndryshim, unë nuk mundem. (Pauzë). Vili. (Me një fije zëri). Ndihi-momë. (Pauzë). Vili, urdhëromë ta lë në vend dhe do të bin-dem menjëherë, siç kam bërë gjithmonë. (Pauzë). Ki më-shirë. (Pauzë). Nuk po më urdhëron? (Pauzë). Për fat, ende e kam gjuhën shpatë. (Pauzë). Më duket mrekullia vetë, që, kur njëres prej dy llambave të mia i pakësohet drita, tjetra ndriçon më shumë. (Pauzë). Ah, po, faleminderës Zotit. (Ombrella merr zjarr. Vini nuhat në ajër, ngre sytë, flak ombrellën prapa sukës, përkulet prapa dhe e sheh tek digjet. Kthehet përpara). Moj tokë, moj zjarrfikëse e lashtë! (Pauzë). Pa dyshim, këtë gjë e kam parë edhe herë tjetër, ndonëse nuk më bie në mend se ku. (Pauzë). Po ti, Vili? (Ajo kthehet pakëz nga ai). Vili, a të kujtohet që e ke parë? (Përkulet prapa për të vështruar). Vili, a e di çfarë ndodhi tani? (Pauzë). Prapë re në kllapi? (Pauzë). Nuk po të pyes a të bën përshtypje kjo gjë që po ngjet, të pyes vetëm a re prapë në kllapi? (Pauzë). Sytë i ke të mbyllur, por dihet se kjo s'do të thotë gjë. (Pauzë). Ngri një gisht, kolopuçi im, hë, nëse s'të ka rënë me të vërtetë të fikët. (Pauzë). Vili, bëje këtë për mua, vetëm gishtin e vogël, në mos i paç humbur ndjenjat. (Pauzë. Gjithë hare). Oh, e ngrite krejt dorën, sot je engjëll i vërtetë, tani mund të vazhdoj, pa më vrarë ndërgjegja. (Kthehet përpara). Po, se mos shohim ndonjëherë gjëra që s'i kemi parë tashmë, megjithëse... pyes veten (Pauzë). Në këtë prushnajë që dita-ditës bëhet më e pamëshirshme, a nuk është e natyrshme që gjërat të marrin flakë, ndonëse kjo s'u kish ndodhur ndonjëherë, dua të them, të ndizen pa ua vënë kush zjarrin? (Pauzë). A nuk do të përfundoj edhe unë vetë e shkrire, apo e përvëluar, oh, nuk dua të them medoemos nga flakët, jo, thjesht të më katandiset çikë e nga një çikë në një tog hiri të zi tërë ky – (bën një gjest të gjerë me krabë) – mish që shihni. (Pauzë). Nga ana tjetër, a kam njohur ndonjëherë ditë me mot të butë? (Pauzë) Jo. (Pauzë). Po flas për ditë me mot të butë dhe për ditë me mot shumë të

nxehtë, por këto janë fjalë boshe. (Pauzë) Flas për atë kohë kur ende nuk isha bllokuar – kësodore – dhe nuk më kishin lënë këmbët dhe mund të ecja, dhe mund të kërkoja një kënd me hije, ashtu si ti, kur s'e duroja dot diellin, apo një kënd me diell, kur më mërzitej hija, ashtu si ti, dhe tërë këto janë fjalë boshe. (Pauzë). Sot nuk bën më nxehtë se dje, nesër nuk do të bëjë më nxehtë se sot, nuk ka mundësi, dhe kështu me radhë pa fund, deri në të shkuarën më të largët e deri në ardhmërinë më të largët. (Pauzë). Po qe se një ditë dheu do të m'i kishte mbuluar gjinjtë, ahëre unë nuk do t'i kisha parë kurrë gjinjtë e mi, askush s'do t'i kishte parë gjinjtë e mi. (Pauzë) Vili, shpresoj se këto që thashë, nuk të shpëtuan pa i dëgjuar, do të më pikonte në zemër, po të mos i kishe dëgjuar, nuk më ndodhë për ditë të ligjërojë kaq bukur. (Pauzë). Po, duket sikur ka ngjarë diçka, diçka duket se ka ngjarë, dhe s'ka ngjarë gjë prej gjëje, ti ke të drejtë, Vili. (Pauzë). Nesër ombrella do të jetë prapë aty, përbri meje, te kjo sukë, që të më ndihmojë për të shtyrë ditën. (Ajo merr në dorë pasqyrën). Po e marr këtë pasqyrë të vogël, po e thyej pas një guri (e thyen) – po e flak tutje (e hedh pas vetes) – nesër ajo do të jetë prapë aty, në çantë, pa asnjë gërvishitje, që të më ndihmojë për të shtyrë ditën. (Pauzë) Jo, s'ke ç'bën. (Pauzë). Është mrekullia vetë mënyra se si gjërat... (i këputet zëri, ul kokën)... gjërat... mrekullia vetë... (Pauzë e gjatë, me kokë të ulur. Më në fund ajo kthehet nga çanta, gjithnjë me kokë të ulur, nxjerr së andejmi ca rrangullina që s'merret vesh se ç'janë, i rras prapë në çantë, rrëmon më thellë, më në fund nxjerr një kuti muzike, e kurdis mekanizmin, e vë në lëvizje, dëgjon një çast muzikë, e përkulur mbi kutinë që e mban me të dyja duart, kthehet përpara, drejton shtatin ngadalë dhe dëgjon muzikën – Valsin «Çast i mrekullueshëm» nga «Veju-sha gazmore» – duke e shtrënguar kutinë pas krabrorit me të dyja duart. Pak nga pak i qesh fytyra nga lumturia. Ajo tundet sipas ritmit. Muzika ndërpritet. Pauzë. Vili këndon me zë të ngjirur melodinë e këngës pa fjalët. Vinit i qesh fytyra edhe më shumë. Vili resht së kënduari. Ajo e lë në vend kutinë). Oh, sa e bukur qe edhe dita e sotme! (Ajo përplas duart). Edhe një herë, Vili, edhe një herë! (Ajo përplas duart). Bis.

Vili, të lutem shumë! *(Pauzë. Vini ngryset në fytyrë)*. Jo? Nuk do ta bësh këtë për mua? *(Pauzë)*. S'ke ç'i bën, është fare normale, fare normale. Nuk mund të këndosh thjesht për të kënaqur tjetrin, sado ta duash, jo, kënga duhet të burojë nga zemra, e kam thënë unë ngaherë, të rrjedhë nga burimi, siç i del kënga mëllenjës. *(Pauzë)*. Sa herë kam thënë, në orë të liga: Këndo tani, Vini, merrja këngës sate, vetëm këtë mund të bësh, dhe nuk e bëja. *(Pauzë)*. Nuk mund ta bëja. *(Pauzë)*. Jo, siç këndon mëllenja, apo lauresha, pa menduar të kënaqë as veten, as të tjerët. *(Pauzë)*. Po tani? *(Disa çaste. Me zë të ulët)*. Kam një ndjesi të çuditshme. *(Pauzë e gjatë. Me po atë zë)*. Një ndjesi të çuditshme, sikur dikush po më vështron. Dukem qartë, pastaj turbullt, pastaj zbehtë, pastaj prapë turbullt, pastaj prapë qartë, e kështu me radhë, vete e vij, zhdukem e rishfaqem në syrin e dikujt. *(Pauzë. Me po atë zë)*. E çuditshme? *(Pauzë. Me po atë zë)*. Jo, këtu gjithçka është e çuditshme. *(Pauzë. Me zë normal)*. Një zë më thotë: Vini, pa hesht pak tani, mjaft, mos i harxho të gjitha fjalët që ke për sot, hesht e bëj diçka, po të them, sa për variacion. *(Ajo i ngre duart dhe i mban të hapura para syve. U drejtohet duarve të veta)*. Bëni diçka! *(Kthehet nga çanta, rrëmon brenda, nxjerr që andej një limë thonjsh, kthehet përpara dhe zë të limojë thonjtë. Limon një çast, heshturazi. Pastaj, ato që thotë ndërpriten nga zburma e limës)*. Nga thellësitë e kujtesës – më vjen në mend njëfarë zotëri Pajper – një zotëri dhe ndoshta – një zonjë Pajper – por jo – ata mbahen dorë për dorë – duhet të jetë e fejuara e tij – apo thjesht një mike – shumë e dashur. *(I vështron thonjtë më nga afër)*. Sot qenkan shumë të thyeshëm. *(Zë prapë të limojë)* Pajper – Pajper – Vili, a të kujton gjë ty – ky emër – dua të them, a të sjell ndërmend – ndonjë realitet të çfarëdoshëm – ty, Vili, – mos m'u përgjigj – po qe se kjo gjë të bezdis – tashmë ti je – fare i kapitur – Pajper – Pajper. *(I këqyr thonjtë e limuar)*. Si më mirë duken. *(Ajo ngre kokën, vështron përpara)*. Mbahu, Vini, ja këtë them ngaherë, le të bëhet ç'të bëhet, mbahu. *(Pauzë. Ajo zë të limojë prapë)*. Po – Pajper – *(resht së limuari, ngre kokën, vështron përpara)* – apo Kuker, mos ndoshta është Kuker. *(Kthehet pakëz nga Vili)*. Kuker, Vili, a ta ngacmon kujtesën

ky Kukeri? (Pauzë. Duke u kthyer pakëz më tepër). Kuker, Vili, a të kujton ndonjë gjë mbiemri Kuker? (Pauzë). Ajo përkulet prapa për ta shikuar. (Pauzë). Oh, të jetë si të dojë! (Pauzë). Ç'e bëre shaminë? (Pauzë). Oh, Vili, se mos e kapërdish! Nxirre nga goja, për hir të Zotit, nxirre! (Pauzë. Ajo kthehet përpara). Po fundja, më beso, është fare e natyrshme. (I këputet zëri). Njerëzore. (Pauzë, me po atë zë). Ç'të bësh? (Pauzë. Me po atë zë) sa zbardh drita e derisa ngryset. (Pauzë. Me po atë zë). Ditë për ditë. (Pauzë. Ajo ngre kokën. Buzëqesh.). Stili i vjetër! (Shuhet buzëqeshja. Nis të merret prapë me thonjtë). Jo, këtë e paskam bërë. (Kalon te thoi tjetër). Duhej të kisha vënë syzet. (Pauzë). T'i kisha vënë me kohë. (Mbaron dorën e majtë, e shikon me kujdes). Tani duken pak më mirë. (Ajo fillon dorën e djathtë. Ato që thotë më tej, ndërpriten si më parë nga të limuarit me limë). Po fundja – pak – dorë për dore – secili me nga një çantë në dorën tjetër – nga ato çantat ku mund të futësh çdo gjë – ngjyrëgështenjë – që rrinë në këmbë e m'i ngulin sytë – gojëhapur – pastaj ai – Pajperi – Kukeri – pak rëndësi ka – Ç'djallin po bën ajo? – thotë ai – ç'kuptim ka kjo? – thotë ai – e kallur deri në kraharor – në këtë dhë të ndyrë – një tip harbuti – ç'kuptim ka kjo gjë? – thotë ai – Çdo të thotë kjo, fundja – e më the – e të thashë – gjithë marrëzitë – e zakonshme – a më kupton? – thotë ai – medet, thotë ajo – si medet? – thotë ai – ç'domethënë medet? (Ajo resht së limuari, ngre kokën, vështron përpara). Po ti? – thotë ajo. Po ti, ç'kuptim ke, çfarë kuptimi të kanë dhënë? Që ende mbahesh në këmbë mbi ata dy shputat e tua si lopata, me qypin tënd plot të pëgëra e me brekë që mund t'i ndërrosh, duke më zvarritur andej-këndej në këtë shkretëtirë të ndyrë – mua një palogrua, një bashkëshorte të denjë – (befas, me rreptësi) – lëshomë, i thotë ajo, dreqi e mori dhe plaç, plaç! (Ajo zë prapë të limojë). Përse nuk e nxjerr nga dheu? – thotë ai – e ka fjalën për ty, shpirti im – ç'i hyn në punë ajo grua në atë farë feje? – e ç'ti bëjë ai, ashtu si është katandisur? – e kështu me radhë – gjithë marrëzitë – e zakonshme – duhet të nxirret nga dheu – thotë ai, – s'ka kuptim të rrijë



kështu – me çfarë ta nxjerrësh nga dheu? thotë ajo – vetëm me duar, thotë ai, do ta nxjerr vetëm me duar – duhej të genë burrë e grua. (*Ajo limon heshturazi*). Mandej i kthej sytë dhe i shoh tek po largohen – të kapur dorë për dorë – me çantat – ikin tutje – mezi shihen – pastaj nuk duken më – qeniet e fundme njerëzore – që gabimisht i nxori rruga këtu. (*Ajo mbaron dorën e djathtë, e shikon me kujdes, e lë limën në vend, vështron përpara*). E çuditshme, të të faniten fantazma të tilla, në një çast të tillë. (*Pauzë*). E çuditshme? (*Pauzë*). Jo, këtu gjithçka është e çuditshme. (*Pauzë*). Sidoqoftë u jam mirënjohëse. (*I këputet zëri*). Shumë mirënjohëse. (*Ajo ul kokën. Pauzë. Ngre kokën. E qetë*). Ul e ngri kokën, ul e ngri kokën, gjithnjë ky avaz. (*Pauzë*). Po tani? (*Pauzë e gjatë. Ajo fillon të rregullojë plaçkat, duke i futur në çantë. Furçën e dhëmbëve e fut në fund. Këto veprime shoqërojnë fjalët që thotë më tej*). Sigurisht – ende është herët – të bëhesh gati – për natën – (*ajo e ndërpret rregullimin e plaçkave, ngre kokën, buzëqesh*) – stili i vjetër! (*shuhet buzëqeshja, zë prapë të rregullojë plaçkat*) – megjithatë po bëhem gati – për natën – e ndiej se po afrohet – se do të bjerë zilja – për gjumë – i them vetes, Vini – s’të mbetet edhe shumë kohë, Vini – do të bjerë zilja – për gjumë. (*E ndërpret rregullimin e plaçkave, ngre kokën, vështron përpara*). Ndodh që gabo. (*Buzëqesh*). Por jo shpesh. (*Shuhet buzëqeshja*). Ndodh që gjithçka ka mbaruar për atë ditë, gjithçka është bërë, është thënë, gjithçka është gati për natën, dhe dita ende s’ka mbaruar, do kohë që të mbarojë, nata nuk është gati, do ende shumë që të bjerë. (*Buzëqesh*). Por jo shpesh. (*Shuhet buzëqeshja*). Po, kur e ndiej se vjen çasti, se do të bjerë zilja për gjumë, dhe për pasojë bëhem gati për natën – (*Bën një gjest*) – kështu ndodh që gabo – (*buzëqesh*) – por jo shpesh. (*Shuhet buzëqeshja. Ajo zë prapë të rregullojë plaçkat*). Njëherë e një kohë mendoja – po them se, njëherë e një kohë mendoja – se gjithë këto sende – të futura në çantë – po qe se i fusja tepër herët mund t’i nxirrja prapë – nëse duhej – po të qe e nevojshme – dhe kështu me radhë – pambarimisht – t’i futësh prapë – t’i nxjerrësh prapë – derisa të bjerë zilja – për gjumë. (*Ajo e ndërpret rregullimin, ngre kokën, buzëqesh*). Por jo.

*(Buzëqesh më shumë).* Jo, jo. *(Shubet buzëqeshja. Ajo zë prapë të rregullojë plaçkat).* Kjo mund të duket e çuditshme – po, sigurisht – Kjo... si të them? – Kjo që sapo thashë – po, sigurisht – *(merr në dorë revolverin)* – e çuditshme – *(kthehet për ta futur revolverin në çantë)* – po qe se – *(matet të futë revolverin në çantë, por ndalet dhe vështron përpara)* – po qe se *(e lë revolverin në të djathtë, e ndërpret rregullimin e plaçkave, ngre kokën)* – se gjithçka nuk të duket e çuditshme. *(Pauzë).* Shumë e çuditshme. *(Pauzë).* Asnjëherë nuk ndryshon gjë. *(Pauzë).* Dhe sa vjen e më e çuditshme bëhet. *(Pauzë. Ajo përkulet prapë, merr sendin e fundit, domethënë furçën e dhëmbëve, dhe kthehet për ta futur në çantë, kur ia tërbeq vëmendjen zhurma që vjen nga ana e Vilit. Ajo përkulet për ta parë. Pauzë).* Lepurushi im, mos u lodhe në atë strofkën tënde? *(Pauzë).* E di se ç'do të thotë. *(Pauzë).* Mos e harro kashtoren! *(Pauzë).* Ah, i shtrenjti im, i gjori ti, nuk zvarritesh dot më si njëherë e një kohë! *(Pauzë).* Jo, nuk je më ai rrëshqanori që më rrëmbeve zemrën. *(Pauzë).* Këmbadoras, i dashur, provoje këmbadoras. *(Pauzë).* Ulu në gjunjë! Në gjunjë! *(Pauzë).* Ç'mallkim qenka të lëvizurit! *(Ajo ndjek me sy Vilin që bën përpara nga ana e prapme e sukës, domethënë drejt vendit që zinte në fillim të aktit).* Vili, edhe një gjysmë metri dhe mbërrite. *(Gjatë pauzës ajo vë re se si përshton centimetrat e fundit).* Ah! *(Ajo kthehet përpara mundimshëm, fërkon qafën).* M'u shtrembërua qafa, duke të seditur ty. *(Ajo fërkon qafën).* Por ia vlen, ama, ia vlen të heqësh edhe më shumë se kaq. *(Ajo kthehet pakëz nga ai).* A e di se ç'shoh në ëndërr nganjëherë? *(Pauzë).* A e di se ç'më fanitet nganjëherë, Vili? *(Pauzë).* Që ti do të vish të rrish nga kjo ana këndeje, ku mund të të shoh. *(Pauzë. Ajo kthehet përpara).* Do të bëhesha një grua tjetër. *(Pauzë).* S'do të njihesha fare. *(Ajo kthehet pakëz nga ai).* Sikur të vije vetëm nganjëherë, nga kjo ana këtej, vetëm nganjëherë, që t'i ngopja sytë me ty. *(Pauzë. Ajo kthehet përpara).* Por ti nuk mundesh, e di. *(Ajo ul kokën).* E di. *(Pauzë. Ajo ngre kokën).* Po fundja *(e vështron furçën)* – Nuk ke edhe shumë kohë, Vini – *(vështron furçën)* – do të bjerë zilja. *(Koka e shogët e Vilit, pjesa e pasme, del mbi shpatin e sukës. Vini vështron*

*furçën më nga afër*). Publikisht e garantuar... (Ajo ngre kokën)... si qe pastaj? (Duket dora e Vilit, që mban shaminë, të cilën e hap mbi kokë, pastaj zhduket). Vërtet e pastër... publikisht e garantuar... (Duket përsëri dora e Vilit që rregullon me sqimë kashtoren mbi kokë, pak mënjane, pastaj zhduket)... ah, qime-derri! (Pauzë). Çfarë është derri me tamam? (Pauzë. Duke u kthyer pakëz nga Vili) Vili, çfarë është me tamam derri? (Pauzë. Duke u kthyer pak më shumë, me përgjërime). Të lutem shumë, Vili, çfarë është derri?

*Pauzë.*

VILI: Thi mashkull, i tredhur. (Vinit i qesh fytyra nga lumturia). Që rritet vetëm për mish.

Vini kthehet përpara. I qesh fytyra edhe më shumë. Vili hap gazetën, por duart nuk i duken. Vetëm koka i del nga fletët e zverdhura. Vini vështron përpara, me fytyrën që i qesh nga lumturia.

VINI: Oh, sa e bukur qe edhe dita e sotme! Edhe një tjetër ditë e bukur! (Pauzë). Pavarësisht nga gjithçka që ndodhi. (Merr fund pamja e saj e lumtur). Kaq. (Pauzë. Vili kthen fletën e gazetës. Pauzë. Ai kthen fletën. Pauzë).

VILI: Rendiment i lartë.

Pauzë. Vini heq kapelen, kthehet për ta futur në çantë, e ndërpret veprimin, kthehet përpara. Buzëqesh.

VINI: Jo. (Buzëqesh më shumë). Jo, jo. (Shuhet buzëqeshja. Ajo vë kapelen, vështron përpara. Vili kthen fletën e gazetës). Po tani? (Pauzë e gjatë). Këndo. (Pauzë). Vini, merrja këngësate. (Pauzë). Jo? (Pauzë). Atëhere lutu. (Pauzë). Vini, thuaj lutjen tënde.

*Pauzë. Vili kthen fletën e gazetës. Pauzë.*

VILI: Përfitime shoqërore...

Pauzë. Vini vështron përpara. Vili kthen fletën e gazetës. Pauzë. Gazeta zhduket.

VINI: Thuaje lutjen tënde të vjetër, Vini!

*Pauzë e gjatë.*

## AKTI I DYTË

*Skena është si në aktin e parë.*

*Vili nuk shihet.*

*Vini është futur në dhe deri në grykë, me kapele në kokë, me sy të mbyllur. Koka, që nuk e rrotullon dot, as nuk e ngre as nuk e ul dot, vështron nga salla dhe qëndron si e ngrirë deri në fund të aktit. Lëvizin vetëm sytë, sipas udhëzimeve.*

*Çanta dhe ombrella gjenden në të njëjtin vend si në fillim të aktit të parë. Bie në sy revolveri, në të djathtë të kokës.*

*Pauzë e gjatë.*

*Zile e mprehtë. Ajo i hap sytë menjëherë. Zilja ndalet. Ajo vështron përpara. Pauzë e gjatë.*

*VINI: Të përshëndes, o dritë e bekuar! (Pauzë. Ajo mbyll sytë. Zile e mprehtë. Ajo i hap sytë menjëherë. Zilja pushon. Ajo vështron përpara. Buzëqesh. Pauzë. Shuhet buzëqeshja. Pauzë). Dikush po më shikon ende. (Pauzë). Ende brengoset për mua. (Pauzë) Kjo është mrekullia vetë. (Pauzë). Sy të tjerë të sytë e mi. (Pauzë). Si thotë ai vargu i paharrueshëm? (Pauzë. I kthen sytë djathtas). Vili. (Pauzë. Më fort). Vili. (Pauzë. Vështron përpara). A mund të flasim ende për kohën? (Pauzë). Çudi, Vili, u bë një copë herë që nuk të shoh më. (Pauzë). Nuk ta dëgjoj më zërin. (Pauzë). A është e mundur? (Pauzë). Ja që qenka. (Buzëqesh). Stili i vjetër! (Shuhet buzëqeshja). Ka kaq pak gjëra, për të cilat mund të flasësh. (Pauzë). Flasin për gjithçka. (Pauzë). Për gjithçka që mund të flitet. (Pauzë). Njëherë e një kohë mendoja... (Pauzë)... po them, njëherë e një kohë mendoja se do të mësohesha të flisja qyqe vetëm. (Pauzë). Desha të them, t'i flisja vetes time, shkretëtirës. (Buzëqesh). Por jo. (Buzëqesh më shumë). Jo, jo. (Shuhet buzëqeshja). Pra, ti je aty. (Pauzë) Oh, ndoshta ke vdekur, po, ashtu si njerëzit e tjerë, edhe ti ndoshta ke*

vdekur, ose ke ikur e më ke braktisur, ashtu si të tjerët, por s'ka gjë, ti je aty. (Pauzë. *I kthen sytë majtas*). Edhe çanta është aty, po ajo çantë që ka qenë, e shoh mirë. (*I kthen sytë djathtas. Më fort*). Vili, çanta është aty, pa asnjë rudhë, ajo çantë që më dhe atë ditë... për të bërë pazarin. (Pauzë. *Ajo vështron përpara*). Atë ditë. (Pauzë). Cilën ditë? (Pauzë). Njëherë e një kohë lutesha. (Pauzë). Po them, një herë e një kohë. (Pauzë). Po, nuk e fsheh. (*Buzëqesh*). Tani nuk lutem më. (*buzëqesh më shumë*) jo, jo (*Shubet buzëqeshja. Pauzë*). Njëherë e një kohë... tani... Sa e vështirë është kur e mendon. (Pauzë). Të kem qenë ngaherë kjo që jam dhe të jem kaq e ndryshme nga ajo që isha. (Pauzë). Jam njëra, po them, jam njëra, pastaj jam tjetra. (Pauzë). Herë njëra, herë tjetra. (Pauzë) S'mund të thuash kushedi çfarë. (Pauzë). Themi gjithçka. (Pauzë). Gjithçka që mund të thuhet. (Pauzë). Dhe asgjëkundi s'ka një fjalë të vërtetë. (Pauzë). Krahët e mi. (Pauzë). Gjijnjtë e mi. (Pauzë). Çfarë krahësh? (Pauzë) Çfarë gjijnsh? (Pauzë). Vili. (Pauzë) Cili Vil? (*Pohon me zjarr*) Vili im! (*I kthen sytë djathtas. Duke thirrur*) Vili! (Pauzë. *Më fort*) O Vili! (Pauzë. *Shikon përpara*). Po fundja, të mos e di, të mos e di me siguri, falemnderës Zotit, nuk kërkoj gjë tjetër. (Pauzë). Ah, po... njëherë e një kohë... tani... hije gjelbëroshë... kjo... Sharloti... të puthurat... Kjo... gjithë kjo... ta turbullon mendjen sa më s'ka. (Pauzë). Por mua nuk më është turbulluar mendja. (*Buzëqesh*). Jo më. (*Buzëqesh më shumë*). Jo, jo. (*Shubet buzëqeshja. Pauzë Mbyll sytë. Zile e mprehtë. Ajo i hap sytë menjëherë. Pauzë*). Më dalin përpara sy... dhe i shoh tek mbyllen... të qetë... për të parë të qetë. (Pauzë). Jo të mitë (*buzëqesh*). Tani nuk janë më të mitë. (*buzëqesh më shumë*) Jo, jo (*Shubet buzëqeshja. Pauzë*). Vili. (Pauzë) Vili, a nuk të duket sikur toka e ka humbur atmosferën? (Pauzë). A të duket kështu, Vili? (Pauzë). Nuk ke kurrfarë mendimi? (Pauzë). S'ke ç'i bën, kështu ke qenë gjithmonë ti, kurrë nuk ke pasur një mendim tëndin, për çfarëdo qoftë. (Pauzë). Është e qartë (Pauzë). *Fare e qartë. (Pauzë)*. Rruzullimi. (Pauzë). Nganjëherë pyes veten (Pauzë). Ndoshta jo tërë qenien time. (Pauzë). Gjithmonë mbetet diçka. (Pauzë). Nga çdo gjë. (Pauzë). Disa mbeturina.

(Pauzë). Po të na linin mendtë. (Pauzë). Sigurisht nuk do të na lënë. (Pauzë). Jo krejtësisht (Pauzë). Jo mua (buzëqesh). Jo tashti. (buzëqesh më shumë). Jo, jo (shubet buzëqeshja. Pauzë). Kjo mund të ishte acari i përjetshëm. (Pauzë). Akulli-mi i përjetshëm. (Pauzë). Thjesht një rastësi, ma do mendja, një rastësi fatlume. (Pauzë). Ah, po, shpirtmadhësia e Perëndisë, shpirtmadhësia e Perëndisë. (Pauzë). Po tani? (Pauzë). Fytyra (pauzë). Hunda. (vëngëron sytë për të parë hundën). Po e shoh... (duke vëngëruar sytë)... majën... vrimat e hundës... frymën e jetës... atë hark që aq shumë e çmoje... (zgjat buzët)... një çikëz buzë... (i zgjat edhe më)... sikur t'i var buzët... (nxjerr gjuhën)... gjuhën po sigurisht... (e nxjerr edhe më)... që ti e pëlqeje aq shumë... (e nxjerr edhe më)... po ta nxjerr... (e nxjerr edhe më)... majën... (ngre sytë lart)... pakëz ballë... vetulla... ndoshta vetëm përfytyrim... (vështron majtas)... faqen jo... (vështron djathtas)... jo... (i fryn bulçitë)... madje dhe po t'i fryj (vështron majtas, i fryn bulçitë)... jo... jo... kurrfarë molle të kuqe. (Shikon përpara). Vetëm kaq. (Pauzë). Sigurisht është edhe çanta (shikon majtas). Pakëz e marrtë... por çanta është... (Shikon përpara. Me plogështi). Sigurisht janë toka e qielli (shikon djathtas). Umbrella që ti më dhe... atë ditë... (Pauzë)... atë ditë... liqeni... kallamat. (Shikon përpara. Pauzë). Çfarë dite? (Pauzë). Çfarë kallamash? (Pauzë e gjatë. Ajo mbyll sytë. Zile e mprehtë. Ajo i hap sytë menjëherë. Pauzë. Shikon djathtas). Sigurisht është edhe Brauni. (Pauzë). Vili, a të kujtohet Brauni, unë e kam para syve. (Pauzë. Më fort). Vili, Brauni ndodhet aty, përbri meje (Pauzë. Edhe më fort). Brauni ndodhet aty, Vili. (Pauzë. Shikon përpara). Vetëm kaq. (Pauzë). Ç'do të bëja pa to? (Pauzë). Ç'do të bëja pa to, kur fjalët të më lënë në baltë? (Pauzë). Të vështroj përpara, me gojë të kyçur? (Ajo e bën këtë gjë për disa çaste). Nuk mundem. (Pauzë). Ah, po, mirësitë e Perëndisë, mirësitë e mëdha të Perëndisë. (Pauzë e gjatë. Me zë të ulët). Hera-herës dëgjoj zhurma. (Mban vesh. Me zë normal). Por jo shpesh. (Pauzë). Qofshin të bekuara, qofshin të bekuara zhurmat, më ndihmojnë... të shtyj ditën. (Buzëqesh). Stili i vjetër! (Shubet buzëqeshja). Po, janë vërtet ditë të bukura, ditët kur ka zhurma

(*Pauzë*). Kur dëgjoj zhurma. (*Pauzë*). Njëherë e një kohë mendoja... (*Pauzë*)... njëherë e një kohë, po them, mendoja se ato ishin në kokën time (*buzëqesh*). Por jo (*buzëqesh më shumë*) jo, jo (*shubet buzëqeshja*). Ajo ishte logjika. (*Pauzë*). Arsyja. (*Pauzë*). Unë nuk e kam humbur arsyen. (*Pauzë*). Ende jo. (*Pauzë*). Jo të tërën. (*Pauzë*). Më ka mbetur një çikëz (*Pauzë*). Ca zhurma. (*Pauzë*). Ca si thërmime... të vogla, vithisje... të vogla. (*Pauzë. Me zë të ulët*).. Vili, këto janë gjërat. (*Pauzë. Me zë normal*). Në çantë, jashtë çantës. (*Pauzë*). Ah, po, gjërat kanë jetën e tyre, ja, këtë them ngaherë unë, gjërat kanë jetë. (*Pauzë*). Bie fjala, pasqyra ime nuk ka nevojë për mua. (*Pauzë*). Dhe kur bie zilja. (*Pauzë*). Të shpon si teh brisku. (*Pauzë*). Si daltë. (*Pauzë*). Nuk mund ta bësh veshin shurdh. (*Pauzë*). Sa herë kam thënë... (*Pauzë*)... po them, sa herë kam thënë: Bëje veshin e shurdhër, Vini, varja ziles, fli apo rri zgjuar, fli apo rri zgjuar, si të ta dojë qejfi, hapi e mbylli sytë, si të ta dojë qejfi, apo si të të vijë më për mbarë. (*Pauzë*). Hapi e mbylli sytë, Vini, hapi e mbylli sytë, gjithmonë ky avaz. (*Pauzë*). Por jo. (*buzëqesh*). Tani jo. (*buzëqesh më shumë*). Jo, jo (*shubet buzëqeshja. Pauzë*). Po tani? (*Pauzë*). Po tani, Vili? (*Pauzë e gjatë*). Kur gjithçka më mungon, sigurisht më mbetet historia ime (*Pauzë*). Historia e një jete (*buzëqesh*). Një jetë e tërë (*shubet buzëqeshja*). Që zë fill në bark të nënës, si qëmoti, Mildredit i kujtohet, asaj do t'i kujtohet barku i nënës, para se të vdesë, barku i nënës (*Pauzë*). Ajo qe nja katër a pesë vjeçe, kur i dhuruan një kukull të madhe dylli. Të veshur kokë e këmbë me gjithçka i duhej. (*Pauzë*). Këpucë, çorape, të brendshme, fund bareshe e dorashka. (*Pauzë*). Me azhur të bardhë. (*Pauzë*). Një kapelëz kashte të bardhë, me llastik. (*Pauzë*). Një gjerdan me margaritarë (*Pauzë*). Një libërth me figura që kishin poshtë tyre shkronja të njëmendta, për ta marrë nën sjetull gjatë shëtitjes. (*Pauzë*). Sy të kaltër si lule liri që hapen e mbyllen. (*Me ton rrëfimitar*). Dielli sapo kishite dalë në horizont, kur Mili u ngrit, zbriti... (*Pauzë*)... u mbështoll me penjuarin e saj të vogël, fill e vetme zbriti shkallën e thiktë, këmbadorazi e së prapthi, ndonëse ia kishin ndaluar ta bënte këtë, hyri në... (*Pauzë*)... kaloi në majë

të gishtave nëpër korridorin e heshtur, hyri në dhomën e femijëve dhe zuri të zhvishte çupëzën. *(Pauzë)*. Duke e qortuar gjithë kohës. *(Pauzë)*. Befas një mi – *(pauzë e gjatë)*. Ngadalë, Vini *(Pauzë e gjatë. Duke thirrur)* Vili! *(Pauzë. Më fort)* O Vili! *(Me qortim)*. Vili, herë-herë sjellja jote më duket pak e çuditshme, ti s'e ke zakon të sillesh mizorisht kot së koti. *(Pauzë)*. E çuditshme? *(Pauzë)*. Jo. *(buzëqesh)*. Këtu jo. *(buzëqesh më shumë)*. Tani jo. *(Shubet buzëqeshja)*. Megjithatë – *(Me shqetësim të papritur)*. Vetëm mos ndodhtë gjë e keqe *(shikon djathtas. Fort)*. I dashur, a është gjithçka në rregull? *(Pauzë. Shikon përpara)*. Dashtë Zoti të mos ketë futur në fillim kokën. *(Vështron djathtas. Fort)*. Vili, mos ke mbetur brenda. *(Pauzë. Me po atë zë)*. Vili, mos ke ngecur e s'del dot? *(Pauzë. Shikon përpara. E dëshpëruar)*. Ndoshta gjatë gjithë kësaj kohe ai ka thirrur për ndihmë, por unë s'e kam dëgjuar. *(Pauzë)*. Natyrisht unë dëgjoj britma *(Pauzë)*. Por ato janë në kokën time, apo s'është kështu? *(Pauzë)*. A ka mundësi që – *(Pauzë. Me ton të sigurt)*. Jo, jo, ka kohë që koka ime është plot britma. *(Pauzë)*. Me britma të mekura, të mbytura *(Pauzë)*. Ato vijnë. *(Pauzë)*. Ikin. *(Pauzë)*. Siç i merr era. *(Pauzë)*. Kjo është mrekullia vetë. *(Pauzë)*. Ato pushojnë. *(Pauzë)*. Ah po, mirësi e Perëndisë, mirësi e paanë e Perëndisë. *(Pauzë)*. Tani dita po ngryset. *(Buzëqesh. Shubet buzëqeshja)*. Megjithatë ende është pakëz herët, sigurisht, për këngën time. *(Pauzë)*. Po të këndosh tepër herët, ndjell zi, kështu më duket ngaherë. *(Pauzë)*. Nga ana tjetër, të ndodh të presësh shumë. *(Pauzë)*. Po bie zilja për gjumë dhe unë ende nuk kam kënduar. *(Pauzë)*. Tërë dita e lume iku, fluturoi – *(buzëqesh, shubet buzëqeshja)* – pa kthim dhe pa kënduar as më të voglën këngë. *(Pauzë)*. Këtu ka një problem. *(Pauzë)*. Nuk mund t'ia marrësh këngës... kështu, jo. *(Pauzë)*. E ke këngën në gojë, pa e ditur përse, por nuk është çasti i duhur, ndaj e kapërdin prapë. *(Pauzë)*. Dikush thotë: është çasti të këndosh, o tani, o kurrë, dhe nuk mundesh. *(Pauzë)*. Thjesht nuk mund të këndosh. *(Pauzë)*. Asnjë notë të vetme. *(Pauzë)*. Diçka tjetër, Vili, para se të hidhemi te diçka tjetër. *(Pauzë)*. Trishtimi pas të kënduarit. *(Pauzë)*. Vili, a e ke provuar një gjë të këtillë? *(Pauzë)*. Gjatë përvojës



sate? (Pauzë). Jo? (Pauzë). Trishtimin pas mbarimit të marrëdhënieve intime seksuale, doemos këtë trishtim e njohim mirë të gjithë. (Pauzë). Vili, në këtë pikë, ti do të ishe në një mendje me Aristotelin, besoj. (Pauzë). Po, këtë trishtim e kemi provuar dhe dimë t'i bëjmë ballë. (Pauzë). Por pas të kënduarit... (Pauzë). Merret vesh, ai nuk zgjat shumë. (Pauzë). Kjo është mrekullia vetë. (Pauzë). Ai davaritet. (Pauzë). Si thonë ato vargjet e mrekullueshme? (Pauzë). Gjithçka... tra-la-la... gjithçka harrohet... vala... jo... furishëm lëshohet... gjithçka ta-la-la, gjithçka furishëm lëshohet... vala... jo... tallazi... po... tallazi mbi tallaz harrohet... rroposet... po... tallazi mbi tallaz rroposet... dhe tallazi jo... vala... po... dhe vala që kalon, harron... harron... (Pauzë). Oh, jo të gjithë. (Pauzë). Një pjesë (Pauzë). Një pjesë mbetet. (Pauzë). Është mrekullia vetë që të mbetet në mend një pjesë, nga vargjet e klasikëve, sepse shtyn ditën me to. (Pauzë). Ah, po, një mirësi e pafund e Perëndisë. (Pauzë). Po tani? (Pauzë). Po tani, Vili? (Pauzë e gjatë). Thërras para syve të mendjes Zotëri Pajperin... a Kukerin. (Ajo mbyll sytë. Zile e mprehtë. Ajo hap sytë menjëherë. Pauzë). Dorë për dore, në dorën tjetër çantat. (Pauzë). Moshë e mesme. (Pauzë). S'janë më të rinj, por as pleq nuk janë. (Pauzë). Rrinë në këmbë aty, si hunj, pa m'i ndarë sytë, gojëhapur. (Pauzë). S'e ka keq kraharorin, thotë ai, kam parë edhe më keq. (Pauzë). S'i ka keq supet, thotë ai, kam parë edhe më të këqija. (Pauzë). Vallë, a i ndien këmbët? – thotë ai. (Pauzë). A mos është atje brenda siç e ka bërë nëna? thotë ai. (Pauzë). Pyete, thotë ai, mua më vjen turp. (Pauzë). Për çfarë ta pyes? thotë ajo. (Pauzë). Pyete a i ndien ende këmbët. (Pauzë). A është siç e ka bërë nëna atje brenda? (Pauzë). Pyete vetë, thotë ajo. (Befas flet me rreptësi). Lëshomë, dreqi e mori, dhe plaç! (Pauzë. Me po atë ton). Plaç! (Buzëqesh). Por jo. (buzëqesh më shumë). Jo. Jo. (Shuhet buzëqeshja). I shoh tek po largohen. (Pauzë). Dorë për dore, me çanta në dorën tjetër. (Pauzë). Turbull. Pastaj treten fare. (Pauzë). Qeniet e fundme njerëzore – që i ka sjellë rruga gabimisht këtej. (Pauzë). Deri këtu. (Pauzë). Po tani? (Pauzë. Me zë të ulët). Ndihi më. (Pauzë. Me po atë zë). Ndihi-

momë, Vili. *(Pauzë. Me po atë zë)*. Jo? *(Pauzë e gjatë)*. Ja ku ia behu një mi... *(Pauzë. Me ton rrëfimtari)*. Ja ku ia behu një mi... mbi kofshën e saj të vogël... u ngjit më lart... më lart... dhe Mildredi e lëshoi çupëzën e llahtaritur, zuri të bërtiste – *(Vini lëshon një britmë të mprehtë)* – dhe bërtiti e bërtiti – *(Vini klith dy herë)* – bërtiti e bërtiti, derisa erdhën me vrap të gjithë, të veshur me rroba nate, Babi, Mami, Bibi dhe plaka... Ani, për të parë se çfarë prapësie kishte ndodhur, se çfarë prapësie, o Zot, mund të kishte ndodhur. *(Pauzë)*. Tepër vonë. *(Pauzë e gjatë. Me zë që mezi dëgjohet)*. Vili. *(Pauzë. Me zë normal)*. Edhe pak, Vini, dhe do të bjerë zilja për gjumë. *(Pauzë)*. Atëhere ti mund t'i mbyllësh sytë, atëhere duhet t'i mbyllësh sytë dhe të mos i hapësh më. *(Pauzë)*. Përse ta thashë prapë këtë? *(Pauzë)*. Njëherë e një kohë mendoja... *(Pauzë)*... po them, njëherë e një kohë mendoja që kurrë nuk kishte asnjë ndryshim midis një fraksioni të sekondës dhe atij që vjen më pas. *(Pauzë)*. Njëherë e një kohë thosha me vete... *(Pauzë)*... po them, një herë e një kohë thosha me vete, Vini, ti nuk do të ndryshosh kurrë, nuk ka kurrë ndonjë ndryshim midis një fraksioni të sekondës dhe atij që vjen më pas. *(Pauzë)*. Përse po e zë ngoje prapë këtë gjë? *(Pauzë)*. Ka kaq pak gjëra të cilat mund t'i zësh ngoje. *(Pauzë)*. Njerëzit flasin e stërflasin për gjithçka. *(Pauzë)*. Për gjithçka mundin. *(Pauzë)*. Po më dhemb qafa. *(Pauzë. Befas flet me të rreptë)*. Po më dhemb qafa! *(Pauzë)*. Ah, e kam më mirë! *(Me një farë pezmatimi)*. Nuk duhet kaluar masa. *(Pauzë)*. S'mund të bëj më asgjë. *(Pauzë)*. S'mund të them më asgjë. *(Pauzë)*. Por duhet të them edhe më. *(Pauzë)*. Këtu është halli. *(Pauzë)*. Jo, duhet të lëvizë, diçka, në botë, unë kam marrë fund. *(Pauzë)*. Një pui. *(Pauzë)*. Një fllad. *(Pauzë)*. Si thonë ato vargje të pavdekshme? *(Pauzë)*. Kjo mund të jetë errësira e përjetshme. *(Pauzë)*. Natë e zezë pus pa shtegdalje. *(Pauzë)*. Thjesht një rastësi, ma thotë mendja, një rastësi fatlume. *(Pauzë)*. Ah, po, një mirësi e pafundme e Perëndisë. *(Pauzë e gjatë)*. Po tani? *(Pauzë)*. Po tani, Vili? *(Pauzë e gjatë)*. Atë ditë. *(Pauzë)*. Shampanja ngjyrëtrëndafili. *(Pauzë)*. Gotat e holla e gjatoshë. *(Pauzë)*. Më në fund mbetëm vetëm. *(Pauzë)*. Rrëkë-

llyem gotën e fundit, ndërsa trupat tanë gati preknin njëri-tjetrin. (Pauzë). Vështrimi. (Pauzë e gjatë). Çfarë dite? (Pauzë). Çfarë vështrimi? (Pauzë e gjatë). Dëgjoj britma. (Pauzë). Nisja këngës. (Pauzë). Këndo këngën tënde të vjetër, Vini!

*Pauzë e gjatë. Befas ajo merr pamjen e njeriut që mban vesh. Shikon djathtas. Koka e Vilit duket në të djathtë, rrëzë sukës, mbi shpat. Ai është këmbadorazi, me kostumin e dhëndërisë – me cilindër, frak, pantallona me vija etj... në duar ka vënë dorashka të bardha. Ka mustaqe të gjata, të bardha e të dendura. Ai vështron përpara, lëmon mustaqet. Del i tëri që prapa sukës, sillet nga e majta, ndalet, i ngre sytë nga Vini. Ecën këmbadoras drejt qendrës, ndalet, kthen kokën nga salla, shikon përpara, lëmon mustaqet, ndreq kravatën, rras edhe pakëz cilindrin në kokë etj... ecën edhe pak, ndalet, heq cilindrin dhe i ngre sytë nga Vini. Tani është pranë qendrës, aty ku ka fushëpamje. I lodhur së vështruari lart, ai e ul kokën deri në tokë.*

VINI: (Me ton mondan). Kjo qenka ç'qenka! Ja një kënaqësi që nuk e prisja fare. (Pauzë). Kjo më kujton atë pranverë kur ti vije e më shprehje dashurinë me lot në sy. (Pauzë). Vini, bëhu imja, unë të adhuroj! (Ai ngre sytë nga ajo). Jeta nuk ka kuptim pa ty, Vini. (Ajo ia shkrep të qeshurit). Ç'dordolec, qenka veshur si për karna-va-le! (Ajo qesh). Ku janë lulet? (Pauzë). E asaj dite. (Vini ul kokën). Çfarë paske në qafë? Një të thatë? (Pauzë). Vili, duhet ta mjekosh me kujdes që të mos hapet. (Pauzë). Ku humbe gjithë këtë kohë? (Pauzë). Ç'po bëje? Po visheshe? (Pauzë). S'më dëgjove kur të thirra? (Pauzë). Mos kishe ngecur brenda në atë strofullën tënde? (Ai ngre sytë nga ajo). Ashtu, Vili. Shumë mirë, shikomë mua. (Pauzë). Kulloti sytë e ty të plakur, Vili. (Pauzë). A ka mbetur gjë? (Pauzë). Ndonjë gjurmë? (Pauzë). Ti e di, nuk munda të bëhesha prapë e bukur siç kam qenë. (Ai ul kokën). Sidoqoftë ti nuk ke ndryshuar aq sa të mos njihesh. (Pauzë). Ke vendosur të vish e të jetosh nga kjo anë tani... mbase për pak kohë? (Pauzë). Jo? (Pauzë). Vetëm sa të rruga këndeje? (Pauzë). Vili, mos të kanë lënë gjë veshët? (Pauzë). Mos të ka lënë goja? (Pauzë). Oh, e di, ti gjithnjë ke qenë fjalëpakë, bëhu imja, Vini, unë të adhuroj, dhe me kaq

morën fund fjalët e ëmbla, fjalët duheshin vetëm për oferta e kërkesa. (Vështron përpara). Po fundja, ç'rëndësi ka, sidoqoftë kjo qe ditë e bukur, edhe një tjetër ditë e bukur. (Pauzë). Nuk të kanë mbetur shumë ditë të tilla, Vini. (Pauzë). Dëgjoj britma. (Pauzë). Vili, a të qëllon të dëgjosh britma? (Pauzë). Jo? (I hedh sytë djathtas, te Vili). Vili, shikomë dhe një herë. (Pauzë). Ah! (Pauzë). Vili, shikomë prapë. (Pauzë). Vili, shikomë dhe një herë. (Ai i ngre sytë nga ajo. Vinit i qesh fytyra). Ah! (Pauzë). E tronditur). Ç'pate, s'të kam parë kurrë kështu. (Pauzë). I dashur, mbuloje kokën, ka diell, mos bëj naze. (Ai hedh cilindrin e dorashkat dhe fillon të ngjitet drejt saj. Vini s'mbahet nga gëzimi). Oh, kjo është fantastike! (Ai shtang në vend, me një dorë kapur fort pas sukës, me tjetër të shtrirë përpara). Jepi, zemër, më me vrull, jepi, unë do të duartrokas për ty. (Pauzë). Tek unë kërkon të vish, apo diku tjetër? (Pauzë). Do të doje të më prekje... fytyrën... edhe një herë? (Pauzë). Kërkon një të puthur, Vili, apo diçka tjetër? (Pauzë). Ka qenë një kohë kur unë mund të të kisha dhënë dorën. (Pauzë). Dhe një kohë tjetër, më e largët, kur vërtet të jepja dorën. (Pauzë). Ti e ke pasur gjithmonë të domosdoshme të të jepnin dorën. (Ai e heq dorën me të cilën mbahet, rrokulliset tatëpjetë sukës). Bum! (Ngrihet prapë këmbadorazi, i ngre sytë nga Vini). Përpiqu edhe një herë, Vili, do të brohoras për ty. (Pauzë). Mos më shiko ashtu. (Pauzë. Prerazi). Mos më shiko ashtu! (Pauzë. Me zë të ulët). Vili, mos të kanë lënë mendtë? (Pauzë. Me po atë zë). Ato pak mend të plakura që të kanë mbetur?

Pauzë.

VILI: (Me të pëshpëritur). Vin!

Pauzë. Sytë e Vinit kthehen përpara. Asaj i qesh fytyra nga lumturia.

VINI: Vil! (Pauzë). Oh, sa e bukur qe edhe kjo ditë! (Pauzë).

Edhe një ditë tjetër. (Pauzë). Në fund të fundit. (I zhduket nga fytyra pamja e lumtur). Deri këtu.

Pauzë. Ajo këndon notat e para të melodisë, të asaj që dha kutia e muzikës, pastaj ia thotë këngës me zë të ulët:

O çast plot hare,  
Që na deh  
Ngadalë  
Ledhatimi  
Premtimi  
Që çasti na fal  
Përçafimi i zjarrtë  
I dëshirave pa fre  
Gjithçka thotë: Mbamë,  
Meqë jotja jam.

*Paузë. Ajo mbyll sytë. Zile e mprehtë. Ajo i hap sytë menjëherë.  
Buzëqesh. Shikon përpara. I hedh sytë djathtas, te Vili, i cili  
vazhdon të rrijë këmbadoras, duke e vështruar ngultas. Shuhet  
buzëqeshja. Ata vështrojnë njëri-tjetrin. Paузë e gjatë.*

BIE PERDJA

## PËRMBAJTJA

Duke pritur Godonë .....	5
Akti i parë .....	7
Akti i dytë .....	48
Oh ato ditë të bukura .....	85
Akti i parë .....	87
Akti i dytë .....	110

## **Konstelacione 8**

---

Samuel Beckett lindi në Dublin më 1906.

Romancieri dhe dramaturgu irlandez u vendos në Francë më 1938 dhe që prej vitit 1945 shkroi kryesisht në frëngjisht.

Mik i Kafkës dhe Joyce-it, Beckett-i ndikohet prej veprës së tyre e gjithashtu bëhet përkthyes i saj.

Pjesët teatrale të Beckett janë përkthyer e janë vënë në skenë në mbarë botën.

Vdiq më 1989.

**Çmim Nobel për letërsi 1969**